REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

# RAPORT
# I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023

**Mars 2024**

**E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,**

**Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,**

Në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 148/b shkronja "d" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 104 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me Kalendarin Vjetor të Kuvendit për Raportimin e Institucioneve të Pavarura për Veprimtarinë e Vitit 2023, dërguar me shkresën tuaj nr. 290 prot., datë 24.01.2024, ju parashtroj Raportin Vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2023.

Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara, për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në vend, për efiçencën e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe efektivitetin e hetimeve, ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale, analizën e profilit të viktimave, kostot e shpenzimeve procedurale penale dhe veprimtari të tjera thelbësore përgjatë vitit 2023, si dhe objektivat prioritare për vitin 2024.

Viti 2023 ishte një vit sfidues për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për shkak të çështjeve administrative që lidheshin me zbatimin e hartës së re gjyqësore dhe vijimit të uljes së numrit të prokurorëve si pasojë e pezullimit apo shkarkimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Megjithatë, përpjekjet dhe profesionalizmi i prokurorëve në të gjithë nivelet pavarësisht ngarkesës dhe bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitucional, dhanë rezultate në punën hetimore, zbatimin dhe përmirësimin e drejtësisë penale siç do të shihet në këtë raport.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe Planit të Veprimit të Grupit të Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar, si dhe në prioritetet në procesin e integrimit me Bashkimin Europian.

Për të garantuar, si vijimin e rritjes së mëtejshme të efiçencës dhe efektivitetit në luftën e përbashkët kundër krimit, forcimin e rendit juridik dhe shtetin e së drejtës, ashtu dhe mbrojtjen e lirive personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetit, ka ende shumë për të bërë, dhe për këtë nevojitet vijimi i masave për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në sistemin e prokurorisë të riorganizuar, rritja e efiçencës së bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë penale dhe i strukturave shtetërore, vijimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe rritja më tej e përgjegjshmërisë dhe integritetit në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë penale.

Në vijim, ju paraqesim raportin për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2023.

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

**I. Drejtimet dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit ..........................................5**
Drejtimet prioritare, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit.........................................5
Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit, Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave "Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023" dhe rekomandimeve të Bashkimit Evropian.........5
Aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm ...........................................................40
Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave………………………...41
Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq..........................................................................................................................43

**II. Analiza e treguesve të kriminalitetit.................................……..…......................45**
2.1 Volumi i punës në hetim ......…………………………..........................................45
2.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë…………………............................…........46
2.3 Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë në pesë vitet e fundit .....…......…...46
2.4 Procedime penale të regjistruara sipas prokurorive............................................. 52
2.5 Koeficientët e kriminalitetit për 100,000 banorë...................................................53
2.6 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale ……………………..…........55
2.7 Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë……................56
2.8 Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal ……………………………..…........57
2.9 Analiza e veprave penale sipas strukturës së kodit penal………………................61
Krime kundër njerëzimit........................................................................................61
Krime kundër jetës të kryera me dashje…………………………………..…....61
Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi………………………………………65
Vepra penale kundër shëndetit të kryera me dashje……………………….........65
Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia………………………........68
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose mosdhënia e ndihmës……......................................................................................68
Krime seksuale……………………..........................................................................71
Vepra penale kundër lirisë së personit………….......................................................75
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit…........................................................78
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes……...............….................81
Vepra penale kundër lirisë së besimit....…..................................……....…....85
Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike…………........................85
Mashtrimet………………………………………………...…..................................89
Shkatërrimi i pronës……………………………………........................….....93
Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare……………...……….....................96
Vepra penale në veprimtaritë bankare dhe financiare…………………….............99
Krime në fushën e doganave…………………...........................….…......99
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet……………………......…………..103
Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë……………………...................…..106
Falsifikimi i dokumenteve…………………………………….................…......108
Vepra penale në fushën e falimentimit..............................................................112
Zhvillimi i palejuar i lojrave të fatit…………………………..............................112
Vepra penale që cënojnë rregjimin juridik të tokës………………………….........114
Vepra penale kundër mjedisit……………………...………..............................117
Krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që cënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera……………………….........................................................121

Vepra me qëllime terroriste……………………………...................................…....121
Krime kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit...............................121
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik…………………..........................................................125
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike……………...............................128
Vepra penale që lidhen me pastrimin e parave…….............................................132
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë……………………......135
Vepra penale kundër drejtësisë…………………………………………….............138
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve…………….........................................................................142
Veprat penale të korrupsionit………………….......................................…...143
Krimi kibernetik……………………....................................................………146
Trafiqet e paligjshme………................................................................................148
Veprat penale që lidhen me prodhimin dhe kultivimin e narkotikëve...................152
2.10 Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në vite....................................156
2.11 Të dhëna për të pandehurit ..................................................................................161

**III. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.............................................166**

**IV Garantimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike …………………………………..…………..…......................................181**

**V. Ngarkesa e punës së prokurorive për vitin 2023.....................................................189**

**VI. Përmbledhje e analizës financiare.........................................................................202**

**VII. Objektiva prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024.................. 206**

**Aneksi 1 Tabelat me të dhëna e tregues statistikorë të veprave penale..................... 210**
**Aneksi 2 Të dhëna për trajnimet.............................................................................233**

# I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023

Prokuroria është organ i pavarur kushtetues, që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.

Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm përbëhen nga:

a) Prokuroria e Përgjithshme;
b) Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë;
c) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në prokuroritë sipas niveleve më sipër funksionet ushtrohen nga prokurorët pranë tyre.

Zhvillimet kryesore, përgjatë vitit 2023 në luftën kundër kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, në mënyrë sintetike, kanë qenë[1]:

## Drejtimet prioritare, rekomandimet, aktivitetet dhe treguesit

Drejtimet kryesore të luftës kundër kriminalitetit për vitin 2023, të formalizuara, si në politikat dhe objektivat prioritare institucionale të parashtruara në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm dërguar Kuvendit të Shqipërisë "Për gjendjen e kriminalitetit për vitin 2022" në prill 2023, ashtu dhe në rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e BE[2]-Shqipëri dhe në planin e veprimit të ICRG/FATF - Shqipëri, kanë qenë në fokusin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023. Këto drejtime janë ndjekur me përparësi, si nëpërmjet masave administrative dhe procedurale institucionale siç janë miratimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit për të unifikuar veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe mbikëqyrjes së zbatimit tyre me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit bazuar në një kornizë të kuadrit normativ të unifikuar, konsoliduar dhe sa më efiçent në veprimtarinë institucionale, ashtu dhe nëpërmjet vijimit të zbatimit të akteve të përbashkëta me disa institucione dhe agjenci ligjzbatuese ndërvepruese brenda dhe jashtë vendit që kanë ndikuar në rritjen e kapaciteteve ndërinstitucionale e profesionale dhe efiçencën e bashkëpunimit ndërinstitucional.

### 1. Zbatimi i rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, i rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, dhe i rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE-së).

**1.1 Në zbatim të rekomandimit 1 të Rezolutës** "*Të vijojë rritja e rolit aktiv të prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore*", **i cili përkon me rekomandimin prioritar 3, në drejtimin**

[1] Renditur sipas rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023.
[2] Shih, pika 2.2.2 Kapitulli 24, "Drejtësia, liria dhe siguria", Raporti për Shqipërinë 08.11.2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en.

**I të vendimit të Këshillit të Ministrave** "*Vijimin e marrjes së masave për kontrollin nga prokurori të punës së oficerëve të policisë gjyqësore, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë së hetimeve, duke evidentuar rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e këtyre rekomandimeve të vazhdueshme, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021"Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", i ndryshuar dhe në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, datë 12.05.2023 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" (në vijim udhëzimi nr. 2/2023), janë normuar masa administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv dhe ushtrimin sistematik të kontrollit efektiv nga ana e prokurorëve dhe drejtuesve ndaj oficerëve të policisë gjyqësore në drejtim të ecurisë së hetimit të procedimeve në ndjekje për ligjshmërinë, objektivitetin, plotshmërinë dhe respektimin e afateve në veprimet hetimore të kryera dhe/ose vlefshmërinë e akteve procedurale të përftuara, në drejtimet prioritare të rekomanduara. Nga ana tjetër, për rritjen e rolit të drejtuesit në drejtimin, bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore në juridiksionin e prokurorisë që drejton dhe rolit të prokurorit në çështjen konkrete, është parashikuar që në rast evidentimi të akteve dhe sjelljeve që përbëjnë shkelje disiplinore, përkatësisht kërkojnë dhe iniciojnë fillimin e procedimit disiplinor sipas ligjit.

Prokuroria e Përgjithshme, aspekt të rëndësishëm të llogaridhënies, ka konsideruar ushtrimin e kontrollit efektiv në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore nga strukturat e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, si për evidentimin e veprimeve në shkelje të ligjit, ashtu dhe për të iniciuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe të shërbimeve në strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit apo shërbimeve policore të tjera me atributet e policisë gjyqësore. Për periudhën raportuese, Prokurori i Përgjithshëm mbi bazën e shkeljeve të evidentuara ka kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 2 oficerë të policisë gjyqësore.

Po kështu, gjatë vitit 2023, në zbatim të udhëzimit nr. 10/2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", i ndryshuar, janë monitoruar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë periodike të dhënat statistikore të nxjerra nga sistemi, *Statistikat e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të prokurorisë*.

Prokurori i Përgjithshëm me urdhrin nr. 24, datë 14.02.2023 ka krijuar një grup pune me objekt "Mbi inspektimin tematik për saktësinë në hedhjen e të dhënave në SVHOPGJP në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë". Në funksion të zbatimit të këtij urdhri, është kryer verifikimi i veprimeve hetimore të pasqyruara në sistem nga oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në periudhën 01.11.2022 – 31.01.2023. Në përfundim të këtij inspektimi rezultoi se nuk është respektuar udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10/2021, i ndryshuar, e konkretisht, neni 8/a, pika 2, lidhur me hedhjen e të dhënave në sistemin SVHOPGJP, nga 23 (njëzetë e tre) oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Prokurori i Përgjithshëm, pas njohjes me rezultatet e inspektimit, ka kërkuar zbatimin me korrektesë të udhëzimit nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe marrjen e masave nga ana e drejtuesve për sigurimin e saktësisë së të dhënave të hedhura.

Nga ana tjetër, procesi i plotësimit të këtij sistemi ka nxjerrë në dukje edhe disa problematika teknike për adresimin e të cilave u morën masat e duhura dhe prej datës 1 janar 2024, ky sistem i përmirësuar është në funksion.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar në informacionin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, përgjatë vitit 2023 ky Komision në zbatim të kompetencave sipas ligjit për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në propozimet e dërguara nga prokurorët e çështjeve, drejtuesit e prokurorive dhe Prokurori i Përgjithshëm, ka urdhëruar dhe vijuar zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj 9 oficerëve të policisë gjyqësore, nga të cilët 6 oficerë të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe 3 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Në përfundim të procedimit displinor Komisioni ka dhënë masat e mëposhtme disiplinore: "largim nga detyra" në 1 rast; "pezullim nga detyra 6 muaj" në 1 rast; "vërejtje me paralajmërim" në 1 rast. Është vendosur pushimi për 1 rast, dhe për 5 procedime disiplinore vijon shqyrtimi.

Një vend të rëndësishëm në sigurimin e profesionalizmit dhe integritetit në kryerjen e detyrave nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore, zë edhe vlerësimi i tyre. Në vitin 2023, në zbatim të nenit 29 pika 2, të ligjit nr. 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", i ndryshuar dhe procedurave që parashikohen në "Rregulloren për sistemin e vlerësimit të rezultateve të punës dhe integritetit të oficereve të policisë gjyqësore", e ndryshuar, mbi bazën e vlerësimeve me pikë të dërguara nga drejtuesit e prokurorive, Komisioni ka kryer vlerësimin e oficerëve të policisë gjyqësore, për vitin 2022, për 127 oficerë të Policisë Gjyqësore duke dhënë vlerësimet si vijon: "Shumë mirë" 75 vlerësime; "Mirë" 44 vlerësime; "Mjaftueshëm" 7 vlerësime; "I paaftë" 1 vlerësim.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i vlerësimeve të performancës së oficerëve të policisë gjyqësore të dërguara nga drejtuesit e prokurorive të shkallës së parë, evidentohet se ky proces nuk ka marrë vlerësimin e duhur nga të gjithë drejtuesit e prokurorive, si një proces i detyrueshëm i cili ka për qëllim të evidentojë aftësitë, efikasitetin, kualifikimin dhe integritetin e oficerëve të Policisë Gjyqësore. Për këtë arsye, Komisioni bëri ndryshime në rregullore duke parashikuar mekanizma që parandalojnë vlerësimet jo objektive dhe të pambështetura në treguesit realë të aktivitetit të Policisë Gjyqësore.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimin prioritar të Këshillit të Ministrave për faktin se nga Prokurori i Përgjithshëm është miratuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 2/2023 dhe ka vijuar zbatimi i udhëzimit nr. 10/2021, të cilët normojnë masa administrative dhe procedurale për monitorimin e veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore, nxitjen e strukturave monitoruese, përfshirë dhe prokurorët, të cilët në bashkërendim me Komisionin e Policisë Gjyqësore, për shkeljet ligjore të konstatuara kanë iniciuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore dhe ndërkohë Komisioni ka proceduar dhe ka marrë masat disiplinore përkatëse.

**1.2 Lidhur me rekomandimin 2 të Rezolutës** "*Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje e veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi. Të forcohen kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet, si dhe për hetimin e rasteve të dhunës në familje",* **dhe me rekomandimet prioritare 1, 4, 6, 7, 8, 9, në drejtimin IV të vendimit të Këshillit të Ministrave** *"1. Vijimin e aplikimit të masave alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangies) tek të miturit, për të siguruar një drejtësi miqësore dhe duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të të miturit.", "4.Vijimin e ashpërsimit të masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e*

*keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.", "6. Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, krimin kibernetik dhe veprat penale mjedisore.", "7. Marrjen e masave për të rritur efektivitetin e garancive procedurale për viktimat e mitur dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit në konflikt me ligjin.", "8. Rritjen e përpjekjeve dhe ashpërsimin e masave për të forcuar luftën kundër krimit në familje dhe dhunës ndaj grave, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e këtyre fenomeneve të dëmshme për shoqërinë shqiptare.", "9. Vijimin e rritjes së cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale duke rritur kërkesat e caktimit të dënimit me burg për autorët e veprës penale të dhunës në familje dhe kryesisht autorët recidivistë të dhunës në familje.",* aktivitetet e zhvilluara dhe rezultatet e arritura do të trajtohen në çështjet si më poshtë:

*Informacion dhe të dhëna statistikore për dhunën në familje dhe dhunën ndaj fëmijëve*

Në kuadrin e këtij rekomandimi të rezolutës dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023, prokurorët janë udhëzuar për rritjen e cilësisë së hetimeve dhe ndjekjen e një politike penale efektive dhe eficiente, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkesat/konkluzionet përkatëse, si rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe kushtet/kriteret ligjore, në ashpërsimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprat penale dhuna në familje, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër këtij krimi, ashtu dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të këtyre veprave penale prioritare, veçanërisht ato ndaj të miturit, dhunës në familje, dhunës gjinore dhe krimeve seksuale.

Përgjatë vitit 2023, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 8/2021, datë 15.11.2021 "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktima dhe/ose dëshmitarë", veçanërisht aplikimin e dispozitave që normojnë shmangien e të miturit në konflikt me ligjin nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative, si dhe që udhëzojnë se në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit dhe/ose për caktimin e dënimit ndaj të miturit, në çdo rast prokurori vlerëson dhe konsideron parësor interesin më të lartë të fëmijës që është rehabilitimi dhe riintegrimi i tij në shoqëri.

Në kuadrin e këtyre masave ka vijuar synimi për rritjen e eficiencës dhe efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve ndaj të miturve, në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë, të udhëhequr nga parimet e një drejtësie penale sa më miqësore dhe i interesit më të lartë të të miturit, si dhe garantimi i të drejtave të tyre, në mënyrë që të kontribuohet në uljen e kriminalitetit te të miturit, në rehabilitimin, riintegrimin dhe eliminimin e dhunës ndaj tyre dhe zbatimin e unifikuar të akteve procedurale penale në çështjet me të mitur, në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare në drejtësinë penale për të mitur.

Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe udhëzimeve të përgjithshme nr. 17/2020 dhe nr. 5/2018, dhe të kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese e ligjore ka kërkuar nga drejtuesit dhe prokurorët, nëpërmjet kërkesave për informacion të dhëna statistikore për dhunën në familje dhe dhunën ndaj fëmijëve, duke garantuar pavarësinë e ushtrimit të funksioneve nga ana e tyre.

Referuar të dhënave statistikore, për veprën penale "Dhuna në familje" neni 130/a i Kodit Penal, për vitin 2023 janë regjistruar 1396 procedime penale, me 1078 të pandehur ose me ulje 3,92 % të procedimeve dhe ulje 11,35 % të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 996 procedime me 1048 të pandehur, ose me ulje prej 8,87 % të procedimeve dhe 11,33 % e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2022.

Efektiviteti i ndjekjes penale është i lartë në kryerjen e hetimeve dhe ndjekjen për veprën penale të dhunës në familje në vitin 2023, ku evidentohet se çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje shumë më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 71,35 % dërguar gjyqit dhe 21,35 % të pushuara.

Lidhur me ashpërsimin e politikës penale për veprën penale "Dhuna në familje" sipas nenit 130/a i Kodit Penal, të dhënat statistikore evidentojnë se:

i) kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë vepër janë të ashpra, ku 89,04 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest me rritje në krahasim me vitin 2022 ku kërkesat për arrest ishin më masën 86,13 %.

ii) kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë vepër penale rezultojnë se 61,82 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 38,18 % e kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg, shifra përafërsisht të njëjta me vitin 2022.

Ndërkohë, në vitin 2023, për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" që parashikon neni 79/c i Kodit Penal, janë regjistruar 12 procedime penale, me 12 të pandehur ose me ulje 14,29 % të procedimeve dhe rritje 20 % e të pandehurve të regjistruar, krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 10 procedime me 10 të pandehur, ose me ulje 9,09 % të procedimeve dhe 28,57 % e të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale, krahasuar me vitin 2022.

Lidhur me ashpërsimin e politikës penale për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare" neni 79/c i Kodit Penal, të dhënat statistikore evidentojnë se: i) kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer këtë vepër janë të ashpra, ku 100 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest, ashtu si dhe në vitin 2022, ndërsa ii) kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këtë vepër penale, gjithashtu rezultojnë të ashpra, me burgim të përjetshëm, apo me burgim në maksimumin e dënimit që parashikon kjo dispozitë (neni 79/c).

Referuar të dhënave statistikore (aneksi 1, tabela 6), për grupveprat penale "Krimet seksuale", Seksioni VI, Kreu III", për vitin 2023 vërehet se janë regjistruar 124 procedime penale, me 69 të pandehur ose me ulje 23,46 % të procedimeve dhe me ulje 28,13 % të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 53 procedime me 58 të pandehur, ose me ulje 39,08 % të procedimeve dhe ulje 38,95 % të të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2022.

Kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime seksuale janë të ashpra, ku 96,29 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest.

E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, 87,30 % e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 12,70 % për caktimin e alternativave të dënimit me burg.

Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrit nr. 124/2020 për "Krijimin e një regjistri të posaçëm në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm" bazuar dhe në informacionet e ardhura nga prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm ka konstatuar se prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në seksionet për të mitur kanë bërë kujdes në kërkimin e masave alternative të dënimit, si shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen dhe paralajmërimi me shkrim. Gjithashtu është synuar që ndaj tyre të jetë proceduar në sa më pak raste me arrestime apo ndalime, duke i kryer hetimet me masa sigurimi "Vendosja në mbikëqyrje" dhe "Vendosja në një shërbim të specializuar", të parashikuara nga nenet 83 e 84 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit apo masa sigurimi të tjera alternative.

i) Referuar të dhënave statistikore për vitin 2023, bazuar në disponimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 891 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin, me rritje 8,53 % të numrit të procedimeve krahasuar vitin 2022. Janë regjistruar 746 të mitur në konflikt me ligjin si të pandehur ose persona nën hetim, ose me rritje 30,42 % të numrit të pandehurve/personave nën hetim të mitur në konflikt me ligjin krahasuar vitin 2022.

ii) Ndaj të miturve në konflikt me ligjin janë vendosur 16 masa sigurimi personal arrest në burg, ose për rreth 4,83 % të të miturve të pandehur ose persona nën hetim, tregues në rritje të lehtë krahasuar me 4,38 % që përbënte ky raport për vitin 2022.

iii) Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat statistikore evidentojnë se: -është vendosur mosfillimi i procedimit për 603 referime/kallëzime penale ndaj të miturve ose me rritje 7,49 % krahasuar me vitin 2022; -janë pushuar 353 çështje me 353 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 11 % të çështjeve të pushuara krahasuar me vitin 2022; dhe -janë dërguar për gjykim 178 çështje me 195 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me ulje 13,59 % të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2022.

iv) Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat statistikore rezulton se: në kuadrin e procedimeve të mosfilluara në 87 raste është aplikuar shmangia, ndër të cilat në 8 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 79 raste është vendosur paralajmërim me shkrim. Ndërkohë, për çështjet e pushuara në 326 raste është aplikuar shmangia, ndër të cilat në 2 raste është vendosur këshillim, në 39 raste është vendosur paralajmërim me gojë, 282 raste është vendosur paralajmërim me shkrim dhe në 3 raste është caktuar masë detyruese.

v) Sipas të dhënave statistikore evidentohet se janë regjistruar 770 procedime/çështje me 807 viktima të mitura, prej të cilëve 346 femra dhe 461 meshkuj, ulje me 7,56 % e çështjeve krahasuar me vitin 2022.

*Aktivitetet mbi forcimin e kapaciteteve në luftën kundër kriminalitetit me subjekte të posaçme pasive, viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunës seksuale dhe të miturit*

Në kuadër të rritjes së efektivitetit dhe forcimit të kapaciteteve në luftën kundër kriminalitetit me subjekte të posaçme pasive, viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunës seksuale dhe të miturit, Prokuroria e Përgjithshme ka mbështetur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe me shoqërinë civile, ku përmendim bashkëpunimin me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe Ambasadën e Mbretërisë së Hollandës, lidhur me projektin 3-vjecar, *"Angazhim Proaktiv për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje"*, si dhe projektin e mbështetur nga SIDA, në kuadër të të cilit është hartuar manuali për dhunën me bazë gjinore.

Ndër aktivitetet e zhvilluara përmendim:

- Trajnimin me temë, "Mbi përmirësimin e legjislacionit shqiptar në fushën e barazisë gjinore" me pjesëmarrjen e 15 koordinatorëve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe atyre në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Takimi për analizimin dhe diskutimin e "Raportit mbi ecurinë e zbatimit të akteve nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm që lidhen me viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, duke evidentuar progresin e bërë dhe hapësirat për përmirësime të mëtejshme në këtë aspekt'', aktivitet i organizuar në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm Korçë, me pjesëmarrjen e prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe koordinatorëve nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria Korçë si dhe përfaqësuesve nga shoqëria civile;
- Vizitë studimore tre ditore në Hagë, Hollandë me pjesëmarrjen e 6 prokurorëve dhe 1 koordinatori të viktimave;
- Trajnimi "Roli i policisë në zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur dhe ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", dhe "Dhuna seksuale online tek të miturit", organizuar në bashkëpunim me UNICEF;
- Kurs kombëtar për policimin gjinor në rastet e dhunës ndaj grave dhe vajzave, organizuar në datat 13-17 nëntor 2023, me pjesëmarrjen e 5 prokurorëve;

- Vizitë studimore me temë “Parandalimi dhe mbrojtja nga trafikimi i të miturve shqiptarë të pashoqëruar në Francë, organizuar nga shoqata “Terre des Hommes” në datat 23-24 nëntor, në Lion, Francë, me pjesëmarrjen e 2 prokurorëve;

- Panel diskutimi me temë "Sistemi i drejtësisë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore", organizuar nga Ministria e Drejtesisë së Kosovës, në datat 5-6 dhjetor, në Prishtinë, me pjesëmarrjen e 1 prokurori;

- Gjithashtu, nga Shkolla e Magjistraturës janë zhvilluar aktivitetet trajnuese, si vijojnë: - “Trafikimi i qenieve njerëzore”, ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë dhe 5 oficerë të policisë gjyqësore; - “Shfrytëzimi seksual online i të miturve dhe metodat e hetimit”, ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 6 oficerë të policisë gjyqësore; - “Vrasjet e grave (femicidi) dhe tentativat për femicid”, ku kanë marrë pjesë 9 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore.

- Koordinatorët e viktimave në Prokurorinë e Përgjithshme kanë hartuar një manual trajnimi mbi çështjen e dhunës me bazë gjinore. Në këtë manual trajtohen çështje mbi dhunën seksuale online tek të miturit dhe trajtimin e rasteve të abuzimit seksual online, teknika mbi intervistimin, vendosja e një komunikimi afatgjatë me viktimën e mitur si dhe trauma dhe efektet e saj. Për këtë manual janë trajnuar 16 koordinatorë të viktimave të të gjitha prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe 19 oficerë të policisë gjyqësore në prokurori. Në rrethet Fier dhe Sarandë në bashkëpunim me UNICEF Albania, u trajnuan edhe përfaqësues nga shkollat, njësitë për mbrojtjen e fëmijës dhe oficerë të policisë gjyqësore në polici.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, rekomandimin e rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, i konsiderojmë të zbatuara, për faktin se, është miratuar dhe zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 2/2023 dhe ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të;- udhëzimit të përgjithshëm nr. 17/2020 për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave; - udhëzimit të përgjithshëm nr. 8/2021 për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin. Për më tepër, treguesit statistikorë evidentojnë se politika penale e kërkesave të prokurorëve ka qenë e ashpër, si për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit të dënimit ndaj autorëve të veprave penale me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit, shfrytëzimit të fëmijëve. Ndërkohë, ndaj të miturve në konflikt me ligjin janë aplikuar masa më të zbutura si masat e sigurimit personal, ashtu dhe masat alternative të dënimit, siç janë: shmangia, ndërmjetësimi, këshillimi për të miturin apo familjen e tij dhe paralajmërimi me shkrim.

**1.3. Lidhur me rekomandimin 3 të Rezolutës** *“Të vijojë puna për vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”,* **që përkon edhe me rekomandimin prioritar 1 në drejtimin I të vendimit të Këshillit të Ministrave** *“Vijimin e masave me qëllim arritjen e funksionimit optimal të sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në Prokurori (sistemi CAMS), për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm për saktësinë e paraqitjes së këtyre të dhënave.”*, Prokuroria e Përgjithshme e ka konsideruar thelbësor për rritjen e eficiencës së punës, ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjes. Në objektivat e institucionit tonë dhe në kërkesat për bashkëpunim për ndërtimin e këtij sistemi, është krijimi i një sistemi që mundëson dixhitalizim të plotë të proceseve të punës, gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, ndërlidhje me baza të dhënash e çdo kërkese të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore. Për këtë qëllim, me urdhrin e Prokurorit të

Përgjithshëm nr. 04 datë 09.01.2023 u ngrit grupi i punës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes.

Në mbështetje të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, Bashkimi Evropian është angazhuar për të mbështetur financiarisht ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, dhe për këtë arsye, fondi i akorduar me buxhetin e vitit 2023 për fazën e parë të investimit nuk u përdor. Për sa më sipër, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 04, datë 04.01.2024 është ngritur grupi i ekspertëve mbështetës për sistemin e qendërzuar të çështjeve për të siguruar mbështetje dhe koordinim sa më efektiv të prokurorisë për realizimin e këtij projekti.

Ndërkohë është bashkërenduar puna me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe është hartuar korniza e ndërveprimit të sistemeve të reja të sistemit të drejtësisë (ku përfshihet edhe sistemi CAMS) e cila përfshin ndër të tjera ndërlidhjen e sistemeve elektronike të tyre ndërmjet njëri-tjetrit, por edhe me bazat e të dhënave shtetërore me protokolle informatike, për një komunikim sa më eficient dhe të sigurtë.

Lidhur me kërkesën për shpërndarjen elektronike të çështjeve, aktualisht, në zbatim të kritereve ligjore dhe përcaktimeve të udhëzimit nr. 3/2016, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori", i ndryshuar, prokuroria siguron që nëpërmjet përdorimit të sistemit CAMS të realizohet ndarja e rastësishme e çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, duke siguruar transparencë në shpërndarjen e çështjeve dhe garantim të pavarësisë e paanshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, edhe nëpërmjet këtij procesi. Nga ana tjetër, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit nr. 3/2016, si nëpërmjet kërkesave për informacion ashtu dhe nëpërmjet monitorimit të sistemit CAMS, me qëllim mbështetjen teknike të prokurorive.

Në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, shorti elektronik përdoret sistematikisht në bazë të regjistrimeve të kallëzimeve/referimeve që kryhen gjatë një dite, të cilat shortohen mes prokurorëve të seksionit ose prokurorisë përkatëse, sipas rastit. Shorti kryhet automatikisht sapo bëhet regjistrimi i kallëzimit/referimit penal në sistem, i cili nëpërmjet një algoritmi përzgjedh prokurorin në mënyrë të rastësishme, duke pasur parasysh dhe ngarkesën e prokurorëve të tjerë të seksionit apo të një prokurorie me numër të vogël prokurorësh, në rastet e prokurorive ku nuk ka seksione. Sistemi i ndan në numër të barabartë kallëzimet/referimet penale të regjistruara brenda një seksioni apo prokurorie të caktuara brenda një dite.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, i konsiderojmë të realizuara këto rekomandime, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet siç u shpjegua më sipër për vlerësimin e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike në zbatim të këtij rekomandimi dhe vijon puna për të realizuar ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në bashkëpunim dhe me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur nga partnerët tanë.

**1.4. Në zbatim të rekomandimit 4 të Rezolutës** *"Të vijojë puna e nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse"*, **që përkon me rekomandimin prioritar 9 në drejtimin III të vendimit të Këshillit të Ministrave** *"Përditësimin e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe aseteve të sekuestruara për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale."*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Sistemi e-tracking PRESTO, i krijuar me mbështetjen e Projektit Euralis V, ngritur me urdhrin nr. 92/2021 të Prokurorit të Përgjithshëm, për përfitimin e statistikave në kohë reale për hetimin dhe

ushtrimin e ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave, vijon të jetë në fokus mbikëqyrjeje dhe zhvillimi nga Prokuroria e Përgjithshme.

Nisur nga rëndësia e sistemit për identifikimin në kohë reale të çdo rasti të pastrimit të parave, qoftë procedim penal apo verifikim pasuror sipas ligjit anti-mafia, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi për administrimin elektronik të regjistrave procedural dhe përfitimin e një sistemi statistikor fleksibël, në kohë reale dhe me të dhëna gjithëpërfshirëse, për periudhën tranzitore deri në ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve, Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar dhe asistencën/ndihmën e projektit të Bashkimit Evropian, EU4FOCAL, "Lufta kundër krimit të organizuar në Shqipëri përmes hetimeve kriminale dhe financiare". Për sa më sipër, megjithëse gjetëm mbështetjen e tyre për të realizuar këtë investim para përfundimit të kohëzgjatjes së projektit, ky investim nuk u bë i mundur. Ndërkohë i kemi paraqitur të njëjtën kërkesë për mbështetje projektit EU4LEA.

Nga ana tjetër, ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2022, datë 06.09.2022, "Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr.10/2020", për sa i përket hedhjes në kohë reale të të dhënave në regjistrin elektronik të sistemit e-tracking PRESTO. Lidhur me këtë rekomandim që përkon dhe me zbatimin e planit të veprimit ICRG/FATF-Shqipëri, e konkretisht rezultatit immediat IO.7-1, lidhur me sistemin elektronik e-tracking PRESTO, Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2023 ka marrë masa administrative nëpërmjet nxjerrjes së tre qarkoreve drejtuar prokurorive, për të mundësuar pasurimin dhe përditësimin e të dhënave në sistemin elektronik dhe përftimin e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të besueshme në kohë reale. Për të garantuar mbarëvajtjen e tij teknike dhe funksionale ky sistem monitorohet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, i konsiderojmë pjesërisht të realizuara këto rekomandime pasi vijojnë përpjekjet për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të programit PRESTO për përfitimin e një sistemi të automatizuar statistikor për të gjithë veprat penale, deri në ngritjen e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve në prokurori.

**1.5 Lidhur me rekomandimin 5 të Rezolutës** "*Të përditësohet manuali për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FIIAPP. Të rritet efektiviteti i hetimeve financiare. Të trajnohen policia dhe prokurorët për të përmirësuar teknikat e hetimit financiar. Të rritet efektiviteti i hetimeve për çështjet e pastrimit të parave dhe të krijohet bashkëpunimi institucional ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme dhe zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për çështjen e monedhave të falsifikuara në vend*", **i cili përkon me rekomandimet e BE-së në Raportin për Shqipërinë[3] 08 Nëntor 2023, Kapitulli 24**, *"të vazhdojë zhvillimi i përdorimit sistematik të hetimeve financiare paralele kur kemi të bëjmë me ... trafikimin e paligjshëm, ... dhe pastrimin e parave"*, **dhe me rekomandimet prioritare 4, 5 në drejtimin II të vendimit të Këshillit të Ministrave** "*4. Rritjen e numrit të hetimeve financiare sistematike dhe hetimit financiar paralel për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura.", "5. Shtimin e rasteve të gjurmimit të produkteve të veprave penale/aseteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve, përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë.",* **rekomandimet prioritare 3, 4, 5 e 6 në drejtimin III të vendimit të Këshillit të Ministrave**, "*3. Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale dhe atë në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim; si dhe numrit të*

[3] Pika 2.2.2 Kapitulli 24, "Drejtësia, liria dhe siguria", Raporti për Shqipërinë 08.11.2023, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en.

*sekuestrimeve/konfiskimeve.”; “4. Vijimin e zbatimit të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust, si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore.”; “5. Marrjen e masave për rritjen e rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por dhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.”;“6. Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë së juridiksioneve të përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”,* **rekomandimet prioritare 1, 2 dhe 6 në drejtimin V të vendimit të Këshillit të Ministrave**, *“1. Forcimin e luftës kundër informalitetit, duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim, për grup veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse në luftën ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal dhe ndaj nëpunësve publikë të administratës tatimore dhe doganore.”, “2. Rritjen e numrit të hetimeve paralele financiare në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, si vepra penale që gjenerojnë të ardhura, gjurmimin e produkteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.”, “6. Rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e krimeve financiare, pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe për veprat penale të fushës së krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit.”,* janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.5.1. Në vijim të zbatimit të rekomandimit për përditësimin e një manuali për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadër të projektit FIIAPP, informojmë se “Manuali për Hetimin e Pastrimit të Parave” është në proces finalizimi. Në këtë manual ndër të tjera, është synuar të trajtohet qasja e mbajtur në udhëzimin nr. 10/2020, që në çdo hetim të veprave penale që sjellin të ardhura të paligjshme, ku padyshim ato që lidhen me korrupsionin, shpërdorimin e detyrës, shkeljen e barazisë në tendera apo ankande publike janë vepra që gjenerojnë fitime të larta, është thelbësore të kryhen hetime paralele financiare dhe pasurore, si për konstatimin e kryerjes së veprës penale, ashtu edhe për gjetjen e pasurive që lidhen me veprimtarinë kriminale të personave nën hetim, lidhjet e tyre familjare apo shoqërore që administrojnë pasuritë e dyshuara se rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Manuali është planifikuar për t’u prezantuar në prill të vitit 2024 dhe do të përfshihet si pjesë e trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

1.5.2 Në kuadrin e zbatimit të rekomandimeve për rritjen e efektivitetit të hetimeve financiare dhe forcimin e luftës kundër informalitetit ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar, dhe u është kërkuar prokurorëve rritje e mëtejshme e hetimeve financiare e pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive produkte të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente, bazuar në prova/rrethana fakti objektive sipas ligjit. Gjithashtu, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar në nivel qendror dhe në nivel vendor zbatimin e memorandumit shumëpalësh të bashkëpunimit për rritjen e efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve që priren të kryejnë evazion fiskal.

Për periudhën raportuese veçojmë dy raste ku prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë vijuar hetimin paralel financiar lidhur me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve dhe sipas rastit regjistrimin edhe të veprës penale të pastrimit të produkteve të këtyre veprave penale.

- Një procedim penal është dërguar për gjykim të për veprën penale të “Fshehjes së të ardhurave” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale” të parashikuar nga nenet

180/3 dhe 287/2 i Kodit Penal, ndaj 4 shtetasve shqiptarë dhe 9 të huaj, ku shuma totale e transaksioneve bankare të kryera nga llogaritë e 15 kompanive (shoqëri tregtare), me fushë operimi Call Center në zotërim të të pandehurve dhe të padeklaruara, është në total në vlerën 5,799,010 (euro).

- Gjithashtu, në kuadër të një procedimi për veprat penale "Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar" kryer në bashkëpunim, "Dhënia e informacioneve të rreme", "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve" kryer në bashkëpunim, "Fshehja e të ardhurave", parashikuar nga nenet 144/a dhe 25, 168, 190/2 dhe 180/ 1 i Kodit Penal, në korrik 2023 janë sekuestruar tre llogari bankare të një shoqërie tregtare në shumat; -1004474 (një milion e katër mijë e katërqind e shtatëdhjete e katër) Euro; - 299925 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzetë e pesë) Euro; -13588890 (trembëdhjetë milion e peseqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë.

- Po kështu në kuadër të një procedimi për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 190 dhe 143 të Kodit Penal, lidhur me lëshimin e faturave fiktive për rimbursim në mënyrë të kundraligjshme të TVSH nga shteti në vlerën e 20765411 lekëve, janë duke u hetuar 3 persona juridikë.

Referuar të dhënave statistikore për grupveprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, për vitin 2023, evidentohet se janë regjistruar 187 procedime penale dhe 55 të pandehur ose me ulje 40,26 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këto vepra krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar në gjykatë 63 çështje penale me 156 të pandehur ose krahasuar me vitin 2022 me ulje 25,88 % të numrit të procedimeve dhe rritje 33,33 % të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grupveprash.

Ndërsa, referuar të dhënave statistikore për grupveprat penale në lidhje me krime në fushën e doganave, për vitin 2023, evidentohet se janë regjistruar 242 procedime penale dhe 211 të pandehur ose me ulje 6,56 % e numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar në gjykatë 164 çështje penale me 217 të pandehur ose me rritje 22,39 % e numrit të procedimeve dhe rritje 14,21 % e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grupveprash krahasuar për vitin 2022.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve në përmirësimin e veprimtarisë hetimore lidhur me këto vepra, përmendim edhe trajnimet "Veprat penale në fushën e tatimeve", ku kanë marrë pjesë 15 prokurorë dhe 17 oficerë të policisë gjyqësore, si dhe "Përgjegjësia penale e personit juridik", ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore.

1.5.3 Lidhur me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve për të përmirësuar teknikat e hetimit financiar, Prokuroria e Përgjithshme rritjen profesionale të prokurorëve e ka vlerësuar si domosdoshmëri për forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm e për këtë ka bashkërenduar me Shkollën e Magjistraturës apo projekte të ndryshme për aktivitete trajnuese e kontribute në kuadër të trajnimit të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore të seksioneve.

Ka vijuar bashkëpunimin me Projektin Eu4Focal, për mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale fokusuar në seksionet e posaçme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, ngarkuar me hetimin e ndjekjen penale në fushën e hetimit financiar dhe të pastrimit të parave.

Në kuadrin e këtij projekti, përveç asistencës për përgatitjen e manualit për pastrimin e parave (i sipërcituar), përmendim disa aktivitete të tjera si:

- Seminar mbi "Pastrimin e Parave, hetimin financiar dhe asistencën e ndërsjellë juridike", organizuar në rrethet Tiranë, Berat, Shkodër me pjesëmarrjen e 18 prokurorëve, 15 oficerëve të policisë gjyqësore;
- "Kriptomonedhat një formë e re krimi e kryer nëpërmjet internetit", trajnim i organizuar në datat, 22-23 Shkurt 2023, Tiranë me pjesëmarrjen e 15 prokurorëve dhe 16 oficerëve të policisë gjyqësore;

- “Forumi i parë mbi Sistemet e Rikuperimit të Aseteve”, organizuar në Romë në datat 27-28 shkurt 2023. Aktivitete të tjera në këtë drejtim përmendim; - dy trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, “Veprat penale në fushën e tatimeve”, ku kanë marrë pjesë 15 prokurorë dhe 17 oficerë të policisë gjyqësore, si dhe “Përgjegjësia penale e personit juridik”, ku kanë marrë pjesë 10 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore; - Seminar mbi raste studimore të parazgjedhura për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale për Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e Përgjithshme/Prokuroritë Tiranë, Durrës dhe Vlorë organizuar nga projekti EU4LEA në kuadër të “ligjit antimafia”, me pjesëmarrjen e 15 prokurorëve dhe 7 oficerëve të policisë gjyqësore;

1.5.4 Prokuroria e Përgjithshme për një periudhë tre vjeçare është angazhuar intensivisht në plotësimin e detyrimeve institucionale në zbatim të Planit të Veprimit të ICRG/FATF për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke e konsideruar si një objektiv të sajin prioritar. Në këtë këndvështrim, gjatë kësaj periudhe është rritur dukshëm numri i ndjekjeve penale për veprat penale të pastrimit të parave si dhe cilësia në hetimin e këtyre veprave penale, janë rritur dënimet dhe konfiskimet lidhur me produktet e veprës penale, veçanërisht në rastet që përfshijnë vepra penale të huaja ose pastrimin e parave lidhur me palët e treta, janë trajtuar në kohë kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe është konsoliduar sistem i menaxhimit të çështjeve të pastrimit të parave me të dhëna të përditësuara. Këto arritje janë evidentuar si të “adresuara gjerësisht”, në të gjitha takimet dhe seancat plenare sidomos të vitit 2023, nga grupi i ekspertëve të ICRG/FATF. Një arritje pozitive në funksion të rritjes së cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale në fushën e pastrimit të parave financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe procedimeve/hetimeve pasurore paralele ka ardhur dhe si rrjedhojë e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese e konkretisht mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave,etj.

Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerra në këtë periudhë ka normuar dhe unifikuar masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, në funksion të rritjes së efektivitetit në hetimet pasurore dhe financiare paralele, për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale. Për këto është kërkuar informacion në vijimësi nga strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshshme. Gjithashtu theksojmë se këto akte të politikave institucionale dhe ndërinstitucionale kanë krijuar një bazë solide për rritjen e efektivitetit në kryerjen e gjurmimit, hetimit dhe ndjekjes penale të këtyre veprave, pasi këto akte krijuan korniza për ngritjen e 7 (shtatë) seksioneve të veçanta dhe caktimin e prokurorëve të dedikuar (44 prokurorë) në prokuroritë vendore të juridiksionit të përgjithshëm, rritjen e kapaciteteve dhe në seksionet e veçanta të drejtorive të policisë vendore, forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese.

Rezultat i masave tre vjeçare të finalizuara në vitin 2023 është progresi në zbatimin e rezultateve imediate të planit të veprimit, ku veçojmë:

- Plotësimi dhe konsolidimi i sistemit elektronik e-tracking PRESTO i menaxhimit të çështjeve të pastrimit të parave me të dhëna të përditësuara të të gjithë prokurorive, në zbatim të rezultatit imediat (IO.7 pika 1) të planit të veprimit. Këto tregues janë vlerësuar vazhdimisht nga grupi i ekspertëve të FATF/ICRG gjatë të gjithë periudhës raportuese dhe janë konsideruar të adresuara gjerësisht (mbi nivelin e gjendjes “zonë gri”).
- Rritje dukshëm e efektivitetit në hetimin, ndjekjen penale, sekuestrimin e pasurive, dhe numrin e akuzave të ngritura me kërkesat për gjykim për pastrimin e parave të dërguara në gjykatë, si dhe rritja dukshëm e dënimeve penale dhe konfiskimeve të pasurive në zbatim të rezultateve (imediate IO.7 pika 2) të planit të veprimit.

- Rritje dukshëm e hetimeve financiare paralele ose procedime/hetime pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve kriminale, sipas tipologjive me vepra penale të huaja, bazuar në rrethana fakti objektive, në zbatim të (rezultatit imediat IO.8) të planit të veprimit.

Në seancën plenare të FATF, në Paris, shkurt 2023, Shqipëria ndër të tjera, është vlerësuar, se ka ndërmarrë hapa drejt përmirësimit të regjimit të saj në luftën kundër PP/FT, duke përfshirë një rritje domethënëse në numrin e rasteve të regjistruara të pastrimit të parave, veçanërisht ato që rrjedhin nga vepra të huaja ku janë pastruar të ardhurat kriminale në Shqipëri. FATF ka bërë përcaktimin fillestar se Shqipëria ka përfunduar në mënyrë thelbësore planin e saj të veprimit dhe vlerëson punën e Shqipërisë për të adresuar mangësitë e saj strategjike.

Në seancën plenare të FATF, zhvilluar në datë 27 tetor 2023 në Paris, është vendosur dalja e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, e njohur si "lista gri". Ky rezultat ka ardhur ndër të tjera nëpërmjet reformave dhe politikave të zbatuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe veçanërisht si rezultat i gadishmërisë për bashkëpunim, transparencës së treguar dhe rezultateve tepër pozitive të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në hetimin e pastrimit të parave. Për këtë Shqipëria nuk do t'i nënshtrohet më monitorimit të shtuar të FATF.

Rezulti i këtyre masave është progresi i evidentuar me rritjen e efektivitetit në hetimet për veprat penale të pastrimit të parave të parashikuara nga nenet 287 e 287/b të Kodit Penal.

Të dhënat statistikore të vitit 2023 tregojnë se për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal, janë regjistruar 158 procedime penale të reja dhe 15 të pandehur, ndërkohë 14 procedime me 27 të pandehur u dërguan për gjykim dhe 22 të pandehur rezultojnë të dënuar. Në këtë periudhë vetëm për veprën penale të pastrimit të parave sipas nenit 287 të Kodit Penal janë regjistruar 156 procedime të reja me 11 të pandehur, dhe 11 procedime me 16 të pandehur janë dërguar për gjykim.

Hetimet financiare dhe pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë

i) Në vitin 2023 në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" sipas nenit 287 të K.Penal dhe për vepra të tjera penale të lidhura me to, në zbatim te nenit 36 të Kodit Penal dhe neneve 274 dhe/ose 210, 190 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, mbi kërkesat e prokurorëve gjykatat kanë vendosur: -konfiskime pasurie/aseteve kriminale në kuadrin e 6 çështjeve, numër i njëjtë me vitin 2022 , dhe -sekuestrime pasurie/aseteve kriminale në kuadrin e 24 çështjeve, nga 18 për vitin 2022.

ii) Në këtë periudhë, në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", në kuadrin e procedimeve/hetimeve pasurore, mbi kërkesat e prokurorëve gjykatat kanë vendosur: -8 konfiskime pasurie/asete kriminale dhe -10 sekuestrime pasurie/asete kriminale nga 7 në vitin 2022.

Për periudhën raportuese, Prokuroria e Përgjithshme ka përgatitur periodikisht kontribute institucionale të progresit dhe është përfaqësuar në 4 takime të GNPIE për zbatimin e Planit të Veprimit dhe në mbledhjet e grupit të ekspertëve ndërinstitucional të Komitetit të Bashkëpunimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave si dhe në 2 takime me ekspertët e ICRG/FATF. Në datën 17.07.2023, Prokuroria e Përgjithshme organizoi një takim ndërinstitucional me objekt diskutimi masat institucionale për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga vizita e ekspertëve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF, rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet masave monitoruese dhe koordinuese, analizave të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit, rritjen e bashkëpunimit në drejtim të shtimit të numrit të hetimeve proaktive.

1.5.5 Në kuadrin e rekomandimit për bashkëpunim me Eurojust, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar ndërveprimin për rritjen e eficencës në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të huaja në

fushën penale për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj.

Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent[4] ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, nëpërmjet veprimtarisë të Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, prania e të cilës ka vijuar konsolidimin e përvojës dhe kapaciteteve, në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritet gjyqësore të vendeve evropiane dhe të vendeve të rajonit. Referuar të dhënave nga Zyra e Prokurorit Ndërlidhës Shqiptar në Eurojust, për vitin 2023, janë mbështetur nga Eurojust 5 skuadra të përbashkëta hetimore të reja, dhe 17 skuadra të përbashkëta hetimore me autoritetet gjyqësore të huaja, që vijojnë punën e nisur në vitet e mëparshme. Shqipëria ka marrë pjesë në 22 mbledhje koordinuese, si organizuese në 3 prej tyre dhe e ftuar në 19 mbledhje të organizuara nga shtete të tjera.

1.5.6 Në janar 2023, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit "Për rritjen e eficencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë". Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme si përfaqësuese në nivel qendror, ka shkëmbyer informacion periodik me Bankën e Shqipërisë lidhur me objektin e marrëveshjes. Sa i përket të dhënave statistikore rezulton se numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale "Falsifikimi i monedhave", parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal ka ardhur në ulje, ku vërehet se janë regjistruar 23 procedime dhe 9 të pandehur gjatë vitit 2023, nga 42 procedime penale dhe 20 të pandehur të regjistruar në vitin 2022.

1.5.7 Në kuadrin e rekomandimit dhe në përmbushje të rekomandimeve të BE-së, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar ndërveprimin për rritjen e eficencës në bashkëpunimin me autoritetet e tjera, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj. Në këtë kuadër, në datën 17.07.2023, Prokuroria e Përgjithshme organizoi edhe takimin ndërinstitucional me objekt diskutimi masat institucionale për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga vizita e ekspertëve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF, rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet masave monitoruese dhe koordinuese, analizave të përbashkëta dhe shkëmbimit të informacionit, rritjen e bashkëpunimit në drejtim të shtimit të numrit të hetimeve proaktive.

1.5.8 Në kuadrin e këtij rekomandimi dhe në vijim të aktiviteteve dhe masave të marra në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve të tjera që gjenerojnë të ardhura/produkte nga veprimtaria kriminale ritheksojmë se në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", prokurorët janë udhëzuar për rritjen e rolit aktiv në hetimet paraprake, dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, dhe veçanërisht kundër pastrimit të parave. Prokurorët, për 2023 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 394 procedime penale vetëm në lidhje me veprat penale: prodhimi dhe shitja e narkotikëve; trafikimi i narkotikëve; kultivimi i bimëve narkotike; trafikimi i armëve e

[4] Shih, "Marrëveshjen për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST", të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 113/2018, në nenin 4 pika 1 parashikon: "*1.Autoriteti kompetent i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë.*"

municioneve; mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit; pastrimi i parave, ndihma për kalim të paligjshëm të personave. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 325 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, i konsiderojmë të zbatuara këto rekomandime për faktin se, ka vijuar bashkëpunimin me Projektin EU4FOCAL për përfundimin e draft manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve dhe pritet promovimi i tij, evidentohen arritje, si në vijimin e zbatimit të politikave dhe masat administrative e procedurale institucionale dhe ndërinstitucionale, ashtu dhe forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale si dhe bashkëpunimit me institucione e agjenci ligjzbatuese vendase, rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale të pastrimit të parave, që kanë sjellë rritje të sekuestrimeve/konfiskimeve për veprën penale të pastrimit të parave dhe vepra penale të tjera të lidhura me të, përmbushja e të cilëve mundësoi vlerësimin pozitiv të Shqipërisë nga Komisioni i Ekspertëve të KiE-së Moneyval duke u konsideruar të adresuara gjerësisht, dhe u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit "Për rritjen e eficiencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë", me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër falsifikimit të monedhave, si një çështje me rëndësi të veçantë në kuadër të integrimit evropian të vendit.

**1.6 Në zbatim të rekomandimit 6 të Rezolutës** *"Të raportohet mbi gjetje, problematika dhe rekomandime për zbatimin e hartës së re gjyqësore brenda muajit dhjetor"*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi, në vitin 2023, Prokuroria e Përgjithshme është përfshirë dhe angazhuar në fazën e zbatimit të hartës së re gjyqësore në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Ministrinë e Drejtësisë. Për të unifikuar veprimtarinë procedurale dhe mirërregulluar aktivitetin administrativ institucional u synua ndërhyrja me akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjatë vitit 2023, grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 84, datë 15.11.2022 të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ndjekur mbarëvajtjen e procesit dhe ka propozuar marrjen e masave administrative të nevojshme në mënyrë që bashkimi i prokurorive dhe mbarimi juridik/mbyllja e disave prej tyre, të bëhej në një kohë sa më të shpejtë e duke zgjidhur çdo problematikë të mundshme.

Për shkak të pluralitetit të çështjeve të nevojshme që kërkonin zgjidhje, në fokus të angazhimit institucional ka qenë veçanërisht:

- Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve, pa cenuar të drejtat e subjekteve procedurale dhe aksesin e qytetarëve. Në kuadër të zbatimit të udhëzimit nr. 1, datë 26.01.2023 "Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm", u identifikuan, administruan dhe inventarizuan aktet, dokumentet, regjistrat dhe arkivat për të mundësuar funksionimin sa më të shpejtë me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të personave nën hetim, të pandehurve e viktimave në procesin penal, ruajtjen e sekretit të hetimeve apo ndalimin e publikimit të akteve procedurale penale, sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve për publikun në prokurori, sipas afateve e kritereve ligjore të përcaktuara;
- Planifikimi i burimeve njerëzore nëpërmjet ndryshimeve në strukturat organike, për të siguruar shpërndarjen e numrit të nevojshëm të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit mbështetës në mënyrë që të garantohet ngarkesë sa më propocionale e punës;

- Transferimi/bashkimi i shërbimeve aseteve informatike për gjithë prokuroritë, duke garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e tyre nga humbja, aksesi i të tretëve, vijimin e shërbimeve, si dhe monitorim të vazhdueshëm të aspekteve të sigurisë në prokuroritë e të gjitha niveleve;
- Sigurimi i kapaciteteve akomoduese. Në këtë drejtim, është punuar për vënien në dispozicion të ambienteve të nevojshme për krijimin e kushteve të punës që t'i përgjigjet shtimit të stafit në prokuroritë respektive. Kështu, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, kanë vijuar punimet në kuadër të investimit për shtimin e një kati ndërtese i cili do të krijojë hapësira të nevojshme për akomodimin e të gjithë stafit të kësaj prokurorie. Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, i është kërkuar Bashkisë Fier marrja në administrim e një godine tjetër. Ka përfunduar detyra e projektimit nga Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorinë Tiranë, për ndërtimin e një godine të re akomodimi për të gjitha institucionet e sipërcituara. Pas vënies në dispozicion nga Bashkia Tiranë të një sheshi ndërtimi do të vijohet me hartimin e projektit;

Në vijim, kërkohet angazhimi i Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e marrëveshjes ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për vënien në dispozicion të ambienteve akomoduese shtesë/ndërtesa ekzistuese të cilat më pas do t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe përshtatjes, për prokuroritë dhe gjykatat në rrethet Gjirokastër, Vlorë dhe Durrës, pasi ndërkohë që Prokuroria e Përgjithshme ka realizuar detyrimet e saj sipas marrëveshjes, nga ana e palëve të tjera nuk janë respektuar detyrimet e ndërmarra.

Ky ristrukturim vlerësojmë se do t'i shërbejë më mirë shpërndarjes së ngarkesës, organizimit në seksione dhe specializimit të prokurorëve veçanërisht për vepra penale komplekse apo me viktima vulnerabël, si dhe administrimit më të mirë të burimeve financiare dhe njerëzore.

Ndërkohë që sigurimi i ambienteve të nevojshme për akomodimin e punonjësve, sigurimi i standardeve ndërkombëtare në infrastrukturë dhe teknologji për intervistimin e miturve dhe viktimave të krimit, si dhe sigurimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në cilëndo pozitë në procesin penal, janë ndër çështjet më të rëndësishme dhe në fokus të objektivave në vijim.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim të rezolutës dhe njëkohësisht objektiv prioritar i prokurorisë, për faktin se Prokuroria e Përgjithshme dhe të gjithë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, nëpërmjet akteve nënligjore dhe bashkëpunimit institucional dhe ndërinstitucional siguruan që periudha kalimtare të mos ndikonte në proceset hetimore duke vijuar veprimtarinë institucionale.

**1.7 Në zbatim të rekomandimit 7 të rezolutës,** "*Të punohet për të siguruar aksesin e drejtpërdrejtë në regjistrin elektronik të abonentëve celularë dhe adresat IP nga ana e ofruesve të shërbimit të internetit (jo vetëm në 40 regjistrat kombëtarë) për lehtësimin e hetimeve*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Për shkak të rëndësisë dhe rolit që kanë komunikimet elektronike midis personave në provueshmërinë e elementeve të veprave penale, aksesi i drejtëpërdrejtë në këto të dhëna nga prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, vlerësohet shumë i rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe shpejtësisë të hetimeve, në veçanti për rastet e krimeve të rënda, duke i shërbyer uljes së ngarkesës, respektimit të afateve dhe uljes së kostos së hetimit.

Në kuadrin e zbatimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Përgjithshme ndërmori iniciativën për nisjen e procesit të bashkëpunimit me dy shoqëri telefonike për sigurimin e aksesit në regjistrin elektronik të abonentëve celularë dhe adresat IP.

Për sa më sipër janë realizuar dy takime ndërmjet palëve ku është diskutuar mbi kuadrin normativ dhe mundësitë teknike për arritjen e formalizimit të një memorandumi bashkëpunimi.

Lehtësimi i aksesit të prokurorëve në bazat e të dhënave/regjistrave elektronikë shtetërore e private, është prioritet i politikës institucionale të Prokurorisë së Përgjithshme duke u vlerësuar si mjet i rëndësishëm në grumbullimin e të dhënave elektronike në hetimin e veprave penale.

Gjatë kësaj periudhe është dakordësuar në parim dhënia e aksesit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit "Për dhënien e të drejtës së aksesit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Prokurorisë së Përgjithshme". Prokuroria e Përgjithshme në muajin prill 2023, ka përcjellë pranë këtij institucioni listën me të dhënat e 14 përdoruesve dhe vijon të jetë në pritje të përfundimit të procesit të konfigurimeve teknike nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për dhënien e këtij aksesi.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 28.10.2020, "Për rregullat për përmbajtjen, formën e Regjistrit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara", Prokuroria e Përgjithshme ka të drejtën e marrjes së informacionit të drejtpërdrejtë dhe statistikave raportuese të bazës së të dhënave të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Në vijim të komunikimeve me këtë institucion, janë përcjellë pikat e kontaktit/përdorues dhe jemi në pritje të procedurave teknike.

- Përmbushjen e detyrave në kuadër të rekomandimit të rezolutës dhe prioriteteve institucionale, i konsiderojmë të realizuara pjesërisht pasi edhe pse janë ndërmarrë masa për sigurimin e aksesit të prokurorisë në bazat e të dhënave, Prokuroria e Përgjithshme e konsideron këtë angazhim në proces.

**1.8 Në zbatim të rekomandimit 8 të Rezolutës** *"Të rritet shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira (agjencitë ligjzbatuese, prokuroria dhe sistemi gjyqësor) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit,"*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi të rezolutës, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar ndërveprimin për rritjen e efiçencës në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të huaja në fushën penale për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, trafikimin e armëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj.

Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, nëpërmjet veprimtarisë të Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, prania e të cilës ka vijuar konsolidimin e përvojës dhe kapaciteteve, në drejtim të bashkëpunimit, koordinimit të hetimeve dhe shkëmbimit të shpejtë të informacionit me autoritet gjyqësore të vendeve anëtare/evropiane dhe të vendeve të rajonit.

Prokuroria e Përgjithshme ka përmbushur detyrimet institucionale në kuadrin e zbatimit të Udhërrëfyesit Rajonal mbi Armët e Vogla dhe të Lehta 2019-2024, nëpërmjet dhënies së kontributit institucional për përgatitjen e progresit në zbatimin e planit të veprimit të Udhërrëfyesit Rajonal dhe pjesëmarrjes aktive të përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme në takimet periodike, të Grupit Lokal të Koordinimit dhe të Grupeve të Koordinimit Rajonal për zbatimin e Udhërrëfyesit në vendet e Ballkanit Përendimorë.

Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar ndërveprimin për rritjen e efiçencës në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të huaja në fushën penale për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale

që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, trafikimin e armëve, trafikimin e qenieve njerëzore, etj.

Lidhur me veprën penale të "Trafikimit të armëve dhe i municionit", parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2023, janë regjistruar 21 procedime penale dhe 9 të pandehur. Duke i krahasuar me vitin 2022 konstatohet një rritje nga 10 procedime penale të regjistruara në vitin 2022 në 21 procedime për vitin 2023 (2,1 herë), rritje nga 3 në 9 e numrit të pandehurve të regjistruar, si dhe rritje nga 1 në 3 i numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këtë vepër.

Lidhur me veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore për vitin 2023 rezulton se janë regjistruar 337 procedime dhe 261 të pandehur, ndërkohë që 209 procedime me 230 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2022 vihet re rritje prej 2,74 % e numrit të procedimeve të regjistruara, ulje prej 0,95 % e numrit të procedimeve të dërguara për gjykim, si dhe ulje 11,54 % e numrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër. Sa i përket politikës penale lidhur me këtë vepër, 91,76 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi janë kërkesa për masa sigurimi "arrest me burg". Lidhur me kërkesat për caktimin e dënimit, për vitin 2023 kërkesat për caktimin e dënimit me burg përbëjnë 96,30 % të numrit total të kërkesave të prokurorit dhe vetëm 3,70 % janë kërkesa për dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për vetëm 34,62 % të të pandehurve.

Në kuadrin e aktiviteteve të organizuara nga UNODC lidhur me trafikimin e armëve apo personave, përmendim:

- Trajnim me temë "Kundër trafikimit të armëve të zjarrit në pakot postare", organizuar nga UNODC Global Firearms Programme, në datë 21 Mars 2023 në Prishtinë me pjesëmarrjen e 2 prokurorëve;
- Seminari Rajonal i UNODC-së, në kuadër të Konventës kundër Terrorizmit Bërthamor, organizuar në datat 21-23 mars 2023 në Vjenë me pjesëmarrjen e një prokurori;
- Trajnim me temë "Rritja e reagimit të strukturave të drejtësisë mbi identifikimin e provave në çështjet e hetimit të trafikimit të personave në Europën Juglindore", organizuar në datat 4-6 prill 2023 në Shkup, me pjesëmarrjen e një prokurori.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të përmbushur këtë rekomandim të rezolutës, për faktin se, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 treguesit statistikorë për veprat penale në fushën e armëve pa leje, në kompetencë hetimi nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, evidentojnë se politika penale e kërkesave të prokurorëve ka qenë e ashpër, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe në caktimin e llojit dhe masave të dënimit ndaj autorëve të veprave penale në fushën e armëve pa leje.

**1.9 Në zbatim të rekomandimit 9 të rezolutës,** *"Të rriten kapacitetet institucionale dhe profesionale në prokurori, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet përdorimit të rrjetit të pikave të kontaktit, të ngritur në zbatim të Konventës së KiE-së për krimin kibernetik për të rritur efektivitetin në luftën kundër krimit kibernetik dhe mashtrimit në internet."*, **që përkon me rekomandimin 4 në drejtimin V të vendimit të Këshillit të Ministrave** *"Rritjen e vëmendjes në lidhje me veprat penale të krimit kibernetik, thelbësore si pjesë e masave për sigurinë kibernetike të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave"*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e zbatimit të këtij rekomandimi, Prokuroria e Përgjithshme i ka kushtuar një rëndësi të veçantë veprave penale në fushën e krimit kibernetik, nisur nga përhapja dhe sofistikimi i formave të kriminalitetit si pasojë e zhvillimeve teknologjike. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve, udhëzimi

nr. 2/2023, vendos në fokus të tij marrjen e masave për pjesëmarrje në trajnime dhe inkurajimin e trajnimeve të përbashkëta dhe tryeza diskutimesh me institucione ligjzbatuese.

Për sa më sipër mbi pjesëmarrjen e prokurorëve në aktivitete trajnuese për këtë periudhë rezulton si vijon:

- Pjesëmarrje e dy prokurorëve në Samitin e nivelit të lartë për luftën kundër krimit kibernetik në Evropën Juglindore, organizuar në Kroaci në datat 21-23 maj 2023;
- Trajnim mbi krimin kibernetik dhe e-evidence, organizuar në datat 9-10 maj, në Lisbonë, Portugali dhe në datat 28-29 shtator në Sofie, Bullgari me pjesëmarrjen e një prokurori;
- Trajnim lidhur me krimin kibernetik, organizuar nga i-Proceeds, në datat 11-12 prill në Vjenë, me pjesëmarrjen e një prokurori;
- Nga Shkolla e Magjistraturës janë zhvilluar në tre sesione trajnime lidhur me "Krimin kibernetik", ku kanë marrë pjesë 46 prokurorë dhe 36 oficerë të policisë gjyqësore.

Lidhur me rritjen e bashkëpunimin nëpërmjet përdorimit të rrjetit 24/7 në zbatim të Koventës së KiE për krimin kibernetik, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 8888, datë 25.04.2002 "Për ratifikimin e Konventës për krimin në fushën e kibernetikës", në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është caktuar një pikë kontakti e cila punon 24 orë, me bazë 7 ditë në javë dhe siguron dhënien e ndihmës së menjëhershme për qëllimet e hetimeve ose gjykimeve për veprat penale në lidhje me sistemet dhe të dhënat kompjuterike ose për marrjen e provave në formë elekronike për një vepër penale. Prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në varësi të çështjeve që kanë në hetim, kanë vijuar të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këtë pikë kontakti për të siguruar ndihmë teknike, informacion të siguruar nga pika kontakti të shteteve të tjera për marrjen e provave, sigurim informacioni për vendndodhjen e personave të dyshuar, si dhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm për hetimin.

Për sa më sipër, të dhënat statistikore për grupveprat penale të krimit kibernetik, gjatë vitit 2023 rezultojnë me rritje prej 22,35 % të numrit të procedimeve të regjistruara, nga 255 në 312 procedime penale. Në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi, ndihma e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja, është shumë e rëndësishme në hetimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimit të krimit kibernetik. Nga të dhënat statistikore rezultojnë 83 kërkesa për ndihmë juridike gjatë vitit 2023, 64 prej të cilave janë letërporosi për jashtë.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të përmbushur këtë rekomandim të rezolutës, për faktin se, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 treguesit statistikorë për veprat penale në fushën e krimit kibernetik evidentojnë se politika penale e kërkesave të prokurorëve ka qenë e ashpër, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe në caktimin e llojit dhe masave të dënimit ndaj autorëve të veprave penale në fushën e krimit kibernetik.

**1.10 Në zbatim të rekomandimit 10 të Rezolutës** *"Të vijojë forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në lidhje me: i. kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, si dhe ii. për shkelje individuale të magjistratëve"*, që lidhet edhe me **rekomandimin prioritar 2 në drejtimin I të vendimit të Këshillit të Ministrave,** "*Marrjen e masave procedurale dhe administrative për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve; si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit.*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

1.10.1 Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, normohet nëpërmjet përcaktimeve ligjore të neneve 38, pika 2, shkronja "i" dhe 106 të ligjit nr.

97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 204 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe neneve 119 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Bazuar në këtë kuadër ligjor, me qëllim forcimin e mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në përputhje me angazhimet e ndërmarra me marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 248 prot., datë 05.02.2021 “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Prokurori i Përgjithshëm, ka propozuar inspektime tematike dhe ka përcjellë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë çdo rast për të cilin ka patur dyshim të arsyeshëm bazuar në të dhëna të besueshme për shkelje disiplinore nga ana e magjistratëve.

Në përmbushje të rekomandimit për forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit në kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike për arritjen e standardeve të unifikuara në zbatimin e ligjit gjatë ushtrimit të funksionit, veçanërisht zbatimin e udhëzimeve me karakter të përgjithshëm për respektimin e garancive procedurale në procesin penal, në kushtet kur prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, gjatë vitit 2023 ishin në proces riorganizimi për shkak të hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore, u vlerësua propozimi i dy inspektimeve tematike objekti i të cilave i shërben si rritjes së përgjegjshmërisë së prokurorëve, ashtu edhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë penale, konkretisht: i) respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të krimeve seksuale dhe dhunës në familje; ii) zbatimi i masës së shmangies nga ndjekja penale, zbatimi i masave të sigurimit dhe dënimit për të mitur.

Prokurori i Përgjithshëm ka normuar me udhëzime të përgjithshme dhe urdhra administrativë këto çështje, dhe mbikëqyr nëpërmjet kërkesave për informacion mënyrën si respektohet zbatimi i detyrimeve ligjore dhe atyre që rrjedhin nga këto udhëzime të përgjithshme. Respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të krimeve seksuale dhe dhunës në familje, përfshihet në objektin e udhëzimit nr. 5/2018, ashtu dhe të udhëzimit nr. 17/2020. Ndërkohë lidhur me zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale, zbatimin e masave të sigurimit dhe dënimit për të mitur në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, një ligj i ri në përputhje me standardet e normat ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit, në zbatim të të cilit ishin të nevojshme për t’u ndërmarrë një sërë masash me karakter organizativ dhe normativ, nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm është disponuar me aktet nënligjore përkatëse ku veçojmë urdhrin nr. 124/2020 “Krijimi i një regjistri të posaçëm në prokuroritë e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm”; urdhrin nr. 87, datë 28.07.2021 “Për miratimin e rregullave për përdorim të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”; udhëzimin e përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”.

Një vend të rëndësishëm në garantimin e efektivitetit të sistemit dhe përgjegjësisë së prokurorëve, sigurisht e zë ngarkesa e punës, ku për shkak të mungesës reale të 36,33 % të numrit organik të prokurorëve për shkak të mbarimit të statusit, pezullimit ose komandimit në institucione të tjera, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një prokuror mban ngarkesën e 1,6 prokurorëve. Për Prokurorin e Përgjithshëm marrja e masave për të ulur efektin negativ të mbingarkesës disa vjeçare të punës, nëpërmjet studimit të strukturave organike, caktimit të burimeve njerëzore në ndihmë të prokurorëve (oficerë të policisë gjyqësore e sekretarë), mbështetja me aksesin në bazat e të dhënave dhe udhëzime e manuale për hetimin e veprave të caktuara penale, ka qenë e vijon të jetë prioritet.

1.10.2 Sa i përket rekomandimit për të vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për shkelje individuale të magjistratëve, Prokurori i Përgjithshëm, në zbatim të kompetencave kushtetuese e ligjore, për shkelje individuale të konstatuar për një magjistrat/gjyqtar pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm ka dërguar kërkesë për inicim të procesit të hetimit/inspektimit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ndërkohë, ankesa e një shtetasi e ardhur në Prokurorinë e Përgjithshme në qershor 2023, me pretendimin për shkelje të ligjit nga një magjistrat/prokuror pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, i është dërguar për vlerësim Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

1.10.3 Lidhur me rekomandimin për garantimin e paanshmërisë së prokurorëve, Prokurori i Përgjithshëm në nxjerrjen/miratimin e udhëzimit nr. 2/2023, dhe në çdo akt nënligjor dhe dokument të politikave institucionale, vendos në themel të ushtrimit të funksionit të prokurorit, pavarësinë e tij të brendshme e të jashtme të sanksionuar mbi të gjitha si parim kushtetues. Këto akte me parashikimet e tyre, i drejtohen vetë prokurorëve për të mbrojtur e ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimarrjen e tyre, dhe garantojnë dhe synojnë që ushtrimi i funksioneve nga prokurori më i lartë apo nga çdo hallkë e sistemit të prokurorisë të respektojë pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave lidhur me hetimin e ndjekjen penale, sipas ligjit.

Nga ana tjetër, edhe garantimi i paanshmërisë është parim thelbësor për sistemin e drejtësisë. Sistemi ynë ligjor parashikon një sërë mekanizmash dhe aktorësh për mbrojtjen ligjore të këtij parimi. Legjislacioni procedural penal detyron prokurorin, të heqë dorë në rastet e parashikuara në ligjin procedural dhe drejtuesin e prokurorisë, të vendos mbi zëvendësimin e prokurorit në rastet dhe sipas procedurës së parashikuar në ligj. Po kështu, nëpërmjet përgjegjësisë disiplinore dhe vlerësimit profesional, ligji ka sanksionuar se shkelja e këtij parimi nuk tolerohet. Prokurori i Përgjithshëm vlerëson se trajnimet mbi paanësinë dhe integritetin dhe mbi parimet e etikës së prokurorit, ndarja e praktikave më të mira apo diskutime të vendimeve të gjykatave kombëtare e ndërkombëtare që trajtojnë këto parime, janë qasje për forcimin e integritetit dhe paanësisë së prokurorit dhe sistemit si një i tërë, paralelisht me mbikëqyrjen e kontrollin sipas kompetencave kushtetuese e ligjore të institucioneve të ngarkuara.

Për sa u trajtua, zbatimi, dhe mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, merr një rëndësi të veçantë, ku veçanërisht udhëzimi nr. 12, datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", i ndryshuar, udhëzimi nr. 3/2016, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori", i ndryshuar, dhe udhëzimet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve vjetore, janë në vazhdueshmëri pjesë e masave të planit të veprimit në zbatim të rekomandimeve prioritare.

Prokuroria e Përgjithshme, ka mbikëqyrur udhëzimet e përgjithshme nëpërmjet kërkesave për informacion, dhe jo vetëm, paraqitjes së raporteve vjetore mbi ecurinë e punës në secilën prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe pjesëmarrjes së Prokurorit të Përgjithshëm në analizat vjetore të punës së prokurorive për vitin 2022, në të cilat i është kushtuar vëmendje e posaçme respektimit të parashikimeve të udhëzimit nr. 12/2020 në marrëdhënien prokuror – drejtues, si një marrëdhënie e një rëndësie të veçantë për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërinë së prokurorëve, duke vënë njëkohësisht theksin te përgjegjësia që vjen për çdo prokuror nga pavarësia që gëzon në ushtrimin e funksioneve, për të vendosur vetëm bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, i konsiderojmë të realizuara këto rekomandime, për faktin se Prokuroria e Përgjithshme ka mbikëqyrur nëpërmjet kërkesave për informacion respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga udhëzimet, ka kërkuar inspektim tematik me objekt respektimin e të drejtave procedurale, me fokus viktimën e krimit dhe të miturit dhe ka vijuar

bashkëpunimin me Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë në kuadrin dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit, “Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve/prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”. Po kështu kanë vijuar masat dhe aktivitetet për konsolidimin e pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të prokurorisë dhe për garantimin e pavarësisë së prokurorëve.

***Kontributi për reformimin e kuadrit ligjor***

Prokuroria ka dhënë kontributin e saj dhe për reformimin e kuadrit ligjor edhe për vitin 2023, nëpërmjet vlerësimit dhe dërgimit të sugjerimeve për projektligje, projektvendime dhe projektmarrëveshje të përbashkëta, ku veçojmë projektligjet si më poshtë:

- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”;
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare”;
- projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- projektligji “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”;
- projektligji “Për amnistinë”;
- projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin Penitenciar”;
- projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të mjekësisë ligjore në Republikën e Shqipërisë”.

## 2. Zbatimi i rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”

Në zbatim të nenit 103 pika 3 të ligjit nr. 97/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, Rekomandimet Prioritare “Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 226, datë 13.04.2023 ju bënë të njohura drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të gjithë niveleve, në një mbledhje të përbashkët me pjesëmarrje edhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

2.1 Prokurori i Përgjithshëm, në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me qëllim orientimin e politikave institucionale për ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara, duke siguruar pavarësinë e prokurorisë si organ që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarisë së saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.

Masat e parashikuara për prokuroritë e juridikisionit të përgjithshëm japin udhëzime për drejtuesit e prokurorive, drejtuesit e seksioneve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, si dhe në marrëdhëniet ndërmjet tyre, për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare në fazën e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit në gjykim, si dhe njëkohësisht përcaktojnë rregulla administrative apo organizative që i shërbejnë procesit të njohjes, lehtësimit dhe garantimit të zbatimit korrekt të rekomandimeve dhe të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, në përputhje me specifikat dhe gjendjen e prokurorisë përkatëse.

Drejtuesit udhëzohen veçanërisht në rritjen e rolit aktiv në marrjen dijeni për vepra penale nga burime të hapura dhe fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve përfshi edhe rastet e ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm në veprimtarinë e prokurorit, si dhe në angazhimin e vazhdueshëm në nxjerrjen e udhëzimeve për prokurorët dhe policinë gjyqësore, koordinimin dhe bashkëpunimin brenda prokurorisë, me prokurori të tjera dhe me institucionet ligjzbatuese, konsolidimin e kapaciteteve dhe menaxhimin efektiv të punës në funksion të mbështetjes së prokurorëve duke prioritizuar veprat penale të rekomanduara.

Në udhëzim u përçua rëndësia dhe detyrimi për të njëjtin angazhim proaktiv edhe nga ana e drejtuesve të seksioneve, ndërkohë që masat drejtuar prokurorit synuan të udhëzojnë jo vetëm mbi rritjen e efektivitetit të procesit të hetimit dhe ndjekjes penale, por edhe në mjetet që shërbejnë për të rritur përgjegjshmërinë, kapacitetet dhe rolin e tij në zbatimin e politikave penale për një sistem drejtësie efiçent.

Në vijim, Prokurori i Përgjithshëm miratoi urdhrin nr. 70, datë 12.05.2023 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023".

Këto akte u dërguan për njohje e zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me shkresat nr. 599/1 prot., datë 08.05.2023 dhe nr. 599/4 prot., datë 12.05.2023 të Prokurorisë së Përgjithshme.

Prokurori i Përgjithshëm, me shkresat nr. 599/7 prot., datë 04.10.2023 dhe nr. 599/25, datë 15.01.2024, ka kërkuar informacion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për ecurinë e këtyre rekomandimeve, zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 70/2023.

Përveç sa u trajtua më sipër lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit ku përfshihet edhe zbatimi i rekomandimeve prioritare në të njëjtën fushë, gjejmë me vend t'ju informojmë për masat e tjera të marra dhe progresin në përmbushjen e disa rekomandimeve prioritare në drejtimet e tjera të vendimit të Këshillit Ministrave përgjatë vitit 2023, sipas drejtimeve ku fokusohen, si më poshtë:

***Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit***

**2.1 Lidhur me rekomandimin prioritar 1,** "*Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit gjatë hetimeve paraprake, rekomandim i përsëritur ndër vite, me qëllim shtimin e rasteve të hetimeve, të filluara kryesisht, numër i cili vijon të mbetet i ulët.*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.1.1 Siç u parashtrua, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, dhe jo vetëm, janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të drejtuesit të prokurorisë, drejtuesit të seksionit dhe prokurorit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara. Kryerja e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit ka qenë në vijimësi udhëzim për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare të rekomanduara.

2.1.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi dhe në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 prokurorët kanë rritur rolin aktiv në hetimin paraprak, në kryerjen e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të rritjes së hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

Referuar të dhënave statistikore të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, evidentohet se në vitin 2023 janë filluar kryesisht 138 procedime penale ose me rritje 11,29 % të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2022. Peshën më të madhe në këto raste e përbëjnë veprat penale të parashikuara në Kreun VIII, seksioni III *Vepra penale kundër*

*rendit dhe sigurisë publike, 56,52 %* dhe seksioni II *Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik,* 13,04 % e totalit, ku vetëm për veprën penale të shpërdorimit të detyrës janë filluar kryesisht 15 procedime penale ose 10,87 % e totalit; 21, 01 % e procedimeve janë regjistruar për vepra penale të parashikuara në Kreun III *Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*, dhe 10,87 % për vepra penale të parashikuara në Kreun II *Vepra penale kundër personit.* Rritja e numrit të çështjeve të filluara kryesisht është kërkesë e vazhdueshme, e cila nuk është ende në nivelin e duhur. Nga një analizë e arsyeve, vlerësohet se mbingarkesa përbën një shkak kryesor që kufizon prokurorët në ushtrimin e këtij diskrecioni ligjor.

2.1.3 Prokurorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në bashkëpunim me shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, sipas kërkesave dhe procedurave ligjore, për vitin 2023 kanë kryer hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 514 procedimeve penale. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 474 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Këto hetime proaktive kanë bërë të mundur që të sigurohen të dhëna jo vetëm për veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi, por edhe për zbulimin në 6 (gjashtë) raste, të kryerjes së veprës penale të korrupsionit dhe korrupsionit aktiv në zgjedhje, të parashikuara nga nenet 319, 319/c, 319/ç, dhe 328 të Kodit Penal në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme, që ka mundësuar kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ajo prokurori. Në 9 raste, duke përdorur metoda speciale hetimi, është mundësuar zbulimi i veprave penale si "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotikeve", "Falsifikimi i dokumenteve", "Falsifikimi i dokumenteve shkollore" përkatësisht të parashikuara nga nenet 283, 186 dhe 187 të Kodit Penal.

2.1.4 Hetimi gjithëpërfshirës i kryer nga prokurorët e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në kuadër të hetimit dhe ndjekjes penale për vepra në kompetencë lëndore të tyre, si dhe vlerësimi i të dhënave/indicieve të përftuara nga përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ka çuar në zbulimin e veprave penale të kryera në kuadër të bashkëpunimit të veçantë (grup i strukturuar, organizatë kriminale, etj.) dhe korrupsionit, vepra penale në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Të dhënat statistikore dhe të konfirmuara nga informacioni i Prokurorisë së Posaçme, tregojnë se për vitin 2023, në zbatim Kodit të Procedurës Penale dhe të Aktit të Koordinimit Institucional datë 15.12.2020 "Për rritjen e efiçencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme", prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 68 procedime/referime penale, prej të cilave në Prokurorinë e Posaçme janë pranuar 44 procedime/referime ose 64,71 % e procedimeve të transferuara, për grupvepra kundër krimit të organizuar dhe të lidhura me korrupsionin ose krimet në detyrë në kompetencë lëndore të asaj prokurorie.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, këtë rekomandim prioritar e konsiderojmë të realizuar për vitin 2023, pasi me udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara, dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare dhe është rritur numri i procedimeve të filluara kryesisht, pavarësisht se nga ana jonë synohen rezultate me të larta në këtë drejtim dhe në rritjen e efektivitetit në zbulimin, goditjen dhe parandalimin e veprimtarisë kriminale në fushat përkatëse të veprimtarive institucionale dhe ndërinstitucionale.

***Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Lufta kundër korrupsionit***

**2.2 Lidhur me rekomandimet prioritare 1, 2 dhe 3** "*Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit për aq sa është e mundur, vijimin e rritjes së numrit të personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave*"; "*Vijimin e bashkëpunimit midis prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme për sa i përket ndarjes së kompetencës lëndore për këto vepra, me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve" ;* dhe "*Rritjen e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon të jetë i ulët), si dhe vijimin e rritjes së numrit të hetimeve proaktive-përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim vazhdimin e përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së hetimeve, veçanërisht për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar kompetencës lëndore.*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

2.2.1 Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe efiçencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme dhe prioriteteve në luftën kundër krimit, përfshi veprat penale që lidhen me detyrën dhe ato korruptive në kompetencë lendore të saj, ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel vendor dhe në nivel qendror, si me Prokurorinë e Posaçme në zbatim të Aktit të Koordinimit Institucional, "Për rritjen e eficencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj", ashtu dhe ka vijuar zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Kontrollin e Lartë të Shtetit; dhe Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me synim rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen dhe krimin ekonomik, shpërdorimin e fondeve publike, ushtrimin e veprimtarisë shtetërore në kundërshtim me ligjin.

Në kuadrin e rekomandimeve prioritare, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, masa për kryerjen e hetimeve të plota e të gjithanshme, për kryerjen e hetimeve proaktive efektive, përdorimin e mjeteve të posaçme/speciale të hetimit sipas ligjit, duke mbajtur në konsideratë këtu kriteret ligjore për përdorimin e mjeteve të kërkimit të provës bazuar në marzhet e veprave penale të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe përdorimin e hetimeve financiare pasurore ose procedimet pasurore në funksion të rritjes së mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimeve të krimeve të lidhura më të.

Në kryerjen e hetimeve proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit gjatë vitit 2023, roli aktiv i oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve përkatës ka mundësuar përftimin e të dhënave nga interceptimi të shoqëruara më vëzhgime përtej veprave penale të regjistruar nga prokurori për të cilat ishte lejuar përgjimi dhe zbulimin në 6 raste të kryerjes së veprave penale të korrupsionit të parashikuara nga nenet 259, 319/c, 319/ç, dhe 328 të Kodit Penal në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme që ka mundësuar kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ajo prokurori.

Referuar të dhënave statistikore të vitit 2023, për grupveprat penale të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, janë regjistruar 170 procedime me 123 të pandehur dhe 140 procedime me 151 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2022 me ulje 35,11 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me ulje 17,16 % të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këto vepra penale.

2.2.2 Në kuadrin e zbatimit të Aktit të Koordinimit Institucional "Për rritjen e eficencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme, dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstitucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj", nënshkruar me 15 dhjetor 2020 mes Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme, ka vijuar bashkërendimi nëpërmjet komunikimeve të drejtpërdrejta në nivel qendror dhe në nivel rrethi gjyqësor, mes drejtuesve të prokurorive përkatëse sipas rastit dhe objektit të përcaktuar.

Në kuadër të rritjes së këtij bashkëpunimi janë zhvilluar takime ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme ku ndër të tjera është diskutuar mbi zbatimin me kujdes të shtuar të dispozitave procedurale lidhur me kompetencën lëndore, në funksion të rritjes së efektivitetit të drejtësisë penale. Në funksionit të realizimit të këtij bashkëpunimi në nivel vendor, Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet një qarkoreje, drejtuar prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ka synuar të adresojë çështje objekt i këtyre takimeve.

Në këtë vështrim, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe të Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional mes dy prokurorive, për vitin 2023, sipas të dhënave statistikore dhe të konfirmuara nga informacioni i Prokurorisë së Posaçme, janë regjistruar 32 procedime penale për vepra që lidhen me korrupsionin ose vepra penale që lidhen me detyrën, që zënë 47,06 % të numrit të referimeve/procedimeve penale të transferuara për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme për këtë periudhë.

2.2.3 Prokurorët sipas kërkesave/procedurave ligjore për vitin 2023 kanë rritur rolin aktiv për veprat penale të korrupsionit dhe ato që lidhen me detyrën duke filluar kryesisht 18 procedime penale, ndaj 16 të filluara në vitin 2022 dhe në kryerjen e hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në 31 procedime penale. Ky proces i ka shërbyer, si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 7 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore i konsiderojmë të realizuara këto rekomandime, si për faktin se ka vijuar zbatimi i Aktit të Koordinimit Ndërinstitucional nëpërmjet bashkërendimit dhe koordinimit me Prokurorinë e Posaçme dhe zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel qendror dhe vendor për luftën ndaj korrupsionit dhe veprave që lidhen me detyrën, si dhe janë rritur hetimet proaktive dhe me mjete të posaçme hetimi në përputhje me kriteret proceduriale të zbatueshme për këto vepra.

***Lidhur me rekomandimet në drejtimin: Lufta kundër krimit të organizuar***

**2.3 Lidhur me rekomandimin 1** "*Rritjen e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim dhe cilësisë së hetimit për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme; si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 strukturat përkatëse në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë udhëzuar për vijimin e rritjes së bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese brenda vendit dhe ato rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, përfshi ato në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve, më synim rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale ndaj narkotikëve dhe trafikimeve të paligjshme.

Ndjekja penale, politika penale dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit, është ndër çështjet prioritare në prokurori, nisur nga cenimi i rëndë i të drejtave të njeriut që karakterizon këtë formë

krimi. Prokuroria e Përgjithshme, në këtë drejtim vlerëson se vetëm një qasje e gjithanshme, që nis me parandalimin nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit, bashkëpunimit me gjithë aktorët vendas të përfshirë, bashkëpunimi ndërkombëtar, mbrojtja e viktimave dhe ndjekja penale e dënimi i duhur i autorëve, mund të japë rezultate efektive.

Në këtë kuadër, jemi angazhuar në bashkëpunimin me projekte ndërkombëtare që mbështesin institucionet shqiptare dhe ato të rajonit, për të forcuar hetimin dhe ndjekjen penale të të gjithë formave të trafikimit, si dhe mbi sfidat dhe nevojat e institucioneve në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe garantimit të mbrojtjes së viktmave, si projekti "Forcimi i kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese për bashkëpunimin ndërsektorial dhe ndjekjen penale të trafikimit të personave" i OSBE-së dhe projekti "Mbështetja e BE-së për të forcuar luftën kundër kontrabandës së migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor".

Bashkëpunim të rëndësishëm Prokuroria e Përgjithshme ka patur me Ministrinë e Brendshme në kuadër të miratimit të marrëveshjes ndërinstitucionale për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, palë të tjera të të cilës janë Ministri e shoqata të shoqërisë civile me rol e kontribut në mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Një rol të rëndësishëm në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, vlerësojmë se do të ketë vijimi i zbatimit të vendimit njehsues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili interpretoi kuptimin, format dhe dallimin e veprave penale të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve, me vepra si shfrytëzimi i prostitucionit dhe keqtrajtimi i të miturit. Prokurori i Përgjithshëm, nëpërmjet një qarkoreje drejtuar prokurorive të të gjithë niveleve, përcolli të trajtuara qëndrimet njehsuese në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për njohjen e prokurorëve me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë me në fokus ato vendime që njehsojnë apo ndryshojnë praktikën gjyqësore.

Një rol aktiv është mbajtur edhe në drejtimin e asistencës ndaj viktimave të trafikimit, ku koordinatorët e viktimave në Prokurorinë e Përgjithshme, angazhohen si në aktivitete të përbashkëta për ndarje eksperiencash e ndërgjegjësim, ashtu edhe në drejtimin e mbështetjen e koordinatorëve të prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm por edhe punonjësve të policisë e policisë gjyqësore. Veçojmë aktivitetet ku koordinatorët në Prokurorinë e Përgjithshme kanë qenë referues/drejtues si vijon:- Aktivitet në kuadër të muajit kombëtar të trafikimit të qënieve njerëzore, organizuar në ambientet e Këndit Amerikan me grupin e të rinjve, për marrjen e njohurive për trafikimin e qënieve njerëzore; Gjithashtu koordinatorët e viktimave në prokuroritë e rretheve gjyqësore për periudhën raportuese kanë marrë pjesë në 3 trajnime me tematika të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore.

Treguesit statistikorë të trafikimit të qenieve njerëzore për vitin 2023, rezultojnë si vijon:

i) Lidhur me "Trafikimin e personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal, për vitin 2023, janë regjistruar 6 procedime penale me 6 të pandehur, dhe janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 5 të pandehur, ose krahasuar me vitin 2022 me ulje nga 7 në 6 të numrit të procedimeve të regjistruara por me rritje nga zero në 6 të të pandehurve të rregjistruar si dhe me rritje nga 2 në 5 të nummrit të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër penale.

ii) Për veprën penale "Trafikimi i të miturve" të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal, sipas të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar 8 procedime penale me 2 të pandehur, është dërguar për gjykim 1 procedim penal e 2 të pandehur. Krahasuar me vitin 2022, kemi një dyfishim të procedimeve të regjistruar nga 4 procedime në 8 procedime dhe rritje të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim, nga 0 në 2 për këtë vepër.

Lidhur me *trafikimin e paligjshëm dhe mbajtjen pa leje ose prodhimin e armëve e municioneve*, informacioni është trajtuar në kuadër të rekomandimit 8 të rezolutës.

Sa i përket treguesve statistikorë lidhur me v*epra penale në fushën e narkotikëve, vërehet si vijon:*

i) Lidhur me luftën kundër trafikimit të narkotikëve parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar 52 procedime me 51 të pandehur, dhe 25 procedime me 40 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2022, kemi një rritje prej 20,93 % të numrit të procedimeve, rritje 13,33 % të numrit të pandehurve të regjistruar, rritje 31,58 % të numrit të procedimeve të dërguar për gjykim si dhe rritje prej 11,11 % të pandehurve të dërguara për gjykim për këtë vepër.

ii) Për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, në vitin 2023, sipas të dhënave statistikore për këtë vepër janë regjistruar 1026 procedime me 892 të pandehur, ose një ulje prej 3,48 % të procedimeve të regjistruara dhe ulje 10,35 % të të pandehurve të regjistruar. Për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 476 procedime me 715 të pandehur ose ulje prej 15 % e procedimeve dërguar për gjykim dhe ulje prej 10,74% e të pandehurve dërguar për gjykim.

iii) Për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotikëve" të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, në vitin 2023, sipas të dhënave statistikore për këtë vepër janë regjistruar 726 procedime me 109 të pandehur ose një rritje prej 51,57 % e procedimeve të regjistruara dhe një ulje prej 44,38 % të të pandehurve të regjistruar. Lidhur me procedimet dhe të pandehurit dërguar për gjykim për këtë vepër penale, vërehet ulje 44,31 % e numrit të procedimeve dhe ulje 55,84 % e numrit të të pandehurve.

iv) Kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime në fushën e narkotikëve janë relativisht të ashpra, ku 77,59 % janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe pjesa tjetër janë kërkesa për masa më të lehta si detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

v) E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit, për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, në vitin 2023 numri i kërkesave për caktimin e dënimit me burg është 67,88 % dhe numri i kërkesave për caktimin e alternativave të dënimit me burg është 32,12 %.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim. Treguesit statistikorë për vitin 2023 tregojnë rritje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të "Trafikimit të qenieve njerëzore", rritje të procedimeve të regjistruara për veprën penale të "Kultivimit të bimëve narkotike" dhe një ulje të lehtë të procedimeve të regjistruara për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve".

Konstatohet një politikë e ashpër penale, si për caktimin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe në caktimin e llojit dhe masave të dënimit ndaj autorëve të veprave penale në fushën e narkotikëve.

**2.4 Lidhur me rekomandimin 2** *"Marrjen e masave për evidentimin dhe rritjen e numrit të procedimeve për veprat penale në fushën e terrorizmit, përfshirë dhe rastet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare",* sa i përket veprave penale me qëllime terroriste, referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, kompetenca lëndore e tyre i përket Prokurorisë së Posaçme, dhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në funksion të parimit të ushtrimit të detyrueshëm të ndjekjes penale, regjistrojnë çdo njoftim për vepra të tilla duke kryer edhe veprimet e nevojshme hetimore, për t'i përcjellë më pas Prokurorisë së Posaçme për kompetencë lëndore.

Duke vlerësuar adresimin e këtij rekomandimi përveç sa është trajtuar lidhur me trafiqet, krimet e tjera të rënda e krimin kibernetik sipas rekomandimeve korresponduese, nga të dhënat statistikore lidhur me Kreun V të Kodit Penal "Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues", nuk rezultojnë procedime penale të regjistruara në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2023.

Nisur nga rëndësia e marrëdhënieve juridike që këto vepra penale mbrojnë, numri i procedimeve nuk është treguesi i vetëm i eficencës ndaj luftës kundër tyre. Për këto grupveprash, rol të rëndësishëm marrin masat me rëndësi parandaluese, siç janë masat administrative mbrojtëse dhe sanksionet administrative, veprimtaria inteligjente dhe zbuluese dhe sigurisht politika penale.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar, ndërkohë nevojitet që rekomandimet të marrin në konsideratë kompetencën lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, në përputhje me kuadrin kushtetues dhe ligjor.

**2.5 Lidhur me rekomandimin 7** "*Vijimin e forcimit të bashkëpunimit me organet ligjzbatuese ndërkombëtare, në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda*", në funksion të rritjes së efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale për veprat penale që lidhen me trafikimin e narkotikëve, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave, etj., janë marrë masa e arritur rezultatet si më poshtë:

Prokurori i Përgjithshëm, në datat 24-27 shtator, zhvilloi disa takime dypalëshe me prokurorët e përgjithshëm të Anglisë dhe Uellsit, Zvicrës dhe Hollandës. Këto takime patën në fokus çështje që lidhen me rritjen e efiçencës në drejtim të bashkëpunimit mes prokurorive, duke u fokusuar në koordinimin e hetimeve në drejtim të goditjes së aktiviteteve kriminale, shkëmbimin e shpejtë të informacionit për çështje prioritare si dhe përshpejtimin e ekzekutimit të letërporosive. Një vëmendje të veçantë mori çështja e transferimit të të dënuarve shqiptarë nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri për të vuajtur pjesë e mbetur të dënimit, në kuadër të marrëveshjes së lidhur mes dy vendeve.

Prokuroria e Përgjithshme ndërmori iniciativën për amendimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Belgjikës, për bashkëpunim gjyqësor, në veçanti në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (nënshkruar në Bruksel më 10.05.2011), e cila aktualisht është në fazën e diskutimeve dypalëshe.

Gjithashtu, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë këtij viti ka marrë pjesë dhe vijon të japë kontribut në takimet periodike që zhvillohen në grupin teknik të punës me përfaqësues të autoriteteve britanike dhe shqiptare, për zbatimin e Marrëveshjes Dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut "Mbi transferimin e personave të dënuar", e cila ka hyrë në fuqi në datë 05.05.2022.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 të dhënat e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar të administruara në sistemin elektronik IMPRO rezultojnë si më poshtë:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, 99 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 48 praktika;
- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, 171 praktika, 45 të përfunduara;
- Urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 280 praktika, 125 të përfunduara;
- Letërporosi nga Jashtë, 431 praktika, 229 të përfunduara;
- Letërporosi për jashtë, 491 praktika, 152 të përfunduara;
- Transferime të dënuarish nga jashtë, 47 praktika, 14 të përfunduara;
- Transferime të dënuarish për jashtë, 2 praktika;
- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 22 praktika;
- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 16 praktika;
- Njohje të vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 33 praktika;
- Njohje të vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 8 praktika.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar të Këshillit të Ministrave, për faktin se evidentohet progres i bashkëpunimit me

partnerët ndërkombëtarë dhe autoritetet gjyqësore të huaja në fushën penale dhe rritje më tej e besimit ndaj institucionit të prokurorisë nga partnerët në marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

***Lidhur me rekomandime në drejtimin: Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut***

**2.6 Lidhur me rekomandimin prioritar 2** "*Shtimin e numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjykimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, si dhe duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve"*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet e mundshme si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 prokurorët janë udhëzuar në rritjen e numrit të kërkesave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për rritjen e numrit të kërkesave në zbatimin e instituteve procedurale penale të gjykimit me marrëveshje dhe urdhrit penal, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore, rrethanat e faktit të bazuara në prova dhe synimet prioritare të rekomanduara.

Ndërkohë ka vijuar mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 9, datë 21.12.2021 "Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit", nëpërmjet të dhënave statistikore periodike, treguesve lidhur me kërkesat e prokurorit në gjykimin e çështjeve në zbatimin e këtyre instituteve, ashtu dhe nëpërmjet informacioneve, për problematikat dhe praktikat e mira të shoqëruara me praktikë gjyqësore sa më të konsoliduar në zbatimin e këtyre instituteve të reja procedurale penale në shërbim të eficencës së punës së organit të akuzës.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2023 prokurorët kanë kërkuar në gjykatë miratimin e urdhrit penal për 136 çështje me 139 të pandehur për kundravajtje penale ose ulje 46,46 % e kërkesave krahasuar me vitin 2022, miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë për 143 çështje me 148 të pandehur ose me ulje 46,04 % të çështjeve krahasuar me vitin 2022, dhe gjykimin e drejtpërdrejtë për 283 çështje me 286 të pandehur ose me rritje 15,51 % të numrit të çështjeve krahasuar me vitin 2022.

Megjithë masat e marra nga Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme por edhe diskutimeve me drejtuesit e prokurorive në analizat vjetore të punës, ku janë ngritur me të drejtë shqetësime për qëndrimet jo mbështetëse të gjykatave që kanë ndikuar në uljen e numrit, sërish konstatohet se urdhri penal dhe marrëveshja e fajësisë jo vetëm nuk shfrytëzohen për të dhënë ndihmën e duhur në drejtim të efektivitetit por ka edhe prokurori, si p.sh në Lezhë, ku nuk ka asnjë rast të aplikimit të tyre. Për këtë arsye, duke nisur nga raportimet vjetore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, në prokuroritë me përformancë më të dobët në këtë aspekt do të kryhet një analizë e thelluar e shkaqeve që këto instrumenta proceduralë nuk po arrijnë qëllimin që synoi ligji. Megjithatë, duhet theksuar se ka nevojë për trajnime të përbashkëta ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve në këtë fushë si dhe për vlerësimin e mundësisë për ndryshime ligjore që të lehtësohet aplikimi i tyre.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar pjesërisht këtë rekomandim, për faktin se evidentohen shifra në ulje në aplikimin e urdhrit penal dhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe rritje për gjykimet e drejtpërdrejta krahasuar me një vit më parë.

2.7 **Lidhur me rekomandimin prioritar 3** "*Nxitjen e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore*", janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet e mundshme si më poshtë:

Në përmbushje të këtij në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, nisur nga natyra specifike që ka secila kategori subjektesh objekt i këtij rekomandimi, prokurorët janë udhëzuar për të ndjekur një politikë penale efiçente dhe efektive, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në

aktet/kërkesat/konkluzionet përkatëse, si referuar në rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe në kushtet/kriteret ligjore, për zbutjen e dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative sipas cilësive të veçanta të subjekteve përkatëse për t'u konsideruar si rrethana lehtësuese në kuptim të ligjit penal.

Nga të dhënat statistikore vihet re se për vitin 2023, prokurori ka kërkuar aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", për 53,74 % të të pandehurve të dënuar.

Theksojmë se duke mos pasur një sistem statistikor për menaxhimin e çështjeve, nga statistika nuk mund të përftohen të dhëna të detajuara sipas kategorive të subjekteve të këtij rekomandimi.

- Në përmbushje të funksioneve kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar, sa i përket masave për nxitjen në drejtim të aplikimit të dënimeve alternative bazuar në kushtet e kriteret ligjore.

**2.8 Lidhur me rekomandimin prioritar 5** *"Rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimit dhe gjykimit për veprat penale në fushën e mjedisit."*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023, drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët janë udhëzuar për vijimin e rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit nga struktura përkatëse me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht dhe ato që lidhen me veprat penale kundër mjedisit.

Prokuroria e Përgjithshme për mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2022 dhe të kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese e ligjore të prokurorisë, ka kërkuar nga drejtuesit, nëpërmjet kërkesave për informacion për veprat penale kundër mjedisit.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2023, për grup veprat penale kundër mjedisit, evidentohet se janë regjistruar 343 procedime dhe 73 të pandehur, ose me ulje 7,80 % të numrit të procedimeve dhe 29,13 % të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2022. Janë dërguar për gjykim 60 procedime me 69 të pandehur, ose me ulje 20 % të procedimeve dhe ulje 33,01 % të të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2022.

Në kuadrin e rritjes së cilësisë së hetimit, Prokuroria e Përgjithshme është ndër përfituesit e Projektit të OSBE-së për "Rritjen e Sigurisë dhe Qeverisjes Mjedisore në Shqipëri", dhe nëpërmjet bashkëpunimit për vlerësimin dhe realizimin e aktiviteteve të këtij projekti, synon të ndihmojë forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, duke mundësuar përgatitjen e një manuali praktik për prokurorët dhe policinë gjyqësore lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale kundër mjedisit dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta me aktorët e përfshirë në luftën kundër veprave penale në fushën e mjedisit.

Po në këtë drejtim, me mbështetjen e projektit EU4LEA është zhvilluar më datë 21 qershor, në Tiranë, trajnim mbi hetimin e veprave penale në fushën e mjedisit me pjesëmarrjen e 1 prokurori. Nga Shkolla e Magjistraturës janë zhvilluar 2 sesione trajnimesh përkatësisht me tema, "Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore", ku kanë marrë pjesë 16 prokurorë dhe 14 oficerë të policisë gjyqësore dhe "E drejta mjedisore e BE-së", ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë.

- Në përmbushje të funksioneve Kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të zbatuar këtë rekomandim prioritar për faktin se evidentohen arritje lidhur me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale si dhe bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese.

***Lidhur me rekomandime në drejtimin: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional***

**2.9 Lidhur me rekomandimin 3** *"Shtimin e vëmendjes për veprat penale në fushën e zgjedhjeve, duke pasur parasysh se viti 2023 është një vit zgjedhor, me qëllim garantimin e hetimit të shpejtë dhe efektiv të çështjeve"***,** janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Prokuroria e Përgjithshme është e angazhuar në garantimin e mbrojtjes juridiko penale të zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik të zgjedhjeve, duke marrë masa ligjore institucionale për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira, si dhe në trajtimin me rigorozitet e përparësi të çdo kërkese të përcjellë për verifikim të thelluar në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe në këtë kuadër, masat institucionale kanë synuar:

- Nxjerrjen e akteve normative për të unifikuar organizimin dhe funksionimin e gatishmërisë, hetimin me përparësi të këtyre veprave dhe veprave të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, bashkërendimin me agjencitë ligjzbatuese për kryerjen e hetimeve proaktive, sigurimin e informimit në kohë, etj.;
- Bashkëpunimin për trajnimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në fushën e zgjedhjeve;
- Angazhimin/përfshirjen e prokurorëve në trajnimin e personelit të policisë, në përgjigje të kërkesës për bashkëpunim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në kuadrin e kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokurori dhe mbikëqyrjes së zbatimit të masave administrative dhe procedurale në periudhën para dhe pas zgjedhore të normuara në udhëzimin e përgjithshëm nr. 3/2019, i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm, ka miratuar dhe përcjellë për zbatim një qarkore me të cilën u është kërkuar drejtuesve të prokurorive të rretheve gjyqësore sipas kompetencës tokësore të marrin masa për organizimin dhe funksionimin e gadishmërisë së përforcuar në prokuroritë që drejtojnë që nga data e fillimit të fushatës zgjedhore deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në fazën e hetimeve paraprake, u është kërkuar të vlerësojnë dhe trajtojnë me prioritet dhe në afate të përshpejtuara, çdo referim dhe/ose kallëzim për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të çdo vepre tjeter penale që dëmton procesin zgjedhor, në bashkërendim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për kallëzimet e paraqitura prej saj, dhe/ose me agjensitë ligjzbatuese të specializuara, për kryerjen e hetimeve proaktive, dhe/ose përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit sipas ligjit, si dhe rritjen e intensitetit të hetimeve për këto grupvepra penale. Gjithashtu ju është kërkuar t'i kushtojnë rëndësi caktimit të masave të sigurimit personal për këto grupvepra penale, të vlerësojnë ashpërsimin e kërkimeve, si për llojin e masave të sigurimit personal, ashtu dhe per llojin dhe masat e dënimit per veprat penale në fushën e zgjedhjeve që janë më të përhapura dhe me tendencë në rritje në shkallë vendi, apo në njësitë administrative në kompetencë tokësore të rrethit gjyqësor të gjykatës pranë të cilës ushtron funksionet ajo prokurori.

Me urdhrin nr. 47, datë 03.04.2023, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019 "Mbi masat administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore", i ndryshuar, është ngritur struktura në Prokurorinë e Përgjithshme e cila shërben si pikë kontakti që bashkërendon, koordinon dhe shkëmben informacion me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, agjencitë ligjzbatuese, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor.

Për të siguruar një qasje bashkëpunimi, ndërgjegjësim dhe besim të publikut ndaj organeve të ndjekjes penale në luftën kundër krimit zgjedhor, është krijuar një rubrikë e veçantë në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme ku janë ftuar qytetarët të kallëzojnë shkeljet e ligjit që kanë dijeni ose

që kanë cenuar interesat e tyre si zgjedhës ose të konstatuara prej tyre në periudhën para zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Të dhënat statistikore të vitit 2023 tregojnë se janë regjistruar 25[5] procedime penale dhe 19 të pandehur. Ndërkaq janë dërguar për gjykim 2 procedime penale me 14 të pandehur për vepra penale që cenojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Peshën më të lartë në këto procedime e zënë vepra penale e parashikuar nga neni 328/a "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", për të cilën janë regjistruar 8 procedime penale ose 32 %, dhe vepra penale e parashikuar nga neni 327/a "Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar", për të cilën janë regjistruar 5 procedime penale ose 20 % e numrit total të procedimeve regjistruar për këto grupvepra.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në periudhën zgjedhore, në Prokurorinë e Përgjithshme janë përcjellë për verifikim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 45 kërkesa, nga të cilat 33 kërkesa lidhur me kandidatë për anëtarë të Këshillit Bashkiak, 9 kërkesa lidhur me kandidatë për kryetar bashkie, 1 kërkesë për këshilltar bashkiak dhe 2 kërkesa për kryetarë bashkie. Nga këto kërkesa për verifikim, për 8 raste ka përfunduar procesi i verifikimit të thelluar dhe rezultatet i janë përcjellë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve; për 4 raste është vendosur mospranim i kërkesës për verifikim të thelluar sipas kritereve të nenit 8 të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; për 2 subjekte është vendosur kthimi për plotësim sipas kritereve ligjore të neneve 44, 62, 64 të Kodit të Procedurave Administrative; për 1 subjekt është bërë referim për verifikime të mëtejshme në prokurorinë kompetente.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të Këshillit të Ministrave, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet më sipër në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019 në drejtim të hetimit të shpejtë dhe efektiv të çështjeve dhe është ngritur struktura në Prokurorinë e Përgjithshme që shërben si pikë kontakti për bashkërendimin, koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, agjencitë ligjzbatuese, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare duke garantuar ruajtjen e sekretit hetimor.

**2.10 Lidhur me rekomandimin 5** *"Vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale, dhe shkëmbimin e të dhënave në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm"*, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultatet si më poshtë:

Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe efiçencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale dhe prioriteteve në luftën kundër kriminalitetit, përfshi veprat penale që lidhen me krimin e organizuar, ka vijuar dhe konsideruar domosdoshmëri qasjen e përbashkët dhe të unifikuar ndërmjet institucioneve ligjzbatuese, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë bashkëpunimit dinamik në nivel vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Drejtuesit e prokurorive e drejtuesit e seksioneve nëpërmjet udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 udhëzohen të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, sipas kompetencës, si dhe për organizimin dhe zhvillimin e analizave të përbashkëta ndërinstitucionale. Po kështu prokurorët udhëzohen të kryejnë analiza të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose të agjencive ligjzbatuese, për

[5] Nuk përfshihen veprat penale të korrupsionit në zgjedhje, për të cilat janë 4 procedime të regjistruara i janë përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme.

shkëmbimin dhe kërkimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të shpejtësisë e gjithanshmërisë në ecurinë e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara.

Bashkëpunimi në nivel qendror dhe vendor ka vijuar edhe në kuadër të realizimit të detyrimeve të marra përsipër në marrëveshje të përbashkëta të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme; me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; me Kontrollin e Lartë të Shtetit; me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, etj.

Nga ana tjetër, Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm, ka vlerësuar detyrimet dhe nevojat për nënshkrimin në janar 2023, të marrëveshjes së bashkëpunimit për rritjen e eficencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë, siç u trajtua më sipër.

Në kuadër edhe të angazhimeve të ndërmarra nga Prokuroria e Përgjithshme me Marrëveshjen e Bashkëpunimit lidhur me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme për rritjen e eficencës në hetimin dhe ndjekjen penale të vjedhjes dhe trafikimit të objekteve të dyshuara si pasuri trashëgimi kulturore dhe mënyrën e administrimit të tyre, vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale “Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës”, është ulur nga 3 në vitin 2022, në 1 procedim në vitin 2023.

Në kuadrin e këtij rekomandimi dhe në vijim të informacionit të dhënë më sipër për ecurinë e secilit rekomandim prioritar, ritheksojmë se Prokuroria e Përgjithshme ka nxitur shkëmbimin e të dhënave me agjencitë ligjzbatuese për marrjen e aksesit në baza të dhënash shtetërore dhe rritjen e efiçencës dhe efektivitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të suksesshme të kriminalitetit sipas prioriteteve në luftën kundër tij.

Prokuroria e Përgjithshme në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, vijon bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe me Shkollën e Magjistraturës, për të siguruar mbarëvajtjen e punës administrative në prokurori, rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe adresimin e problematikave lidhur me vakancat e prokurorëve në sistemin e prokurorisë në këtë periudhë riorganizimi dhe vijimi të procesit të rivlerësimit kalimtar.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të Këshillit të Ministrave, për faktin se janë realizuar masat dhe aktivitetet më sipër në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023 për zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe akteve/marrëveshjeve ndërinstitucionale, krahas masave dhe aktiviteteve në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar të realizuara në përmbushje të rekomandimeve të trajtuara lidhur me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

**2.11 Lidhur me rekomandimin 8** “*Rritjen e rasteve të përfshirjes në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre*” dhe “*Shtimin e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik*”, përveç sa është trajtuar më sipër në kuadër të rekomandimeve për forcim kapacitetesh e bashkëpunim në drejtimet e tjera prioritare, janë zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

Në kuadrin e këtij rekomandimi, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 2/2023 prokurorët janë udhëzuar për të vlerësuar në çdo rast zbatimin e parimit të specializimit dhe urdhërimin për kryerjen

e hetimeve paraprake nga oficerët e policisë gjyqësore të strukturës hetimore përkatëse që ka referuar veprën penale në prokurori. Si përjashtim nga rregulli i kryerjes së veprimeve hetimore nga shërbimet e policisë gjyqësore që kanë bërë referimin, është parashikuar në përputhje edhe me ligjin nr 25/2019, që në raste të veçanta me kërkesë të arsyetuar të prokurorit për të garantuar objektivitetin e hetimit, drejtuesi i prokurorisë mund të urdhërojë për kryerjen e hetimeve oficerët e policisë gjyqësore të strukturave hetimore përkatëse të shërbimeve të tjera ose të seksioneve të policisë gjyqësore në prokurorinë që drejton.

Në këtë udhëzim është normuar që sipas natyrës dhe kompleksitetit të çështjes për vepra penale prioritare të rekomanduara, shtimin e rasteve të urdhëruara nga prokurori dhe/ose drejtuesi i prokurorisë për kryerjen e veprimeve hetimore të përbashkëta nga oficerë të policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve me ato të seksioneve në prokurori, sipas prioriteteve të rekomanduara.

Sa i përket shtimit të kapaciteteve profesionale veçojmë të përmendim trajnimet lidhur me cilësinë e akteve proceduriale dhe procesin e të provuarit si: - "Standardet e provës në këndvështrim krahasues, mes procesit penal dhe civil", ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore;- "Kontrolli i vendeve dhe i banesës", ku kanë marrë pjesë 42 prokurorë dhe 38 oficerë të policisë gjyqësore; - "Përgjimi, infiltrimi, blerja e kontrolluar etj., mjete të kërkimit të provës si të veçanta", ku kanë marrë pjesë 13 prokurorë dhe 13 oficerë të policisë gjyqësore; - "Cilësia e akteve procedurale", ku kanë marrë pjesë 5 prokurorë dhe 42 oficerë të policisë gjyqësore dhe tema "Aktet procedurale të mbajtura nga oficerë të policisë gjyqësore", ku kanë marrë pjesë 24 prokurorë dhe 66 oficerë të policisë gjyqësore; - "Trajnimi për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave", ku kanë marrë pjesë 32 prokurorë dhe 33 oficerë të policisë gjyqësore.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, e konsiderojmë të realizuar këtë rekomandim prioritar të Këshillit të Ministrave, për faktin se janë marrë masa për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm nr. 2/2023, krahas masave dhe aktiviteteve në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional të realizuara në përmbushje të rekomandimeve të trajtuara më sipër.

***Lidhur me rekomandimet prioritare për forcim kapacitetesh në të gjithë drejtimet e rekomanduara***

**2.12 Lidhur me rekomandimet prioritare 4 në drejtimin I, 6 në drejtimin II, 8 në drejtimin III, 6 në drejtimin IV, 7 dhe 9 në drejtimin V**, Prokuroria e Përgjithshme e ka vlerësuar si domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe e ka trajtuar me prioritet në funksion të efiçencës dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit. Për këtë qëllim është bashkëpunuar me Shkollën e Magjistraturës dhe me misionet/projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, dhe është bashkërenduar me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe policisë gjyqësore të seksioneve, nëpërmjet realizimit të trajnimeve përfshirë edhe aktivitete të përbashkëta trajnimi me prokurorët dhe agjencitë ligjzbatuese.

Në përmbushje të këtij rekomandimi, në udhëzimin nr. 2/2023 drejtuesit e prokurorive udhëzohen të koordinojnë dhe organizojnë trajnime të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në një ose më shumë trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat e rekomanduara. Gjithashtu, në këtë udhëzim prokurorëve u kërkohet të synojnë rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet policore, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare të rekomanduara.

Ndërsa pjesëmarrja në aktivitete trajnuese është sa domosdoshmëri aq edhe detyrim ligjor përsa i përket trajnimit vazhdues, gjejmë me vend të theksojmë se ngarkesa e punës ndikon negativisht edhe në këtë prioritet.

Të dhëna të detajuara lidhur me aktivitetet trajnuese u trajtuan në rekomandimet sipas veprave penale dhe fushave të caktuara, si dhe gjenden të listuara në Aneksin 2 bashkëlidhur.

- Në përmbushje të detyrave kushtetuese e ligjore, i konsiderojmë të realizuara këto rekomandime prioritare, për faktin se kanë vijuar masat dhe aktivitetet për konsolidimin e aftësive profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

### 3. Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm

3.1 Prokurori i Përgjithshëm, në përmbushje të objektivave prioritare të prokurorisë lidhur me procesin e implementimit të reformës ligjore në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në zbatim të detyrave Kushtetuese e ligjore, rekomandimeve të Rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm, me synim për të normuar dhe unifikuar veprimtarinë administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, edhe gjatë vitit 2023 ka vijuar të vlerësojë detyrimet dhe nevojat për nxjerrjen e akteve të reja normative si dhe marrëveshjeve të përbashkëta ndër të cilët veçojmë:

3.1.1 Udhëzimet e përgjithshme të miratuara nga Prokurori Përgjithshëm:

- "Për masat administrative dhe procedurale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm", nr. 01, datë 26.01.2023;
- "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm", nr. 02, datë 12.05.2023.

3.1.2 Urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm:

- "Për caktimin e personelit në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019, i ndryshuar, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023;
- "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022", nr. 103, datë 25.07.2023;
- "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023"", nr. 70, datë 12.05.2023.

3.1.3 Marrëveshje Bashkëpunimi:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë "Për rritjen e eficencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë" nr. 57 prot., i Prokurorisë së Përgjithshme, datë 17.01.2023;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit "Për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave", nr. 1311 prot., datë 14.08.2023 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe organizata me objekt veprimtarie këtë fushë.

Udhëzimet e përgjithshme në zbatim të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar janë të publikuara në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe i janë dërguar për zbatim të gjithë prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Drejtuesit e prokurorive janë udhëzuar për marrjen e masave në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, si për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët për çështje konkrete, me synim, që të garantojnë pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe të sigurojnë eficencën, ligjshmërinë e transparencën në veprimtarinë e prokurorive që drejtojnë.

3.2 Në kuadrin e mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, në mbështetje të nenit 148/b shkronja "b" e Kushtetutës, neneve 38 pika 2 shkronjat "b", "c", "f", 104 pika 2 e vijues të ligjit nr. 97/2016 i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm për të mbikëqyrur zbatimin dhe ndikimin e udhëzimeve të përgjithshme në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara dhe efektivitetin e ushtrimit të ndjekjes penale në fushat përkatëse, u ka kërkuar periodikisht informacione drejtuesve të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm për masat e marra në zbatim të kompetencave ligjore të tyre, nëse kanë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe nëse kanë marrë masa për koordinimin e veprimtarisë me prokuroritë e tjera, apo për kërkimin e informacionit për ecurinë e procedimeve dhe/ose për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët lidhur me çështje konkrete, apo nxjerrjen e urdhrave për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve të tyre.

Kjo veprimtari ka synuar dhe synon që drejtuesit e prokurorive të sigurojnë efiçencën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë, si dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurorët e prokurorisë që drejtojnë, në përmbushje të rekomandimeve, si në marrëdhënie me institucionet kushtetuese brenda vendit, ashtu dhe në marrëdhënie me institucionet apo autoritetet ndërkombëtare dhe në raportimin e progresit në kuadrin e integrimit evropian të vendit, gjithmonë duke garantuar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore.

3.3 Edhe gjatë vitit 2023, konstatohet e njëjta problematikë në koordinimin me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në kuadër të kërkesave për informacion. Ndërkohë, vërehet mungesa e rolit aktiv të drejtuesve të prokurorive në nxjerrjen e masave të plota administrative dhe/ose procedurale për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerra në kuadrin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe më pas në mbikëqyrjen apo ndjekjen efektive të tyre. Konstatohet gjithashtu nxjerrja e një numri të papërfillshëm udhëzimesh jo të detyrueshme për çështje konkrete.

## 4. Përmbledhje e tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara në kërkesat e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave, rekomandimet e BE-së për Shqipërinë, dhe jo vetëm, të përçuara nga Prokurori i Përgjithshëm nëpërmjet udhëzimeve dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, mbi tendencat e kriminalitetit të reflektuara në numrin e procedimeve të regjistruara, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

4.1 Për vitin 2023 vërehet **tendenca në ulje e numrit të procedimeve të regjistruara** për veprat penale si më poshtë:

- "Krimet Kundër jetës të kryera me dashje", **8,81 %;**
- "Krimet kundër jetës të shkaktuar me pakujdesi", **28,57 %.**
- "Veprat penale kundër shëndetit të shkaktuar me pakujdesi", **66,66** %;

- "Veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose nga mosdhënia e ndihmës", **6,97 %;**
- "Krimet seksuale", **23,46 %**;
- "Veprat penale kundër lirisë së personit[6]", **26,72 %**;
- "Veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit", **1,39 %;**
- "Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes[7]", **4,68 %;**
- "Veprat penale kundër vjedhjes së pasurisë[8]" **16,39 %;**
- "Veprat penale të mashtrimit[9]", **5,10 %;**
- Veprat penale të shkatërrimit të pronës", **15,63 %;**
- "Veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare[10]", **35,42 %;**
- "Veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare", **50 %;**
- "Krimet në fushën e doganave", **6,56 %**;
- "Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet", **40,26 %**;
- "Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë", **43,18 %**;
- "Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve[11]", **15,23 %**;
- "Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit", **3,08 %**;
- "Veprat penale kundër mjedisit", **7,80 %**;
- "Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit[12]", **9,62 %**;
- "Veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik[13]", **16,01 %**;
- "Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike[14]", **1,54 %**;
- "Veprat penale kundër pastrimit të parave", **35,25 %**;
- "Veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve[15]", **3,85 %.**
- "Veprat penale kundër korrupsionit", **35,11 %**.

4.2 Për sa i përket veprave penale të mëposhtme, vihet re **një rritje e numrit të procedimeve të regjistruara** për vitin 2023. Kështu:

- "Veprat penale kundër shëndetit të kryera me dashje", **1,50 %;**
- "Veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës", **12,86 %;**
- "Veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë", **9,20 %;**
- Veprat penale kundër drejtësisë[16]", **5,15 %;**
- "Veprat penale kundër krimit kompjuterik", **22,35 %**;
- "Veprat penale të trafiqeve të paligjshme", **47,59 %**;
- "Veprat penale kundër prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve", **13,81 %**.

4.3 Referuar analizës dhe vlerësimit të tendencave të kriminalitetit sipas grupveprave më sipër, bazuar në të dhënat statistikore, të trajtuara edhe tek efektiviteti i ndjekjes penale në raport,

[6] Veçuar trafikimi i personave të rritur;
[7] Veçuar trafiku i të miturve;
[8] Veçuar trafikimi i mjeteve motorike dhe trafikimi i veprave të artit dhe kultures;
[9] Veçuar mashtrimi kompjuterik;
[10] Veçuar korrupsioni në sektorin privat;
[11] Veçuar falsifikimi kompjuterik;
[12] Veçuar korrupsioni, neni 244 K.Penal;
[13] Veçuar korrupsioni, neni 259 K.Penal;
[14] Veçuar nenet lidhur me narkotikët, pastrimin e parave dhe krimin kibernetik;
[15] Veçuar nenet e korrupsionit në zgjedhje
[16] Veçuar nenet e korrupsionit në drejtësi

evidentohet se përgjithësisht ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara. Vlerësojmë se në këtë ulje ka patur ndikim edhe Memorandumi i Bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe udhëzimi mbi zbatimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe trajtimin e referimeve të tjera që dukshëm nuk përmbajnë elementë të ndonjë vepre penale, në bazë të të cilave për vitin 2023 rezultojnë 4588 materiale.

## 5. Efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë të veprimtarisë së institucionit

Në analizë dhe vlerësim të ndikimit të politikave institucionale dhe politikave të rekomanduara nga institucionet kushtetuese, të përçuara nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve normative të tjera në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, mbi disa tregues siç janë dhe efektiviteti i ndjekjes penale, cilësia e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe elemente të tjerë thelbësorë në ndjekjen penale, dhe jo vetëm, evidentohen treguesit statistikorë, si më poshtë:

### 5.1 ***Tregues të përgjithshëm të efektivitetit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të çështjeve/akuzave në gjyq***

i) Gjatë vitit 2023 janë përfunduar 23419 çështje që përbën ulje prej 9,41 % të çështjeve të përfunduara krahasuar me vitin 2022, prej të cilave: 41,21 % janë dërguar për gjykim, 25,76 % janë pushuar, 30,04 % janë pezulluar dhe 2,99 % janë transferuar në prokuroritë kompetente.

ii) Janë dërguar në gjykatë 9652 çështje me akuzë ndaj 11401 të pandehurve. Krahasimisht me vitin 2022 rezulton një ulje prej 12,13 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 11,87 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

iii) Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 janë dënuar 7254 të pandehur që krahasuar me vitin 2022 përbën ulje 31,22 % të numrit të pandehurve të dënuar, dhe për 199 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm ose për 2,67 %.

iv) Në gjykatë janë dërguar 136 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 139 të pandehur ose krahasuar me vitin 2022 me ulje 46,46 % e numrit të kërkesave dhe ulje 47,55 % e numrit të të pandehurve, ndërsa nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal dhe kthimi i akteve në 5 raste ndaj 8 rasteve në vitin 2022 dhe refuzimi i urdhrit penal dhe pushimi i çështjes në 3 raste, ndaj 1 rasti në vitin 2022.

v) Në gjykatë gjithashtu janë dërguar 143 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 148 të pandehur ose krahasuar me vitin 2022 me ulje 46,04 % të numrit të kërkesave për miratim marrëveshje dhe ulje 44,78 % të numrit të të pandehurve, ndërkohë nga gjykata është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes dhe kthimi i akteve në 5 raste, tregues në ulje krahasuar me 12 raste në vitin 2022, dhe refuzimi i miratimit të marrëveshjes dhe pushimi i çështjes në asnjë rast ndaj 5 rasteve në vitin 2022.

vi) Gjatë vitit 2023, u dërguan në gjykatë për pushim 4912 çështje ose me ulje 9,71 % krahasuar me vitin 2022. Nga të dhënat rezulton se për 133 çështje gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ose me ulje 5 % krahasuar me vitin 2022, ndërsa në 3 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe formulimi i akuzës, shifër në ulje krahasuar me 6 çështje për të cilat janë kthyer aktet për formulim akuze në vitin 2022.

vii) Ndërkohë, është kërkuar gjykimi i drejtëpërdrejtë për 283 çështje me 286 të pandehur, që krahasuar me vitin 2022, përbëjnë rritje prej 15,51 % të numrit të çështjeve dhe 15,79 % të numrit të të pandehurve për të cilët është kërkuar ky lloj gjykimi.

### 5.2 ***Efektiviteti i përgjimit të komunikimeve elektronike në hetimet paraprake***

i) Gjatë vitit 2023, në kuadrin e 514 procedimeve penale, me anë të përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore, në zbatim të kritereve ligjore, është arritur në arrestimin/ndalimin e 474 personave të dyshuar për krime kundër rendit dhe sigurisë publike, kundër jetës dhe kundër autoritetit të shtetit, dhe për vepra penale kundër lirisë së personit, korrupsion, shpërdorim detyre, në fushën e narkotikëve, pastrimi produkteve të veprimtarisë kriminale, trafiqe të paligjshme e vepra të tjera të rënda, duke parandaluar kështu pasoja të mëtejshme për shtetin dhe shtetasit.

ii) Në shifra të përgjithshme, gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar 1121 vendime për përgjim të autorizuara nga gjykata në hetimet paraprake dhe 456 autorizime dhe urdhra të prokurorit. Për sa më sipër është mundësuar interceptimi për 2675 pajisje fundore në përdorim të 2492 personave të dyshuar si të përfshirë në vepra penale.

Ecuria e këtij mjeti kërkimi prove në dy vitet e fundit paraqitet në grafikun në vijim:




Grafiku më poshtë paraqet procedimet sipas grupveprave penale për të cilat është kërkuar përgjimi i komunikimeve elektronike në hetimet paraprake:



# II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT, TË DHËNA PËR NUMRIN, LLOJET, SHTRIRJEN TERRITORIALE DHE FORMAT

## VOLUMI I PUNËS NË HETIM PËR VITIN 2023[17]

Gjatë vitit 2023, në organin e prokurorisë janë trajtuar 55347 materiale në shqyrtim[18] që përbën një ulje prej 9,44 % në krahasim me vitin 2022. Janë ndjekur gjithsej 45401 procedime penale, që përbëjnë një ulje prej 6,03 % në krahasim me vitin 2022, nga të cilat: 24146 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 6,18 % në krahasim me vitin 2022; 21054 janë procedime penale të mbartura, me një ulje prej 3,79 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2022 dhe 201 janë procedime penale të rifilluara.
Është vendosur mosfillimi për 9946 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 22,29 % në krahasim me vitin 2022.

Volumi i punës në hetim i organit të prokurorisë për vitin 2023 paraqitet si vijon:




[17] Procedimi penal nuk njësohet me vepër penale, pasi:

1- Sistemi statistikor i prokurorisë regjistron të dhëna **për veprën penale më të rëndë**, pavarësisht se mund të jenë kryer disa vepra penale.
2- Në bazë të nenit 79 e 93 të Kodit të Procedurës Penale prokurori vendos bashkimin ose ndarjen e procedimeve.

[18] Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara/shqyrtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2023 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2023; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2023.

## 2.2 ÇËSHTJE TË PËRFAQËSUARA NË GJYKATË

Gjatë vitit 2023 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar për 9701 procedime penale (ulje prej 11,86 % në krahasim me vitin 2022) me 11450 të pandehur (ulje prej 11,64 % në krahasim me vitin 2022). Gjithashtu, janë paraqitur në gjykatë 12259 kërkesa lidhur me masat e sigurimit personal.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës të Shkallës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është përfaqësuar akuza në emër të shtetit shqiptar për 1345 çështje themeli (ulje prej 30,49 % në krahasim me vitin 2022) dhe 2370 raste për masat e sigurimit personal (ulje prej 8,71 % në krahasim me vitin 2022).

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës pranë Gjykatës së Lartë në 51 çështje, prej të cilave 30 gjykime themeli (nga 65 gjykime themeli në vitin 2022), 2 përfaqësime në gjykime për të njësuar/ndryshuar praktikën gjyqësore dhe 19 mendime për çështje të shqyrtuara në dhomë këshillimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 22 çështje (nga 11 çështje në vitin 2022).

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat në përqindje për çështjet e përfaqësuara në gjykatë në të tre shkallët:




## 2.3 TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË NË PESË VITET E FUNDIT

**Procedime të regjistruara dhe në ndjekje**

Në vitin 2023 janë regjistruar 24146 procedime penale, me një ulje prej 6,18 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 janë regjistruar 25737 procedime penale, me një ulje prej 9,27 % krahasuar me vitin 2021 në të cilin rezultojnë 28368 procedime penale të regjistruara, që krahasuar me vitin 2020, përbën rritje prej 1,71 % ndërkohë që në vitin 2020 janë regjistruar 27890 procedime penale që përbën ulje prej 9,29 % krahasuar me 30748 procedime të vitit 2019.

Në vitin 2023 rezultojnë 45809 procedime penale në ndjekje me një ulje prej 5,19 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezultojnë 48315 procedime penale në ndjekje me një rritje prej 1,69 % krahasuar me vitin 2021 në të cilin rezultojnë 47512 procedime, që përbën rritje prej 5,97 % krahasuar

me vitin 2020 ndërkohë që në vitin 2020 rezultojnë 44834 procedime në ndjekje penale që përbën rritje prej 1,23 % krahasuar me 44289 procedime të vitit 2019.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit:




**Ndjekja penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak**

Pesha specifike që zënë procedimet penale të regjistruara në bazë të Kodit Penal Ushtarak në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në prokurori gjatë vitit 2023 është 0,21 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 0,11 %.

Në vitin 2023, janë regjistruar 51 procedime penale në bazë të Kodit Penal Ushtarak, janë mbartur 43 procedime penale, ndërkohë për këtë periudhë nuk rezultojnë vendime për të rifilluar procedime penale ushtarake dhe as vendime mosfillimi.

Gjatë vitit 2023 nga prokuroritë pranë gjykatës të shkallës së parë është ngritur akuza në gjykatë në emër të shtetit shqiptar në 49 procedime penale, janë pushuar 3 procedime penale dhe është pezulluar 1 procedim penal.

Grafikët në vijim paraqesin të dhënat e volumit të punës në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës, për veprat penale në fushën e zbatimit të Kodit Penal Ushtarak:









Në vijim të dhënat lidhen me vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, ligji nr. 7895/1995 i ndryshuar.

**Çështje të përfunduara**

Në lidhje me **çështjet e përfunduara**[19], të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2023 rezulton një ulje prej 9,41 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton një rritje prej 0,64 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 rezulton një ulje prej 1,84 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2020 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 7,14 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e pushuara**, në vitin 2023 rezulton një ulje prej 7,80 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton një rritje prej 12,56 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 rezulton ulje prej 1,82 % e çështjeve të pushuara në krahasim me vitin 2020 dhe në vitin 2020 rezulton një rritje prej 1,67 % e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e pezulluara**, në vitin 2023 rezulton një ulje prej 9,38 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton një ulje prej 10,39 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 rezulton ulje prej 7,84 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2020 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 6,80 % e çështjeve të pezulluara në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me **çështjet e dërguara në gjykatë**[20], në vitin 2023 rezulton një ulje prej 12,13 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton një rritje prej 4,64 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 rezulton një rritje prej 5,25 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2020 dhe në vitin 2020 rezulton një ulje prej 4,07 % e çështjeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2019.

Lidhur me numrin e të **pandehurve** të dërguar në gjykatë vërehet se në vitin 2023 rezulton një ulje prej 11,87 % e numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton një rritje prej 4,80 % e numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është rritur me 7,3 % krahasuar me vitin 2020 dhe në vitin 2020 numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është ulur me 5,39 % krahasuar me vitin 2019.

Më poshtë paraqiten në mënyrë grafike të dhënat e pesë viteve të fundit lidhur me çështjet sipas mënyrës së përfundimit:

[19] Në këtë tregues përveç çështjeve të pushuara, pezulluara dhe dërguar gjyqit mblidhen edhe çështjet e transferuara.

[20] Në këtë tregues janë përfshirë edhe kërkesat për dërgimin e çështjes në gjykatë drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake si dhe kërkesat për miratimin e urdhrit penal dhe marrëveshjes së fajësisë.




Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të ndjekjes penale në hetimet paraprake në pesë viteve të fundit:




## Vendimmarrja e gjykatës

Vendi që zënë vendimet e gjykatës për **pushimin e çështjeve**, përkundrejt numrit total të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2023 përbën 1,08 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2022 përbën 2,10 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2021 përbën 1,35 % të çështjeve të dërguara në gjyq, në vitin 2020 ky tregues është 1,28 %, ndërsa në vitin 2019 ky tregues është 1,74 %.

Në lidhje me **pushimin e akuzës** për të pandehurit, në vitin 2023 është vendosur pushimi i akuzës për 0,22 % të akuzave të ngritura, në vitin 2022 është vendosur pushimi i akuzës për 0,17 % të akuzave të ngritura, në vitin 2021 është vendosur pushimi i akuzës për 0,18 % të akuzave të ngritura, në vitin 2020 është vendosur pushimi i akuzës për 0,13 % të akuzave të ngritura, ndërsa në vitin 2019 është vendosur pushimi i akuzës për 0,10 % të akuzave të ngritura.

Në lidhje me **vendimet e gjykatës për pafajësinë**, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,75 % kanë marrë pafajësi, në vitin 2022 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,68 % kanë marrë pafajësi, në vitin 2021 nga totali i të pandehurve të dërguar në gjykatë 1,17 % kanë marrë pafajësi, në vitin 2020 kanë marrë pafajësi 1,32 % e totalit të pandehurve të dërguar në gjykatë, ndërsa në vitin 2019 kanë marrë pafajësi 1,55 % e totalit të pandehurve të dërguar në gjykatë.

Më poshtë paraqiten të dhëna në pesë vite (2019-2023) në lidhje me të pandehurit për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë nga organi i prokurorisë dhe vendimet e gjykatës për dhënie pafajësie:




## Pezullimet

Në vitin 2023 procedimet për të cilat është vendosur pezullimi i hetimeve përbëjnë 30,04 % të procedimeve të përfunduara. Të dhënat tregojnë se ndër 7036 procedime të pezulluara, 7034 prej tyre janë pezulluar për shkak se nuk njihet autori i veprës penale dhe 2 procedime penale janë pezulluar për shkak se i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm.

Grafiku në vijim paraqet të dhënat për procedimet e pezulluara në vitet 2019-2023:




Procedimet penale të pezulluara sipas grup veprave penale për vitin 2023, paraqiten grafikisht si më poshtë (në grafik nuk janë përfshirë procedimet e pezulluara për grup veprat penale numri i të cilave është më i ulët se 20):



**Mosfillimet**

Në lidhje me referimet dhe kallëzimet për të cilat është vendosur mosfillimi, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 9946 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 22,27 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 12795 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 5,24 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13503 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 0,94 % krahasuar me vitin 2020 dhe në vitin 2020 të dhënat statistikore tregojnë se është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 13631 referime dhe kallëzime ose një ulje prej 12,60 % kundrejt vendimeve të mosfillimit të marra në vitin 2019.

Të dhëna të detajuara gjenden në grafikun e mëposhtëm:




## 2.4 PROCEDIME PENALE TË REGJISTRUARA SIPAS PROKURORIVE PRANË GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM

Paraqitja grafike në vijim paraqet të dhënat për procedimet penale të regjistruara në prokuroritë e shkallës së parë në vitin 2023.

Siç vërehet, numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara rezulton në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë me 35,12 % të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi; në vijim, Durrës 11,14 %; Fier 8,54 %; Shkodër 6,63 %; Korçë 6,47 %; Vlorë 6,27 %; Elbasan 6,12 %; Lezhë 5,73 %; Sarandë 3,64 %; Berat 3,11 %; Gjirokastër 2,55 %; Kukës 2,37 %; Dibër 2,31 % të numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi.




## 2.5 KOEFICIENTËT E KRIMINALITETIT PËR 100,000 BANORË[21]

Koeficienti i kriminalitetit për procedimet penale të regjistruara, për 100,000 banorë në vitin 2023 është **872,** ndërsa në vitin 2022 koefiçenti i kriminalitetit ka qenë **920.** Në lidhje me koeficientet e kriminalitetit për 100,000 banorë sipas qarqeve, të dhënat statistikore rezultojnë si më poshtë:

Në qarkun Berat që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë në vitin 2023 është 672; në qarkun Dibër që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 523; në qarkun Elbasan që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 583; në qarkun Fier që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 758; në qarkun Gjirokastër që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1154; në qarkun Korçë që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 809; në qarkun Kukës që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 797; në qarkun Lezhë që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1209; në qarkun Shkodër që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 844; në qarkun Vlorë që përfshin Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 1301 dhe në qarqet Tiranë e Durrës që përfshijnë Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë e Durrës koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë është 917.[22]

Siç rezulton nga të dhënat, përqindjen më të ulët të koeficientit të kriminalitetit në vitin 2023 e ka qarku Dibër, ndërsa përqindjen më të lartë e ka qarku Vlorë.

[21] https://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2

[22] Për këtë analizë, këtu e në vijim popullsia dhe numri i procedimeve për qarqet dhe prokuroritë Tiranë e Durrës janë mbledhur pasi nuk disponohen të dhëna për popullsinë sipas rretheve gjyqësore, ndërkohë që ndarja territoriale dhe e popullsisë së qarqeve është e ndryshme nga ajo e sistemit gjyqësor. Konkretisht Kruja i përket rrethit gjyqësor Tiranë dhe Kavaja rrethit gjyqësor Durrës.

Renditja dhe të dhënat e kriminalitetit në pesë vitet e fundit paraqiten grafikisht në vijim:






## 2.6 TË DHËNA NË LIDHJE ME NJOFTIMET PËR VEPRAT PENALE

Bazuar në të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 janë **filluar kryesisht** 138 procedime penale nga ana e prokurorisë.

**Kallëzime nga nëpunësit publikë:** në vitin 2023 rezulton të kenë ardhur në prokurori 650 kallëzime, që përbën ulje prej 36,95 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1031 kallëzime, që përbën rritje prej 27,28 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 810 kallëzime, që përbën ulje prej 3,57 % krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 840 kallëzime, që përbën ulje prej 41,59 % krahasuar me vitin 2019.

**Kallëzime nga personeli mjekësor:** në vitet 2020-2023, nuk rezultojnë kallëzime nga personeli mjekësor.

**Kallëzime nga shtetasit:** në vitin 2023 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2328 kallëzime, që përbën ulje prej 2,51 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2388 kallëzime, që përbën ulje prej 1,36 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 2421 kallëzime, që përbën rritje prej 36,56 % krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 1769 kallëzime, që përbën ulje prej 46,70 % krahasuar me vitin 2019.

**Kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim:** në vitin 2023 rezulton të kenë ardhur në prokurori 154 ankime nga viktima, që përbën rritje prej 12,41 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton të kenë ardhur në prokurori 137 ankime nga viktima, që përbën ulje prej 26,74 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 187 ankime nga viktima, që përbën rritje prej 0,57 % krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 186 kallëzime për vepra penale që ndiqen mbi ankim, që përbën ulje prej 6,53 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2023 rezulton të jetë marrë njoftim për 3063 ngjarje, që do të thotë ulje prej 7,85 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton të jetë marrë njoftim për 3324 ngjarje, që do të thotë ulje prej 25,49 % në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 rezulton të jetë marrë njoftim për 4461 ngjarje, që do të thotë ulje prej 8,9 % në krahasim me vitin 2020, ndërkohë që gjatë vitit 2020 rezulton të jetë marrë njoftim për 4897 ngjarje, që do të thotë ulje prej 12,93 % në krahasim me vitin 2019.

**Referime nga Policia e Shtetit dhe polici të tjera me atributet e policisë gjyqësore,** në vitin 2023 rezulton të kenë ardhur në prokurori 32418 referime, që përbën rritje prej 2,73 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezulton të kenë ardhur në prokurori 31557 referime, që përbën ulje prej 6,25 % në krahasim me vitin 2021, ndërkohë që në vitin 2021 rezulton të kenë ardhur në prokurori 33662 referime, që përbën rritje prej 5,86 % në krahasim me vitin 2020, ndërkohë që në vitin 2020 rezulton të kenë ardhur në prokurori 31798 referime që përbën ulje prej 13,50 në krahasim me vitin 2019.

Të dhënat e pesë viteve për njoftimet për vepra penale paraqiten në grafikun më poshtë:




## 2.7 TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PENALE TË FORMËS SË PRERË

Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 urdhrat për ekzekutim e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë (në vijim: vendime) të dënimeve kryesore me burgim, gjobë dhe dënime plotësuese, zënë 35,40 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori, ndërsa urdhrat për ekzekutim të dënimeve alternative zënë 64,60 % të totalit të urdhrave për ekzekutim të lëshuara nga prokurori. Krahasuar me vitin 2022, urdhrat e ekzekutimit për dënimet me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë dhe dënime plotësuese kanë pësuar një ulje prej 8,02 %, ndërsa ato për dënimet alternative kanë pësuar një ulje prej 24,25 %.

Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar 4627 vendime, ndërsa kanë mbetur pa u ekzekutuar 2093 vendime. Numri i vendimeve sipas llojit të tyre të mbetura pa ekzekutuar është 712 vendime me burgim, 289 vendime për dënime me gjobë, 5 dënime plotësuese dhe 1087 dënime alternative.

Grafikun në vijim paraqet raportin në përqindje të vendimeve të ekzekutuara dhe të vendimeve të pa ekzekutuara:




## 2.8 KRIMINALITETI SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

**Raporti krime dhe kundërvajtje**

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2023, sipas ndarjes në krime dhe kundërvajtje penale[23] duke përfshirë të dhëna që lidhen me procedimet penale të regjistruara në prokurori sipas veprave penale:




**Raporti i grupveprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, rezulton si vijon:**

- Raporti që zënë **krimet kundër njerëzimit**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0 %;

[23] Në këtë shifër janë përfshirë edhe veprat penale për të cilat parashikohet dënim deri në 2 vjet

- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me dashje**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,38 %[24];
- Raporti që zënë **krimet kundër jetës të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,02 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me dashje** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,81 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër shëndetit të kryera me pakujdesi** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,02 %;
- Raporti që zënë v**eprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose mosdhënia e ndihmës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,11 %;
- Raporti që zënë **krimet seksuale** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,51 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së personit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,38 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,18 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 6,20 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër lirisë së besimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0 %;
- Raporti që zë **vjedhja e pasurisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 23,64 %;
- Raporti që zënë **mashtrimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,85 %;
- Raporti që zë **shkatërrimi i pronës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 3,94 %;
- Raporti që zënë **veprat penale të kryera në shoqëritë tregtare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,13 %;
- Raporti që zënë veprat penale në lidhje **me veprimtarinë bankare dhe financiare** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,05 %;
- Raporti që zënë **krimet në fushën e doganave** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,00 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,78 %;
- Raporti që zë **falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,10 %;
- Raporti që zë **falsifikimi i dokumenteve** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,93 %;
- Raporti që zënë **veprat penale në fushën e falimentimit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,01 %;
- Raporti që zë **zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,05 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 6,08 %;

[24] Përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë.

- Raporti që zënë **veprat penale kundër mjedisit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 1,42 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër pavarësisë dhe integritetit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër rendit kushtetues** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0 %;
- Raporti që zënë **krimet që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0 %;
- Raporti që zënë **veprat me qëllime terroriste** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,02 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,39 %;
- Raporti që zënë **krimet kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,28 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 31,71 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 3,35 %;
- Raporti që zënë **veprat penale kundër drejtësisë** në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 2,54 %;
- Raporti që zënë **veprat penale që prekin zgjedhjet e lira**, në numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara në prokurori për vitin 2023, është 0,12 %.

Numri i procedimeve sipas grup veprave penale, raporti i tyre me numrin e përgjithshëm të procedimeve të regjistruara gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, dhe tendenca në pesë vite paraqiten si më poshtë (grupvepra me mbi 25 procedime penale të regjistruara):

| Grup veprat | Procedime regjistruar 2022 | Procedime regjistruar 2023 | Ndryshimi % dy vite | Tendenca 2019-2023 |
|---|---|---|---|---|
| Kundër rendit dhe sigurisë publike | 29% 7570 | 32% 7641 | 1% | 7321 7369 8187 7570 7641 |
| Vjedhja e pasurisë | 26% 6724 | 24% 5695 | -15% | 9668 8700 7899 6724 5695 |
| Kundër fëmijëve, martesës dhe familjes | 6% 1564 | 6% 1494 | -4% | 1247 1358 1491 1564 1494 |
| Kundër regjimit juridik të tokës | 5% 1299 | 6% 1466 | 13% | 1909 1748 1957 1299 1466 |
| Shkatërrimi i pronës | 4% 1126 | 4% 950 | -16% | 1258 1142 1158 1126 950 |
| Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë | 3% 739 | 3% 807 | 9% | 1457 876 860 739 807 |
| Falsifikimi i dokumenteve | 3% 787 | 3% 705 | -10% | 1188 753 848 787 705 |
| Mashtrimet | 3% 696 | 3% 687 | -1% | 745 627 752 696 687 |
| Kundër shëndetit me dashje | 3% 667 | 3% 677 | 1% | 903 862 823 667 677 |
| Kundër drejtësisë | 2% 583 | 3% 613 | 5% | 681 504 555 583 613 |
| Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit | 3% 717 | 2% 575 | -20% | 637 695 605 717 575 |
| Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik | 3% 646 | 2% 549 | -15% | 997 660 609 646 549 |
| Kundër mjedisit | 1% 372 | 1% 343 | -8% | 264 331 314 372 343 |
| Kundër jetës me dashje | 1% 354 | 1% 332 | -6% | 434 515 460 354 332 |
| Kundër moralit dhe dinjitetit | 1% 288 | 1% 284 | -1% | 276 225 285 288 284 |
| V.P që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e | 1% 287 | 1% 267 | -7% | 399 426 350 287 267 |
| Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit | 1% 260 | 1% 252 | -3% | 144 128 217 260 252 |
| Krime në fushën e doganave | 1% 259 | 1% 242 | -7% | 160 164 168 259 242 |
| Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet | 1% 313 | 1% 187 | -40% | 415 300 316 313 187 |
| Krime seksuale | 1% 162 | 1% 124 | -23% | 158 136 158 162 124 |
| Kundër lirisë së personit | 123 | 91 | -26% | 128 139 111 123 91 |
| Vepra penale në shoqëritë tregtare | 49 | 32 | -35% | 82 45 54 49 32 |
| Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve | 27 | 29 | 7% | 35 5 60 27 29 |
| Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë | 44 | 25 | -43% | 85 78 64 44 25 |

Në vijim do të analizohet në mënyrë më të detajuar secili nga seksionet e Kodit Penal:

## 2.9 ANALIZA E VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

### KRIME KUNDËR NJËRËZIMIT

Në vitin 2023 nuk rezultojnë procedime të regjistruara në lidhje me krimet e parashikuara në Kreun I të Kodit Penal, “Krime kundër njerëzimit”.

### KRIME KUNDËR JETËS TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike[25] që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 është 1,20 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2022 ky grup veprash përbënte 1,24 % të totalit të procedimeve. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 10,50, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 11,38.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 1), rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 8,81 % të numrit të procedimeve të regjistruara për “Krime kundër jetës të kryera me dashje” në krahasim me vitin 2022 dhe ulje prej 5,75 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit regjistruar për këtë grup veprash penale vihet re ulje prej 17,96 %, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur 18,03 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 56,90 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër jetës të kryera me dashje për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




[25] “Pesha specifike” është llogaritur si raport i grupveprave të renditura në tabelë me numrin total të procedimeve të regjistruara. Për shkak të grupimit të veprave jo gjithmonë sipas strukturës së Kodit Penal, por edhe sipas fushës, mund të mos ketë përputhje midis këtij treguesi dhe raportit të grup veprave me numrin e procedimeve të regjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal.

## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 97,06 % e tyre janë meshkuj (nga të cilët 3,78 % janë të mitur) dhe 2,94 % janë femra (ndër të cilat 1 e pandehur rezulton e mitur).
Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se për këto grup veprash penale 2,94 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të lartë, 41,91 % e të pandehurve të regjistruar janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër e të pandehurve, prej 55,15 % rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.
Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 74,54 % e të pandehurve janë të papunë, 25,45 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat.
Rezulton se, rreth 66,91 % e të pandehurve për këtë grup veprash janë banues në qytet dhe 33,09 % e tyre, në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vihet re se 1,53 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, 13,74 % e tyre janë përsëritës për vepra të tjera dhe 84,73 % janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të krimeve kundër jetës të kryera me dashje në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime kundër jetës të kryera me dashje është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Tiranë, regjistruar përkatësisht rreth 21 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër në shkallë vendi; Fier dhe Korçë me nga 13 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër regjistruar 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër dhe Sarandë ku janë regjistruar rreth 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Vrasja me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" për vitin 2023 është 4,83 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 7,86 %.
Të dhënat statistikore tregojnë se në vitin 2023 janë regjistruar 14 procedime për veprën penale të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal "Vrasja me dashje", që rezulton me një ulje prej 44 % në krahasim me vitin 2022.

### Vrasja me paramendim

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" për vitin 2023 është 5,17 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 10,38 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023, ka një ulje prej 54,55 % të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 78 "Vrasja me paramendim", krahasuar me vitin 2022.

### Vrasja në rrethana të tjera cilësuese

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" është 5,86 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 4,09 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023, ka një rritje prej 30,77 % të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 79 i Kodit Penal "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", krahasuar me vitin 2022.

### Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" është 4,14 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 4,40 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 janë regjistruar 12 procedime penale për veprën penale të vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare, që ndaj 14 procedimeve të regjistruara në vitin 2022, përbën ulje prej 14,29 %.

### Kanosja

Në grupin e veprave penale "Krime kundër jetës të kryera me dashje" peshën specifike më të lartë e përbën vepra penale e parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal "Kanosja", që në vitin 2023 zë 76,90 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 69,81 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 ka një rritje të lehtë prej 0,45 % të procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër, krahasuar me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 97,05 % janë meshkuj madhorë, 55,15 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 74,54 %, janë të papunë dhe 13,74 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për krime kundër jetës me dashje, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 21 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 26 procedime dhe Korçë me 19 procedime.
**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, 85,29 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 83 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit, rezulton se në 88,46 % të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 11,54 % dënim me gjobë (ku të gjitha rastet i përkasin kanosjes). Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 19,56 % të të pandehurve (88,89 % e të cilëve të akuzuar për kanosje), 6,52 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 41,31 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 21,74 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 10,87 % e kërkesave rezultojnë për dënim të përjetshëm. Gjykata ka vendosur në 95 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 10 % dënim me gjobë, ndërkohë që kemi 6 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 22,22 % të të pandehurve (75 % e të cilëve për kanosje), 11,11 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 37,78 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 20 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 8,89 % dënime të përjetshme.
**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar hetimet për 53 procedime që përbëjnë 18,28 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2022 kjo peshë ishte 22,3 %.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë 92,86 % viktima të rritur dhe 7,14 % (të mitur nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 73,08 % janë meshkuj dhe 26,92 % janë femra.

## KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI

Nga të dhënat statistikore (tabela 2) rezulton se në vitin 2023 për “Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi”, janë regjistruar 5 procedime penale dhe 5 të pandehur, ndaj 7 procedimeve penale dhe 2 të pandehurve të regjistruar në vitin 2022. Sa i përket numrit të procedimeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë, rezulton rritje nga 2 procedime me 2 të pandehur në vitin 2022, në 4 procedime me 4 të pandehur në vitin 2023, ndërkohë janë dënuar 3 të pandehur për këtë vepër gjatë vitit 2023.

## VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 është 2,81 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, ndërsa për vitin 2022 ky grup veprash përbënte 2,59 % të totalit të procedimeve. Pra, vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 24,51, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 23,88.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 3), rezulton se, në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara është rritur me 1,50 %, numri i procedimeve të dërguara në gjykatë ka pësuar ulje prej 0,38 %, numri i të pandehurve të regjistruar rezulton me ulje 14,08 %, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është rritur me 1,99 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur me 24,28 % krahasuar me vitin 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Në lidhje me gjininë e të pandehurve vihet re se 2,17 % e tyre janë femra dhe 97,83 % janë meshkuj, ndër të cilët 7,32 % janë të mitur (14-18 vjeç).
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se për këto grup veprash penale 5,64 % e tyre janë me arsim të lartë, 46,85 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe pjesa tjetër prej 47,51 % e të pandehurve, rezultojnë me arsim deri 9-vjeçar.
Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 83,41 % e të pandehurve janë të papunë, rreth 16,59 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat.
Rezulton se 59,44 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 40,56 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 12,19 % prej tyre janë të dënuar për vepra të tjera penale dhe 87,59 % janë të padënuar më parë dhe 0,22 % janë të dënuar për të njëjtën vepër penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale të kryera me dashje kundër shëndetit është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Tiranë regjistruar 31 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto grupvepra në shkallë vendi, Korçë 13 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Kukës dhe Gjirokastër, regjistruar rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi, për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Plagosja e rëndë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e "Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit" për vitin 2023 është 14,77 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 14,54 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 ka një tendencë në rritje prej 3,09 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i Kodit Penal "Plagosja e rëndë me dashje", në krahasim me vitin 2022.

## Plagosja e lehtë me dashje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e "Veprave penale të kryera me dashje kundër shëndetit" për vitin 2023 është 82,57 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 82,01 %.
Në vitin 2023, të dhënat statistikore tregojnë tendencë në rritje prej 2,19 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal "Plagosja e lehtë me dashje", krahasuar me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 97,83 % janë meshkuj madhorë, 47,51 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 83,41 % janë të papunë, 12,19 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për krime kundër shëndetit me dashje, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 31 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Korçë me 46 procedime, qarku Lezhë me 33 procedime dhe qarku Vlorë me 32 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 74,80 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 70,87 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 69,35 % e të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 30,65 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 11 kërkesa për pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 46,51 % të të pandehurve, 23,26 % e kërkesave rezulton për

caktimin e dënimit në minimum, 27,91 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 0,76 % në maksimumin e dënimit të parashikuar nga dispozita si dhe është kërkuar dënim me masën e paraburgimit për 1,56 % të rasteve. Gjykata ka vendosur në 74,46 % të dënimeve dënim me burg dhe në 25,54 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë vendosur 12 pushime çështjesh dhe 3 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 57,66 % të të pandehurve, në 14,59 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum, 27,75 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 8,27 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 dhe 7,8 % në vitin 2022, përkatësisht 56 procedime të pezulluara në vitin 2023 dhe 52 procedime të pezulluara në vitin 2022.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë 88,02 % viktima të rritur dhe 11,98 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 92,67 % janë meshkuj dhe 7,33 % janë femra.

## VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA

Të dhënat statistikore të vitit 2023 (tabela 4) tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara për "Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia" krahasuar me vitin 2022, është ulur nga 12 në 4 procedime të regjistruara. Për këtë periudhë rezulton 1 procedim dërguar në gjykatë, 1 i pandehur regjistruar dhe 1 i pandehur dërguar në gjykatë.

## VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZËNËSISË OSE MOSDHËNIA E NDIHMËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,11 %. Ky tregues për vitin 2022 ka qenë 1,12 %, pra vihet re ulje e lehtë e tij për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 9,67, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 10,27.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 5) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 6,97 % të numrit të procedimeve të regjistruara për "Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose nga mosdhënia e ndihmës", në krahasim me vitin 2022. Numri i procedimeve dërguar në gjykatë është ulur nga 10 në 7, numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 3 në 1 dhe numri i të pandehurve dërguar në gjykatë është i njëjtë, 12. Në lidhje me numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata, rezultojnë 2 të pandehur të dënuar në vitin 2023, kundrejt 10 të pandehurve në vitin 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose mosdhënia e ndihmës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të gjithë të pandehurit rezultojnë të moshës madhore dhe meshkuj. Ndërkohë rezulton 1 shtetas i huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 81,25 % e të pandehurve janë me arsim të lartë, 12,50 % janë me arsim të mesëm dhe 6,25 % janë me arsim deri 9-vjeçar.
Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 75 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin shtetëror.
Rezulton se 62,50 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet ndërsa pjesa tjetër në fshat, ndërsa në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 93,75 % e tyre janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 29 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Korçë regjistruar 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier regjistruar 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër regjistruar 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Gjirokastër, Sarandë, regjistruar secila 1 % e ose më pak se 1% e totalit të procedimeve në shkallë vendi, për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzënësisë ose mosdhënia e ndihmës.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënësisë ose nga mosdhënia e ndihmës” është 15,36% për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 16,03 %.
Të dhënat statistikore tregojnë se numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2023 për këtë vepër penale është ulur me 10,87 % krahasuar me vitin 2022.

## Shkaktimi i vetëvrasjes

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër shëndetit të kryera nga pakujdesia” është 83,90 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 81,18 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje prej 3,86 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal “Shkaktimi i vetëvrasjes”, në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatëzanisë ose mosdhënia e ndihmës, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 29 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Korçë me 35 procedime dhe në qarkun Fier me 14 procedime.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë 88 % viktima të rritur dhe 12% (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 65,90 % janë meshkuj dhe 34,10 % janë femra.

## KRIME SEKSUALE

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,51 % ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 0,63 %. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 4,49 ndërsa në vitin 2022 ka qenë 5,80.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 6) rezulton se në vitin 2023 ka ulje prej 23,46 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime seksuale në krahasim me vitin 2022 dhe një ulje prej 39,08 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 28,13 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 38,95 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18,18 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e krimeve seksuale për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Në lidhje me gjininë dhe moshën për të pandehurit, nga të dhënat statistikore rezulton se 94,74 % e të pandehurve (mbi 18 vjeç) janë meshkuj dhe 5,26 % janë femra. Ndërkohë nga numri i përgjithshëm i të pandehurve meshkuj, 2,7 % janë të mitur (14-18 vjeç).
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 56,41 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 37,18 % me arsim të mesëm dhe 6,41 % me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 78,05 % e të pandehurve janë të papunë, 21,95 % e të pandehurve janë të punësuar në sektorin privat.
Rezulton se 60,26 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 39,74 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 89,33 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 9,33 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme nga ajo që procedohen dhe vetëm 1,34 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime seksuale është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 39 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Durrës regjistruar 12 % e procedimeve, Fier dhe Vlorë përkatësisht me nga 8 % të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Elbasan, Kukës, Lezhë, regjistruar secila rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grup veprash dhe prokuroria Dibër me 1% të procedimeve në shkallë vendi për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

**Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur**
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime seksuale" në vitin 2023 është 13,71 %, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 13,58 %.
Në vitin 2023 vihet re ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i Kodit Penal "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur", prej 22,73 % në krahasim me vitin 2022.

**Ngacmimi seksual**
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Krime seksuale" është 59,68 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 53,70 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi krahasuar me vitin 2022.
Në vitin 2023, në grupin e krimeve seksuale vihet re një ulje prej 14,94 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 108/a i Kodit Penal "Ngacmimi seksual", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 94,74 % janë meshkuj madhorë, 2,7 % janë meshkuj të mitur, 56,41 % janë me arsim deri 9 – vjeçar, 78,05 % janë të papunë dhe 89,33 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për krime seksuale, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 39 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastër me 11 procedime dhe në qarkun Vlorë me 10 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 96,29 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 96,23 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 12,73 % të të pandehurve, 9,09 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 76,36 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,82 % rezulton caktim dënimi në maksimum. Gjykata ka vendosur në të gjithë dënimet, dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 14,82 % të të pandehurve, 14,81 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 68,52 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,85 % në maksimum të dënimit që parashikon dispozita.
**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 18,55 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 dhe 11,7 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2022, përkatësisht 23 të pezulluara në vitin 2023, dhe 19 procedime të pezulluara në vitin 2022.

**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 të gjitha viktimat janë femra. Nga numri total i viktimave rezultojnë 41,18 % viktima të mitura nën 18 vjeç dhe 58,82 % të rritura.

## VEPRA PENALE KUNDËR LIRISË SË PERSONIT

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,35 % dhe për vitin 2022 ka qenë 0,45%. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 3,08, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 4,15.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 7) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 26,72 % të numrit të procedimeve të regjistruara për "Vepra penale kundër lirisë së personit" dhe ulje prej 35,90 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit e regjistruar për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 21,43 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 10,20 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 32,56 %, përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e krimeve kundër lirisë së personit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Në lidhje me gjininë, 94,29 % e të pandehurve janë meshkuj (nga këta 4,55 % janë të mitur 14-18 vjeç) dhe 5,71 % janë femra.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 47,83 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 49,28 % me arsim të mesëm dhe 2,89 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror 3,57 % e të pandehurve, në sektorin privat janë punësuar 35,72 % e të pandehurve, dhe të papunë janë 60,72 %.
Rezulton se 81,43 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 18,57 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 86,15 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 13,85 % janë përsëritës për vepra të tjera penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër lirisë së personit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 33 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Fier regjistruar 13 %, Durrës dhe Elbasan regjistruar përkatësisht nga 9 %, Sarandë regjistruar 8 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokurorinë pranë gjykatës të shkallës së parë Dibër, regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për grupvepra kundër lirisë së personit, ndërkohë që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë grup veprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vepra penale kundër lirisë së personit" është 7,06 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 11,21 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet ulje e numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal "Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit" nga 13 procedime regjistruar në vitin 2022, në 6 procedime të regjistruara në vitin 2023.

### Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale për vitin 2023, në grupin "Vepra penale kundër lirisë së personit" është 51,77 % ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 40,52 %.
Nga të dhënat statistikore të vitit 2023 vërehet ulje prej 6,38 % (nga 47 në 44) e numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë" krahasuar me vitin 2022.

**Heqja e paligjshme e lirisë**
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër lirisë së personit" është 20 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 35,34 %.
Nga të dhënat statistikore të vitit 2023 vërehet ulje prej 58,54 % (nga 41 në 17) e numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal "Heqja e paligjshme e lirisë" krahasuar me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 94,29 % janë meshkuj, 49,28 % janë me arsim të mesëm, 60,72 % janë të papunë, dhe 13,85 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera penale.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër lirisë së personit është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 7 procedime dhe Fier,Gjirokastër dhe Lezhë me nga 4 Procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash 87,88 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 87,50 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 33,33 % të të pandehurve, 30 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 36,37 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Sa i përket masës së dënimit, është

vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 39,23 % të të pandehurve, 21,44 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 39,28 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, ndërkohë që ka vendosur në në 2 raste pafajësi.
**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 27 procedime që përbëjnë 31,76 % të procedimeve të regjistruara, ndërkohë që në vitin 2022 pesha që zinin procedimet e pezulluara ishte 30,17 %.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 të gjitha viktimat janë meshkuj madhorë.

## VEPRA PENALE KUNDËR MORALIT DHE DINJITETIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,18 % ndërkohë që në vitin 2022 ky tregues ka qenë 1,12 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 10,28 ndërsa në vitin 2022 ka qenë 10,31.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 8) rezulton se për "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit" në vitin 2023 ka një ulje prej 1,39 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje prej 6,45 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Ndërkaq rezulton ulje në lidhje me numrin e të pandehurve regjistruar për këtë grup veprash penale prej 1,64 % përkundrejt këtij totali në vitin 2022, rritje prej 33,98 % e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe ulje prej 51 % e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, krahasuar me vitin 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër moralit dhe dinjitetit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Në lidhje me gjininë, 80,92 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 19,08 % janë femra. Ndërkohë rezultojnë dhe 3 të pandehur shtetas të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 36,57 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 51,43 % me arsim të mesëm dhe 12 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë 3,17% e të pandehurve, në sektorin privat janë punësuar 39,68 % e të pandehurve, dhe të papunë janë 57,15 %.
Rezulton se 87,43 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 12,57 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 89,08 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 10,92 % janë përsëritës për vepra të tjera penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 42 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Elbasan regjistruar 11 %, Fier regjistruar 8 %, Durrës regjistruar 7 %, Korçë regjistruar 6 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Gjirokastër,Vlorë, Sarandë regjistruar përkatësisht rreth 2 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për grupvepra kundër lirisë së personit, ndërkohë që në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është regjistruar rreth 1 % e totalit të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupveprash.

**VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

## Shfrytëzimi i prostitucionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit" është 9,51 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 10,07 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re në vitin 2023 tendenca në ulje 6,90 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal "Shfrytëzimi i prostitucionit", në krahasim me vitin 2022.

## Pornografia

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit" është 17,96 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 11,81 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal "Pornografia", është rritur me 50 % krahasuar me vitin 2022.

## Përndjekja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit" është 56,34 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 56,94 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal "Përndjekja", është ulur me 2,44 % krahasuar me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




**VLERËSIME**

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** meshkuj janë 80,92 % dhe femra janë 19,08 %. 51,43 % janë me arsim të mesëm, 57,15 % janë të papunë, 10,92 % e tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 89,08 % janë të padënuar.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 42 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Berat, Elbasan dhe Durrës e Tiranë me nga 12 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 83,90 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest, ndërkohë që nga gjykata në 68,60 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 95,45 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 4,55 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 23,81 % të të pandehurve, 23,81 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 50 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe në 2,38% të rasteve është kërkuar maksimumi i dënimit me burgim. Gjykata ka vendosur në 95,92 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 4,08 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur në 1 rast pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 29,79 % të të pandehurve, 14,89 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 53,19 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 2,13 % rezulton dënim në maksimun të dispozitës.
**Siguria publike:** pezullimi i procedimit për këto grupvepra përbën 27,11 % të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 dhe 21,2 % në vitin 2022, përkatësisht 77 të pezulluara në vitin 2023 dhe 61 procedime të pezulluara në vitin 2022.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë, 71,43 % viktima të rritur dhe 28,57 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 80 % janë meshkuj dhe 20 % janë femra.

## VEPRA PENALE KUNDËR FËMIJËVE, MARTESËS DHE FAMILJES

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 6,17 % ndërsa për vitin 2022 ka qenë 6,06 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 53,81 ndërsa në vitin 2022 ka qenë 55,81.

### TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore në vitin 2023 për “Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes”, rezulton ulje prej 4,68 % e numrit të procedimeve të regjistruara në krahasim me vitin 2022 e ndërkaq kemi ulje prej 8,33 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 11,39 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 10,52 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 34,21 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
94,07 % e të pandehurve janë meshkuj ku 0,44 % e përbëjnë të miturit dhe 5,93 % janë të pandehura femra.
Për këto vepra, rezultojnë edhe 6 të pandehur me shtetësi të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 55,20 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 39,89 % me arsim të mesëm dhe 4,91 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 0,35 % e të pandehurve, në sektorin privat 32,33 % e të pandehurve dhe të papunë 67,32 %.
Rezulton se 61,11 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 38,89 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 82,20 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 2,07 % janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 15,73 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 35 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Durrës regjistruar 12 %, Fier regjistruar 10 %, Elbasan regjistruar 9 %, e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër, Gjirokastër, Sarandë, regjistruar rreth 2 % dhe Kukës ku janë regjistruar 1 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruar për këtë grup veprash.

**VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

## Braktisja e fëmijëve të mitur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin "Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes" për vitin 2023 është 1,14 % ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 1,86 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i Kodit Penal "Braktisja e fëmijëve të mitur", në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, nga 29 në 17 procedime të regjistruara ose 41,38 %.

## Keqtrajtimi i të miturit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin "Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes" për vitin 2023 është 2,76 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 2,89 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në ulje për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal "Keqtrajtimi i të miturit", në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, nga 45 në 41 procedime të regjistruara, ose 8,89 %.

## Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin "Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes" për vitin 2023 është 0,94 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 0,77 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje për veprën penale të parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal "Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë", në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, nga 12 në 14 procedime të regjistruara.

## Dhuna në familje

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin "Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes" për vitin 2023 është 93,94 %, ndërsa në vitin 2022 pesha e kësaj vepre rezulton në masën 93,20 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vihet re ulje prej 3,92 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal "Dhuna në familje", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 94,07 % janë meshkuj, 55,20 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 67,32 %, janë të papunë, 2,07 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 15,73 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 35 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Lezhë me 69 procedime dhe qarku Korçë me 63 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 86,92 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 79,76 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që janë vendosur edhe 19 masa ndaluese.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burg, ndërkohë që është kërkuar pushimi për 7 çështje. Sa i përket masës së

dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 38,07 % të të pandehurve, 16,52 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 45,26 % në marzhin mesatar dhe 0,15 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjitha rastet dënim me burg, ndërkohë që ka vendosur në 6 raste pushim çështje dhe ka dhënë 14 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 40,48 % të të pandehurve, për 0,14 % është kërkuar dënim me kohën e paraburgimit, 15,63 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 43,75 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023, nga numri total i viktimave rezultojnë, 92,86 % viktima të rritur dhe 7,14 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 73,85 % janë femra dhe 26,15 % janë meshkuj.

## VEPRAT PENALE KUNDËR LIRISË SË BESIMIT

Në lidhje me veprat penale kundër lirisë së besimit, gjatë vitit 2023 është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale "Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit" parashikuar nga neni 132 i Kodit Penal.

## VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE NË SFERËN EKONOMIKE
## VJEDHJA E PASURISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 22,98 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 25,77 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 200,52, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 237,11.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 11) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 16,39 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vjedhjen e pasurisë dhe një ulje prej 18,55 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 18,05 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 15,48 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 39,33 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të vjedhjes së pasurisë për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




**TË PANDEHURIT**

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
94,34 % e të pandehurve janë meshkuj, ku 12,17 % e përbëjnë të miturit, dhe 5,66 % janë të pandehura femra.
Në këtë grup veprash janë marrë të pandehur 14 shtetas të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 62,20 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 33,89 % me arsim të mesëm, 3,91 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 1,12 % e të pandehurve, në sektorin privat 10,27 % e të pandehurve dhe të papunë 88,61 %.
Rezulton se 69,68 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 30,32 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 73,35 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, 6,14 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 20,51 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

**SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE**

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e vjedhjes së pasurisë është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 44 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Durrës regjistruar 18 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier regjistruar 7 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, siç janë: Dibër, Gjirokastër, Kukës regjistruar përkatësisht nga 1 % e numrit total të procedimeve në shkallë vendi për veprat penale të vjedhjes së pasurisë.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Vjedhja

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin "Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike" është 93,73 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 91,98 %.
Nga të dhënat rezulton se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal "Vjedhja", në vitin 2023 janë ulur me 14,80 % në krahasim me vitin 2022.

### Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2023 është 1,48 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 1,19 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 3,80 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal "Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën", në krahasim me vitin 2022.

### Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër vjedhjes së pasurisë në vitin 2023 është 0,07 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 0,08 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet ulje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal "Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit" në krahasim me vitin 2022, nga 5 në 4 procedime të regjistruara.

## Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vjedhja e pasurisë" për vitin 2023 është 2,76 %, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 5,13 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 137 "Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike" i Kodit Penal, ka një ulje prej 55 % në krahasim me vitin 2022.

## Vjedhja me dhunë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vjedhja e pasurisë" për vitin 2023 është 1,52 % ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 1,27 %.
Nga të dhënat statistikore rezulton se në të dy vitet e fundit është regjistruar numër i njëjtë procedimesh, (84 procedime) për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal "Vjedhja me dhunë".

## Vjedhja me armë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vjedhja e pasurisë" për vitin 2023 është 0,18 % ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 0,24 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet një ulje e numrit të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal "Vjedhja me armë" nga 16 në 10 procedime ose 37,50 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 94,34 % janë meshkuj nga të cilët të mitur 12,17 %, 62,20 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 88,61 % janë të papunë, 6,14 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër penale, ndërsa 20,51 % e të pandehurve janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vjedhjen e pasurisë, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 44% e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Tiranë e Durrës me 281 procedime, qarkun Vlorë me 249 procedime dhe qarkun Korçë me 153 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 82,35 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 75,14 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest, ndërkohë që janë vendosur edhe 6 masa ndaluese.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 98,78 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 1,2 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi i 10 çështjeve. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 39,23 % të të pandehurve, për 0,15 % është kërkuar dënim me kohën e paraburgimit, 13,54 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 46,77 % në marzhin mesatar, 0,31 % në marzhin maksimal të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98% të dënimeve, dënim me burg dhe në 2 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur kthim aktesh në 2 çështje,13 pushim çështje dhe 11 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 42,21 % të të pandehurve, për 0,58 % është vendosur dënim me kohën e paraburgimit, për 9,89 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 47,03 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,29 % në marzhin maksimal të dënimit.
**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 4538 procedime që përbëjnë 81,94 % të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2022 ku janë pezulluar 5189 procedime që përbëjnë 78,3 % të procedimeve të regjistruara.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë, 96,87 % viktima të rritur dhe 3,13 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 75,81 % janë meshkuj dhe 24,19 % janë femra.

## MASHTRIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,39 %, ndërsa në vitin 2022 është 2,37 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 20,89, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 21,76.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 12) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 5,10 % të numrit të procedimeve regjistruar krahasuar me vitin 2022 dhe rritje prej 13,59 % e procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 10,40 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 32,43 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 72,78 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të mashtrimeve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




**TË PANDEHURIT**

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Rezulton se 87,94 % e të pandehurve janë meshkuj dhe 12,06 % e të pandehurve janë femra.
Në këtë grup veprash rezultojnë të pandehur edhe 10 shtetas të huaj.
Për sa i përket arsimit të të pandehurve rezulton se 18,44 % e të pandehurve janë me arsim deri 9 vjeçar, 58,16 % me arsim të mesëm dhe 23,40 % me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se në sektorin privat rezultojnë 69,33 % e të pandehurve dhe 30,67 % janë të papunë.
Rezulton se 86,52 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 13,48 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 0,35 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 14,18 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme, ndërsa 85,46 % janë të padënuar më parë.

**SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE**

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e mashtrimit është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë, siç janë: Tiranë, 54 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës 11 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 6 % dhe Shkodër 5 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Sarandë, Kukës, Berat, ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupveprash.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Mashtrimi
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Mashtrimet" është 90,99 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 86,35 %.
Në vitin 2023, në këtë grup veprash penale vihet re e njëjta tendencë për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal "Mashtrimi" si në vitin 2022, 525 procedime penale të regjistruara.

### Mashtrimi në sigurime
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Mashtrimet" është 2,25 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 3,13 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re ulje nga 19 procedime në 13 ose 31,58 % e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal "Mashtrimi në sigurime", krahasuar me vitin 2022.

### Mashtrimi në kredi
Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale kundër mashtrimit për vitin 2023 është 2,25 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 5,43 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje nga 33 procedime në 13 ose 60,61 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal "Mashtrimi në kredi", krahasuar me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




**VLERËSIME**

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 87,94 % janë meshkuj, 58,16 % janë me arsim të mesëm, 30,67 % janë të papunë, 0,35 % e tyre rezultojnë përsëritës për të njëjtën vepër, 14,18 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për veprat penale të mashtrimit, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 54 % e tyre, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Tiranë e Durrës me 31 procedime, Lezhë me 20 procedime dhe Gjirokastër me 19 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 80,85 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 72,53 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se për 95,56 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe për 4,44 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar 1 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 39,53 % të të pandehurve, për 9,31 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 51,16 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 97,67 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 2,33 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 4 pushim çështje, dhe 4 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 42,86 % të të pandehurve, 9,52 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 47,62 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 185 procedime që përbëjnë 32,06 % të procedimeve të regjistruara, kurse në vitin 2022 janë pezulluar 95 procedime që përbëjnë 15,6% të procedimeve të regjistruara për atë vit.

**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë, 91,67 % viktima të rritur meshkuj dhe 8,33% viktima të rritura femra.

## SHKATËRRIMI I PRONËS

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 3,94 % ndërsa në vitin 2022 ky tregues ka qenë 4,38 %. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 34,40, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 40,31.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 13) rezulton se në vitin 2023 ka trend në ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të shkatërrimit të pronës në krahasim me vitin 2022, e konkretisht 15,63 %. Ndërkohë vërehet ulje prej 0,82 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022, rritje 0,66 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 4,29 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 12,22 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të shkatërrimit të pronës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga të pandehurit 9,04 % janë femra dhe 90,96 % meshkuj (nga këta 2,54 % meshkuj të mitur).
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 62,36 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 30,34 % me arsim të mesëm dhe 7,30 % e të pandehurve me arsim të lartë.

Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektor shtetëror janë regjistruar 1,18 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë 25,88 % e të pandehurve dhe 72,94 % janë të papunë.
Rezulton se 67,98 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,02 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre janë të padënuar më parë, 92,44 % e të pandehurve, ndërsa 7,56 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për grupveprat e shkatërrimit të pronës është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë 24 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier 15 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës 11 % dhe Korçë 9 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Gjirokastër dhe Dibër ku janë regjistruar rreth 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Shkatërrimi i pronës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” për vitin 2023 është 41,26 %, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 34,99 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vihet re se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës" është në ulje me 0,51 % në krahasim me vitin 2022.

## Shkatërrimi i pronës me zjarr

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Shkatërrimi i pronës" është 42,32 % për vitin 2023, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 37,74 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023, vihet re tendenca në ulje me 5,41 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës me zjarr", në krahasim me vitin 2022.

## Shkatërrimi i pronës me eksploziv

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Shkatërrimi i pronës" për vitin 2023 është 3,37 %, ndërsa në vitin 2022 ky tregues ka qenë 3,46 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re ulje prej 17,9 % e numrit të procedimeve të regjistruara në vitin 2023, për veprën penale të parashikuar nga neni 152 i Kodit Penal "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", konkretisht nga 39 procedime penale të regjistruara në vitin 2022 në 32 procedime penale.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 90,96 % janë meshkuj, 62,36 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 72,94 %, janë të papunë dhe 7,56 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për shkatërrimin e pronës, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 24 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Vlorë me 58 procedime dhe qarku Kukës me 56 procedime.

**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 57,32 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 48,78 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 79,01 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 20,99 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar në 3 raste pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 62,50 % të të pandehurve, për 17,19 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 20,31 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 79,75 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 20,25 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 4 pushim çështje, dhe 1 vendim pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 66,67 % të të pandehurve, 12,69 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 20,64 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 582 procedime që përbëjnë 62,32 % të procedimeve të regjistruara, një rritje krahasuar me vitin 2022 ku procedimet e pezulluara përbënin 49,70 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 rezultojnë 87,50% viktima meshkuj në moshë madhore dhe 12,50 % viktima femra në moshë madhore.

## VEPRA PENALE TË KRYERA NË SHOQËRITË TREGTARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,13 %, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 0,19 %. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 1,12, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1,72.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 14) rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve penale të regjistruara është ulur nga 48 në 31 ose 35,42 %, numri i procedimeve të dërguar në gjykatë është rritur nga 6 në 14, numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 10 në 6, numri i të pandehurve të dërguar gjykatë është rritur nga 7 në 16 dhe numri i të pandehurve të dënuar është rritur 4 në 7 përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të kryera në shoqëritë tregtare për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, tregojnë se, 93,75 % e të pandehurve janë meshkuj të moshës madhore.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se rreth 62,50 % e të pandehurve janë me arsim të mesëm dhe 31,50 % janë me arsim të lartë.
Lidhur me vendbanimin rezulton se 93,75 % e të pandehurve e kanë vendbanimin në qytet dhe 6,25 % në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se të gjithë të pandehurit janë të padënuar.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat sipas prokurorive, ku vërehet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar numrin më të lartë të procedimeve penale për këtë grupvepash me 39 % e ndjekur nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Durrës me 19 % dhe Korçë me 10 %. Ndërkohë prokuroritë e shkallës së parë Fier, Kukës dhe Shkodër nuk kanë regjistruar asnjë procedim penal për vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare.




## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Punësimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare" në vitin 2023 është 64,52 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 56,25 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal "Punësimi i paligjshëm". Kështu në vitin 2023 janë regjistruar 20 procedime penale kundrejt 27 procedimeve penale të regjistruara në vitin 2022 ose me ulje prej 25,93 %.

Grafikisht, ecuria 5-vjeçare e kësaj vepre paraqitet si vijon:



## VEPRA PENALE NË LIDHJE ME USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE BANKARE DHE FINANCIARE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,05, ndërsa në vitin 2022, ka qenë 0,09 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 0,43, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 0,86.

### TENDENCA

Në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare (tabela 15), në krahasim me vitin 2022 ka pësuar ulje nga 24 në 12 procedime, ndërkohë që numri i të pandehurve të regjistruar është ulur nga 13 në 8. Numri i procedimeve të dërguara gjyqit është ulur nga 16 procedime në vitin 2022 në 12 procedime në vitin 2023, numri i të pandehurve dërguar gjyqit është rritur nga 16 në 26 të pandehur, ndërkohë që të pandehurit e dënuar nga gjykata rezultojnë në të njëjtën shifër.

Grafikisht tendenca e veprave penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## KRIME NË FUSHËN E DOGANAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,00 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1,01 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 8,76, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 9,27.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 16) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 6,56 % të numrit të procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave dhe rritje prej 22,39 % të procedimeve

të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 9,05 %, numri i të pandehurve të dërguar në gjykatë është rritur me 14,21 %, ndërsa numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur me 36,76 % krahasuar me vitin 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e doganave për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Rezulton se 92,86 % e të pandehurve të rritur janë meshkuj dhe 7,14 % janë femra.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 19,48 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61,42 % me arsim të mesëm dhe 19,10 % të pandehurve janë me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjatë vitit 2023 gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror zënë 7,84 % të numrit të të pandehurve, në sektorin privat zënë 61,44 % të numrit të të pandehurve dhe 30,72 % rezultojnë të papunë.
Rezultojnë edhe 13 shtetas të huaj të pandehur për këtë grup veprash penale në vitin 2023.
Sa i përket vendbanimit, 88,39 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 11,61 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 93,08 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, dhe 5,38 % përsëritës për vepra të tjera të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krime në fushën e doganave është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë, 33% e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës 14 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Korçë 13 % dhe Gjirokastër 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër dhe Elbasan,ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe Berat, ku nuk ka asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2023 në grupin e krimeve në fushën e doganave është 11,98 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 16,22 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, në shifra nga 42 në 29 procedime ose 30,95 % në krahasim me vitin 2022.

## Kontrabanda me mallra të tjera

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Krime në fushën e doganave” është 16,12 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 30,50 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re se procedimet penale të regjistruara për këtë vepër janë ulur 50,63 %, konkretisht në vitin 2023 janë regjistruar 39 procedime penale kundrejt 79 procedimeve të regjistruara në vitin 2022 për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.

## Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2023 vihet re tendenca në ulje me 6,56 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë", ku kjo vepër ka një peshë prej 23,55 % të procedimeve të regjistruara gjatë të dy viteve të fundit.

## Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë

Në grupin e krimeve në fushën e doganave në vitin 2023 vihet re tendencë në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179/a i Kodit Penal "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", ku kjo vepër ka një peshë prej 37,19 % të procedimeve të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vërehet se për vitin 2023 janë regjistruar 90 procedime penale ndaj 48 procedimeve të regjistruara në vitin 2022, ose rritje prej 87,50 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 92,86 % janë meshkuj madhorë, 61,42 % janë me arsim të mesëm, 61,44 %, janë të punësuar në sektorin privat, dhe 5,38 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për krime në fushën e doganave, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Gjirokastër me 43 procedime dhe qarku Kukës me 25 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 73,11 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 26,89 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 89,76 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur po në 73,11 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 26,89 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 3 pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 88,24 % të të pandehurve.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 13 procedime që përbëjnë 5,37 % të procedimeve të regjistruara, tregues në ulje krahasuar me vitin 2022 ku procedimet e pezulluara përbënin 6,95 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

## VEPRAT PENALE NË LIDHJE ME TAKSAT DHE TATIMET

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,78 %, ndërsa për vitin 2022 është 1,22 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 6,77 ndërsa në vitin 2022 ka qenë 11,20.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 17) rezulton se për "Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet", në vitin 2023 ka një ulje prej 40,26 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 25,88 % të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 14,58 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 33,33 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 37,84 %.

Grafikisht tendenca e veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të pandehurit janë të gjithë të rritur ku 12,31 % femra dhe 87,69 % meshkuj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 21,54 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 60 % me arsim të mesëm dhe 28,46 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për këto vepra rezultojnë të marrë si të pandehur edhe 17 shtetas të huaj.

Sa i përket gjendjes shoqërore, 97,73 % e të pandehurve rezultojnë të punësuar në sektorin privat, 2,27 % janë të papunë.
Lidhur me vendbanimin, rezulton se 75,19 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 24,81 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 96,15 % janë të padënuar më parë, 3,85 % e tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë 29 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Vlorë 14 %, Fier 10 %, Durrës me 9 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër dhe Kukës ku janë regjistruar përkatësisht, 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokurorinë Berat ku nuk kanë asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Fshehja e të ardhurave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet” është 65,24 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 71,57 %.

Nga të dhënat statistikore të vitit 2023 vërehet tendenca në ulje prej 45,54 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal "Fshehja e të ardhurave" në krahasim me vitin 2022.

## Mospagimi i taksave dhe i tatimeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet" është 18,18 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 9,90 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal "Mospagimi i taksave dhe i tatimeve", prej 9,68 % krahasuar me procedimet e regjistruara në vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 87,69 % janë meshkuj madhorë, 60 % janë me arsim të mesëm, 97,73 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 3,85 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale në lidhje me taksat dhe tatimet, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 29 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Vlorë me 21 procedime dhe qarku Shkodër dhe Gjirokastër përkatësisht me nga 11 procedime.
**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 77,19 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 22,81 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar 5 pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 52,28 % të të pandehurve, 11,36 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 36,36 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 76,09 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 23,91 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur 6 pushim çështje dhe 13 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për

62,86 % të të pandehurve, minimumi i dënimit për 5,71 % të të pandehurve 31,43 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 9 procedime që përbëjnë 4,81 % të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër.

## FALSIFIKIMI I MONEDHAVE DHE LETRAVE ME VLERË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,10 %, ndërsa në vitin 2022 ishte 0,17.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 0,91, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1,58.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 18) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë” në krahasim me vitin 2022 nga 44 në 25 dhe ulje nga 17 në 9, të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 nga 22 në 9, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 30 në 10, dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me nga 18 në 9 përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga të pandehurit 92,86% janë meshkuj madhorë dhe 7,14 % janë femra.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 42,86 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 50 % me arsim të mesëm dhe 7,14 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Në lidhje me gjendjen shoqërore rezulton se 50 % e të pandehurve kanë qenë të papunë, 50 % të punësuar në sektorin privat.
Rezulton se 71,43 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 28,57 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, të gjithë të pandehurit rezultojnë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë 52 % e numrit total të procedimeve, Durrës 12 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier dhe Durrës me 12 % dhe Vlorë me 8 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Gjirokastër, Berat, Elbasan, Dibër, Shkodër, ku nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Falsifikimi i monedhave

Për vitin 2023 pesha specifike e kësaj vepre përbën 92 % të procedimeve të regjistruara për grupin e veprave penale “Falsifikimi i monedhave dhe letrave me vlerë”, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 95,45 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal "Falsifikimi i monedhave", nga 42 procedime në 23 procedime ose 45,24 % në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




**VLERËSIME**

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 92,86 % janë meshkuj madhorë, 508 % janë me arsim të mesëm, 50 %, janë të papunë dhe të gjithë të pandehurit janë të padënuar më parë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e monedhave, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 52 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Vlorë me 2 procedime.
**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 72,73 % të të pandehurve, 27,27 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjitha dënimet, aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë.
**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 15procedime që përbëjnë 60 % të procedimeve të regjistruara,

## FALSIFIKIMI I DOKUMENTEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,45 %, ndërkohë që në vitin 2022 pesha specifike e këtij grupi ka qenë 2,71 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 21,36, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 24,91.

**TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 19) rezulton se në vitin 2023 ka ulje prej 15,23 % të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat e falsifikimit të dokumenteve në krahasim me vitin 2022, ulje të numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë me 24,81 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 42,08 %, ulje të numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë prej 21,07 % dhe ulje të numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 50,46 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të dhënat lidhur me gjininë e të pandehurve tregojnë se nga të pandehurit madhorë 84,79 % e tyre janë meshkuj dhe 15,21 % janë femra.
Në vitin 2022 rezultojnë të pandehur 30 shtetas të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 24,12 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 48,23 % me arsim të mesëm dhe 27,65 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se gjithsej të punësuar në sektorin shtetëror janë 9,02 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin privat janë 40,60 % e të pandehurve dhe pjesa tjetër prej 50,38 % e të pandehurve, rezultojnë të papunë.
Rezulton se 73 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 27 % e të pandehurve në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 93,89 % e tyre janë të padënuar më parë dhe 6,11 % e tyre rezultojnë të dënuar për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për falsifikimin e dokumenteve është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë, 44 % e numrit total të procedimeve, Vlorë 10 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Durrës dhe Fier përkatëisht me nga 8%, etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë: Dibër, regjistruar rreth 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Falsifikimi i dokumenteve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve" është 64,92 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 66,52 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet ulje prej 17,28 % e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, "Falsifikimi i dokumenteve".

### Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Falsifikimi i Dokumenteve" për vitin 2023 është 17,80 %, ndërkohë që vitin 2022 është 18,39 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave", kanë pësuar një ulje prej 17,97 % krahasuar me një vit më parë.

### Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve" është 12,03 % për vitin 2023, ndërkohë që për vitin 2022 rezulton 8,33 %.

Nga të dhënat statistikore, në vitin 2023 vërehet rritje prej 22,41 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal "Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 84,79 % janë meshkuj madhorë, 48,23 % janë me arsim të mesëm, 50,38 %, janë të papunë dhe 6,11 % janë të dënuar për vepra të tjera.

**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për falsifikimin e dokumenteve, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 44 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 44 procedime.

**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 94,5 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 5,5 % dënim me gjobë, ndërkohë që është kërkuar pushimi i çështjes në 2 raste. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 64,10 % të të pandehurve, 13,46 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 22,44 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 98,14 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,86 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur 5 pushim çështje dhe 13 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 71,52 % të të pandehurve, 13,29 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 15,19 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.

**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 99 procedime që përbëjnë 16,78 % të procedimeve të regjistruara, tregues në rritje krahasuar me vitin 2022 ku procedimet e pezulluara përbënin 14,08 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

## VEPRAT PENALE NË FUSHËN E FALIMENTIMIT

Në lidhje me veprat penale të parashikuara në seksionin e IX-të të Kreut të tretë të Kodit Penal, veprat penale në fushën e falimentimit (tabela 20), vërehet se gjatë vitit 2023, janë regjistruar 2 procedime penale, konkretisht 1 procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 193 i Kodit Penal, "Falimentimi i provokuar", dhe 1 procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 196 i Kodit Penal, "Shkelja e detyrimeve", për të cilën janë regjistruar edhe 2 të pandehur.

## ZHVILLIMI I PALEJUAR I LOJËRAVE TË FATIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,05 %, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 1,01 %.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 9,12, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 9,31.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 21) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje të numrit të procedimeve të regjistruara për grupveprat penale "Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit", në krahasim me vitin 2022 me 3,08 %, numri i procedimeve të dërguara në gjykatë ka pësuar rritje me 4,52 %, numri i të pandehurve të regjistruar për këtë grup veprash penale është ulur me 4,91 % përkundrejt këtij totali në vitin 2022, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur me 5,15 % dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është rritur 0,65 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të zhvillimit të palejuar të lojërave të fatit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




### TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të pandehurit rezultojnë 99,20 % meshkuj të rritur dhe 0,80 % femra të rritura.

Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 25,46 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 61,55 % me arsim të mesëm dhe 12,99 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Sa i përket gjendjes shoqërore, të punësuar në sektorin privat rezultojnë 73,56 % e të pandehurve, 26,44 % rezultojnë të papunë.
Nga treguesit vërehet se 77,45 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 22,55 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 91,73 % janë të padënuar më parë, 7,73 % rezultojnë të dënuar për vepra të tjera dhe 0,54 % janë të dënuar për të njëjtën vepër penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë 32 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Korçë 12 %, Fier 11 %, Lezhë 10 %, Elbasan 10% të numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë: Vlorë, ku janë regjistruar 2 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi dhe prokuroritë Gjirokastër dhe Kukës ku nuk kanë asnjë procedim të regjistruar për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit" është 94,44 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 97,31 %.

Nga të dhënat statistikore të vitit 2023, vihet re tendencë në ulje prej 5,93 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal "Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 99,20 % janë meshkuj madhorë, 61,55 % janë me arsim të mesëm, 73,56 %, janë të punësuar në sektorin privat dhe 7,73 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për zhvillimin e palejuar të lojrave të fatit është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 32 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 23 procedime dhe në qarkun Korçë me 16 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 9,13 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 5,56 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 99,31 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 0,69 % dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 82,52 % të të pandehurve. Gjykata ka vendosur në 98,08 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 1,92 % dënim me gjobë, ndërkohë ka vendosur pushimin e çështjes për 1 rast dhe për 2 raste ka vendosur pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 91,50 % të të pandehurve.

## VEPRA PENALE QË CENOJNË REGJIMIN JURIDIK TË TOKËS DHE TË NDËRTIMEVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 6,08 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 5,05 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 53,08, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 46,50.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 22) rezulton se në vitin 2023 ka një rritje prej 12,86 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve në krahasim me vitin 2022, dhe ulje prej 24,97 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje prej 8,57 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 24,04 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 36,01 % krahasuar me vitin 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër regjimit juridik të tokës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga numri i të pandehurve të rritur, rezultojnë se 8,88 % e përbëjnë femrat dhe 91,12 % meshkujt.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 39,02 % janë me arsim të mesëm, 6,59 % të pandehur me arsim të lartë dhe pjesa tjetër prej 54,39 % me arsim 9 vjeçar.
Në sektorin privat rezultojnë të punësuar 39,95 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,25 % dhe pjesa tjetër e të pandehurve prej 59,79 % janë të papunë.
Nga treguesit vërehet se 43,19 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 56,81 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 96,45 % janë të padënuar më parë, 3,55 % e të pandehurve përsëritës për vepra të ndryshme penale.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale që cënojnë regjimin juridik të tokës është në prokuroritë pranë gjykatave së shkallës së parë: Tiranë 20 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Shkodër 14 %, Vlorë 12 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, Sarandë 10 % etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këto grupvepra penale është në prokurorinë pranë gjykatës të shkallës së parë: Gjirokastër, ku janë regjistruar 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Ndërtimi i paligjshëm

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve është 78,65 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 86,61 %.
Vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal "Ndërtimi i paligjshëm" në vitin 2023 prej 2,49 % në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 91,12 % janë meshkuj madhorë, 54,39 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 59,79 % janë të papunë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër regjimit juridik të tokës, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, 20 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun VLorë me 192 procedime dhe qarkun Kukës me 138 procedime.
**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se 3,65 % e kërkesave kanë qenë për dënimin me gjobë dhe 96,35 % për dënimin me burg, ku është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 93,09 % të rasteve. Gjykata ka vendosur në 3,61 % të dënimeve dënimin me gjobë dhe në 96,39 % dënimin me burg, ku në 94,93 % të rasteve është pezulluar vendimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri është vendosur në provë. Në 8 raste është vendosur pushim çështje dhe 7 raste pafajësi.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 të gjitha viktimat janë në moshë madhore, nga ku 87,10 % janë meshkuj dhe 12,90 % janë femra.

## VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,42 %, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 1,45 %. Pra vihet re ulje e peshës specifike të këtij grupi veprash penale për vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 12,42, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 13,32.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 23) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 7,80 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 20 % të procedimeve të dërguara në gjykatë për vepra penale kundër mjedisit, në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej

29,13 %, ulje e numrit të të pandehurve të dërguar në gjykatë prej 33,01 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 36,99 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër mjedisit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të pandehurit rezultojnë 95,74 % meshkuj të rritur dhe 4,26 % femra të rritura.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 49,47 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar dhe 47,37 % me arsim të mesëm dhe 3,16 % me arsim të lartë.
Të punësuar në sektorin privat rezultojnë 50 % e të pandehurve dhe të papunë rezultojnë të jenë 50 %.
Ndërsa lidhur me vendbanimin rezulton se 36,56 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 63,44 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e tyre, 82,79 % janë të padënuar më parë, 11,83 % prej tyre janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 11,83 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër mjedisit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 20 % e numrit total të procedimeve për këto vepra në shkallë vendi, Korçë regjistruar 13 %, Elbasan regjistruar 13 %, Dibër me 9 % të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë: Vlorë ku është regjistruar 1 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër mjedisit" është 8,45 % për vitin 2023, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 5,38 %.

Nga të dhënat statistikore, vërehet tendenca në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal "Ndotja e ajrit, e ujrave dhe e tokës" në vitin 2023, gjatë të cilit janë regjistruar 29 procedime penale ndaj 20 procedimeve të regjistruara në vitin 2022, ose 45 %.

### Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër mjedisit" është 4,96 % për vitin 2023, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 4,03 %.

Nga të dhënat statistikore, vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 202/b i Kodit Penal "Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore" në krahasim me vitin 2022, nga 15 në 17 procedime ose 13,33 %.

### Prerja e paligjshme e pyjeve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër mjedisit" për vitin 2023 është 52,19 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 52,69 %.

Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal "Prerja e paligjshme e pyjeve", në vitin 2023 prej 8,67 % në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** Meshkuj madhorë janë, 95,74 % e të pandehurve; me arsim deri 9-vjeçar janë 49,47 %; të papunë janë 50 %; përsëritës për të njëjtën vepër janë 5,38 % dhe 11,83 % janë përsëritës për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër mjedisit, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 20 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqun Gjirokastër dhe Dibër, përkatësisht me 28 procedime dhe qarkun Kukës me 25 procedime.
**Politika Penale:** Për këtë grup veprash, në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit, të kërkuar nga prokurori, rezulton se 28,57 % e kërkesa kanë qenë për dënimin me gjobë dhe 71,43 % për dënimin me burg, ku është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 60 % të rasteve. Gjykata ka vendosur në 43,48 % të dënimeve dënimin me gjobë dhe në 56,52 % dënimin me burg, ku në 69,23 % të rasteve është pezulluar vendimi i dënimit me burgim dhe i pandehuri është vendosur në provë. Në 3 raste është vendosur pafajësi.
**Siguria publike:** Për këtë grup veprash, në vitin 2023 janë pezulluar 79procedime që përbëjnë 23,03 % të procedimeve të regjistruara, tregues në ulje krahasuar me vitin 2022 ku procedimet e pezulluara përbënin 26,60 % të numrit të procedimeve të regjistruara.

## KRIME KUNDËR PAVARËSISË E RENDIT KUSHTETUES
## dhe
## KRIME QË CENOJNË MARRËDHËNIET ME SHTETET E TJERA

Gjatë vitit 2023, nuk rezulton asnjë procedim penal i regjistruar për krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera.

## VEPRA ME QËLLIME TERRORISTE

Nga të dhënat statistikore (tabela 25) rezulton se numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale me qëllime terroriste në vitin 2023 është 4, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1.
Këto procedime penale janë regjistruar përkatësisht, 1 procedim për nenin 232 të Kodit Penal "Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste" dhe 3 procedime për nenin 232/b të Kodit Penal "Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste".

## VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 1,87 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 1,94 %. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është16,33, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 17,86.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 27) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 9,62 % të numrit të procedimeve të regjistruara për "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit" dhe ka një ulje prej 17,46 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje 19,13 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 17,44 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 35,53 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga të pandehurit, rreth 0,72 % kanë qenë të pandehur të mitur. Të pandehur të rritur (mbi 18 vjeç) rezultojnë 97,22 % meshkuj dhe 2,78 % femra.
Në këtë grup veprash rezulton edhe 1 i pandehur i huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 40,18 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 48,73 % me arsim të mesëm dhe 11,09 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror rezultojë 1,02 % e të pandehurve, nga sektori privat janë regjistruar 39,69 % e të pandehurve dhe të papunë 62,29 %.
Rezulton se 68,82 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 31,18 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve rreth 85,88 % janë të padënuar më parë ndërsa 14,12 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 34 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Vlorë dhe Elbasan përkatësisht me nga 9 %, Korçë me 8% të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Berat dhe Kukës, ku janë regjistruar 3 % e numrit total të procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër, si dhe në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë Dibër ku janë regjistruar 2 % e procedimeve në shkallë vendi për këtë grupvepër.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit" është 27,94 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 23,25 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re tendenca në rritje prej 8,62 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik" në krahasim me vitin 2022.

## Goditjet për shkak të detyrës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit" në vitin 2023 është 15,52 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 13,43 %.
Për këtë vepër penale rezulton tendenca në rritje prej 4,48 % e procedimeve të regjistruara në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

## Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale "Kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit" është 40,80 % në vitin 2023, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 50,70 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendencë në ulje prej 27,27 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 97,22 % janë meshkuj madhorë, 48,73 % janë me arsim të mesëm, 62,29 %, janë të papunë dhe 14,12 % janë përsëritës për vepra të ndryshme penale.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 34 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastër me 36 procedime dhe qarkun Vlorë me 32 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 79,58 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 66,90 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 73,36 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 26,64 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar edhe 3 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 73,36 % të të pandehurve, për 14,89 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 31,55 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 68,57 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 31,43 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 1 pushim çështjeje dhe 11 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 57,14 % të të pandehurve, 16,07 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 26,79 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 të gjitha viktimat rezultojnë të rritur, nga këta 95,65 % janë meshkuj dhe 4,35% janë femra.

## VEPRA PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA PUNONJËSIT SHTETËRORË OSE NË SHËRBIM PUBLIK

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 2,11 %, ndërsa në vitin 2022 pesha e këtyre veprave ka qenë 2,36 %. Pra, vihet re ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 18,43, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 21,69.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 28) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 16,01 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, në krahasim me vitin 2022 dhe rritje prej 10,14 % të procedimeve të dërguara në gjykatë. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 67,51 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë me 3,14 %, dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 11,69 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit, për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të pandehurit rezultojnë 84,40 % femra dhe 15,60 % meshkuj.
Lidhur me arsimin rezulton se 74,80 % e tyre janë me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se 94,17 % e të pandehurve janë nëpunës të thjeshtë.

Rezulton se 88,80 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 99,59 % e të pandehurve janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Vlorë 15 %, Durrës 11 %, Korçë 7 % të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër dhe Berat ku janë regjistruar përkatësisht nga 2 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Shpërdorim detyre

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2023 në grupin e veprave penale "Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik" është 91,16 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 92,57 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal "Shpërdorim detyre", në vitin 2023, prej 17,29 % në krahasim me vitin 2022.

## Kryerja e veprimeve arbitrare

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik” në vitin 2023 është 5,50 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 5,45 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal “Kryerja e veprimeve arbitrare” në vitin 2023 është ulur me 15,15 %, krahasuar me vitin 2022.

### Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë në vitin 2023 është 1,38 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 1,16 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” është regjistruar i njëjti numër procedimesh në të dy vitet e fundit, 7 procedime penale.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




### VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 84,40 % janë meshkuj madhorë dhe 74,80 % janë me arsim të lartë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë me 58 procedime dhe qarkun Gjirokastër me 39 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 63, 49 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 65,15 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 99 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 1 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar në 5 raste pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 65,66 % të të pandehurve, për 18,18 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum dhe 16,16 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në të gjitha rastet, dënim me burg, ndërkohë që ka vendosur 8 pushim çështje dhe 33 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 85,29 % të të pandehurve, 7,35 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 4,42 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 4,42 % nën minimumin e parashikuar nga ligji dhe 2,94 % të rasteve është vendosur dënim me kohën e paraburgimit.

## VEPRA PENALE KUNDËR RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 23,10 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 21,99 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 201,57, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 202,39.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore për "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike" (tabela 29) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 1,54 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 7,94 % të numrit të të pandehurve të regjistruar në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me numrin e procedimeve të dërguara në gjykatë për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 13,04 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 12,89 % si dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 31,82 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:



## TË PANDEHURIT

Nga të pandehurit, 4,57 % kanë qenë të pandehur të mitur dhe 95,43 % të rritur (mbi 18 vjeç). Të pandehurit meshkuj përbëjnë edhe për këtë grup veprash pjesën më të madhe e konkretisht 97,31 % dhe 2,79 % femra të rritura.
Rezultojnë 27 të pandehur me shtetësi të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve, rezulton se 38,06 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 51,79 % me arsim të mesëm dhe 10.15 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore, nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë rreth 0,9 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 43,37 % e të pandehurve dhe të papunë 55,73 %.
Rezulton se 65,85 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 34,15 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se 93,44 % e tyre janë të padënuar më parë, 6,27 % prej tyre janë përsëritës në vepra penale të ndryshme dhe 0,29 % përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 33 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Durrës 11 %, Fier 10 %, Shkodër 8 % e procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Gjirokastër ku janë regjistruar 2 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

### VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

## Vetëgjyqësia

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2023 është 4,06 %, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 3,15 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 26,97 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal “Vetëgjyqësia”, në krahasim me vitin 2022.

## Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2023 është 6,05 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 5,80 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 2,74 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” në krahasim me vitin 2022.

## Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2023 është 4,06 %, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 4,07 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje prej 1,74 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i Kodit Penal “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2023 është 17,35 %, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 16,11 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 6,04 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, në krahasim me vitin 2022.

## Largimi nga vendi i aksidentit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” është 5,46 % për vitin 2023, ndërsa në vitin 2022 pesha specifike e kësaj vepre ka qenë 5,54 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet se procedimet e regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal “Largimi nga vendi i aksidentit”, janë ulur 2,88 % krahasuar me vitin 2022.

## Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” për vitin 2023 është 53,28 %, që përbën edhe peshën më të lartë, ndërsa në vitin 2022 ky tregues ka qenë 55,91 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” në vitin 2023, prej 6,17 % në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 97,21 % janë meshkuj të rritur, 38,06 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 55,73 % janë të papunë, 0,29 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 6,27 % janë të dënuar për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër rendit dhe sigurisë, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 33 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 304 procedime dhe qarkun Vlorë me 250 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 30,31 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 25,21 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.

Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 94,89 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 5,11 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë kërkuar tërheqja e akteve në 1 rast, 3 pushim akuze dhe 13 pushim çështjeje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 80,17 % të të pandehurve, për 0,04 % të tyre është kërkuar ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, për 7,77 % të kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 11,72 % në marzhin mesatar dhe në 0,30 % të rasteve është dënimi me kohën e paraburgimit. Gjykata ka vendosur 93,39 % të dënimeve, dënim me burg dhe në 6,61 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka vendosur 4 kthim aktesh, 15 pushim çështjeje dhe 14 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 82,81 % të të pandehurve, për 0,04 % të tyre është vendosur ulja e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji, 7,67 % rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 9,23 % në marzhin mesatar dhe 0,25 % të liruar me kohën e paraburgimit.

**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 400 ose 7,19 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 7,2 % të procedimeve të regjistruara.

**Viktimat:** Për këtë grup veprash në vitin 2023 nga numri total i viktimave rezultojnë, 87,28 % viktima të rritur dhe 12,72 % (të mitur-nën 18 vjeç). Nga viktimat në moshë madhore, 70,85 % janë meshkuj dhe 29,15 % janë femra.

## VEPRA PENALE QË LIDHEN ME PASTRIMIN E PARAVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 0,66 %, ndërsa në vitin 2022 ky tregues ka qenë 0,95 %. Pra vihet re një ulje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 5,72, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 8,73.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 30) rezulton se në vitin 2023 ka një ulje prej 35,25 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, në krahasim me vitin 2022 (nga 244 në 158). Ndërkaq në krahasim me vitin 2022 kemi ulje nga 27 procedime në 14 procedime të dërguara në gjykatë në vitin 2023. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar nga 40 në 15, numri i të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë është ulur nga 43 në 27 dhe numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është ulur nga 31 në 22 përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër pastrimit të parave për vitet 2022-2023 paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga numri i të pandehurve të rritur (mbi 18 vjeç), rezultojnë të pandehur meshkuj 90,91 % dhe femra 9,09 %.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 27,27 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 65,15 % me arsim të mesëm dhe 7,58 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore rezulton se 18,18 % e të pandehurve janë nga sektori privat dhe 81,82 % janë të papunë.
Rezulton se 71,21 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 28,79 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, rezulton se 56,06 % e të pandehurve janë të padënuar më parë, ndërsa 43,94 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër pastrimit të parave është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë vepër, Vlorë, 20 %, Lezhë 11 %, Fier 10 %, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë vepër është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë: Kukës, ku janë regjistruar 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Dibër dhe Sarandë ku nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë vepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale

Pesha specifike që zë kjo vepër në grupin e veprave penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale për vitin 2023 është 98,73 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 91,39 %.
Gjatë vitit 2023 vërehet tendenca në ulje prej 30,04 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e kësaj veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 90,91 % janë meshkuj, 65,15 % janë me arsim të mesëm, 81,82 % janë të papunë dhe 56,06 % janë të padënuar më parë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër pastrimit të parave, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Vlorë dhe Gjirokastër përkatësisht me nga 17 procedime dhe qarkun Lezhë me 16 procedime.
**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjitha rastet është kërkuar dënim me burgim. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 43,31 % të të pandehurve, 57,69 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në marzhin mesatar të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në gjitha rastet dënim me burg, ndërkohë që në 5 vendime ka vendosur pafajësi. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 59,09 % të të pandehurve, për 40,91 % të të pandehurve është vendosur dënimi në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 38 ose 24 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 12,30 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRA PENALE KUNDËR SEKRETIT DHE KUFIJVE SHTETËRORË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2023 është 3,35 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 2,87 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 29,22 ndërsa, në vitin 2022 ka qenë 26,45.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 31) rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është rritur 9,20 % në krahasim me vitin 2022 dhe numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është ulur 1,35 % në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022 prej 4,28 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 16,35 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 20,59 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 97,49 % meshkuj dhe 2,51 % femra.
Të pandehur të huaj rezultojnë 76.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 54,18 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 43,53 % me arsim të mesëm dhe 2,29 % me arsim të lartë.
Të punësuar në sektorin privat janë regjistruar 9,49 % e të pandehurve, në sektorin shtetëror 0,14 % dhe pjesa tjetër prej 90,37 % rezulton e papunë.
Rezulton se 61,29 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 38,71 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 92,51 % e tyre janë të padënuar më parë, 6,73 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të tjera dhe 0,76 % përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 39 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Gjirokastër me 13 %, Sarandë 12 % etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepra është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë: Lezhë, ku janë regjistruar 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

**VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

## Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë" në vitin 2023 është 78,19 %, ndërsa në vitin 2022 ky tregues ka qenë 57,37 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 48,82 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal "Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror", në krahasim me vitin 2022.

## Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë" për vitin 2023 është 21,19 %, ndërsa për vitin 2022 ky tregues ka qenë 41,48 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje prej 44,48 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 97,49 % janë meshkuj, 54,18 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 90,37 % janë të papunë dhe 6,73 % janë përsëritës, për vepra të ndryshme penale.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 39 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastër me 199 procedime, dhe qarkun Vlorë me 62 procedime.
**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 41,69 % të të pandehurve është kërkuar dënim me gjobë dhe në 58,31 % dënim me burg, ndërkohë që ka patur 5 kërkesa për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 48,68 % të të pandehurve, 9,65 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 40,35 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita dhe 1,32 % në maksimum të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur në 37,17 % të dënimeve dënim me gjobë dhe në 62,83 % dënim me burg, ndërkohë që janë vendosur 4 pushim akuze, 3 pushim çështjeje dhe 10 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 51,91 % të të pandehurve, në 10,21 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 37,45 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita, në 0,43 % të rasteve është vendosur caktimi i dënimit me kohën e paraburgimit.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 49 ose 6,07 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 5,54 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRA PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023, përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 2,54 % ndërsa për vitin 2022 ka qenë 2,26 %. Pra vihet re rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 22,16, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 20,83.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 32) rezulton se në vitin 2023 ka një rritje prej 5,15 % të numrit të procedimeve të regjistruara për vepra penale kundër drejtësisë në krahasim me vitin 2022 e ndërkaq numri i procedimeve të dërguara në gjykatë është rritur me 22,38 %. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 6,38 %, rritje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 6,38 % përkundrejt këtij totali në vitin 2022 dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 27,30 % krahasuar me një vit më parë.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër drejtësisë për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Sa i përket gjinisë së të pandehurve nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezulton 12,32 % janë femra dhe 87,68 % meshkuj.
Ndër të pandehurit rezultojnë edhe 3 shtetas të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 43,55 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 48,57 % me arsim të mesëm dhe 7,88 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin privat rezultojnë 26,56 % e të pandehurve dhe të papunë 72,61 %, ndërkohë që 0,83 % rezultojnë të punësuar në sektorin shtetëror.
Sa i përket vendbanimit, vërehet se 69,17 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 30,83 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, 68,07 % janë të padënuar më parë, 31,75 % prej tyre janë përsëritës për vepra penale të ndryshme dhe 0,18 % janë përsëritës për të njëjtën vepër.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 31 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra, Durrës 10 %, Shkodër 9 % e numrit të procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër ku janë regjistruar 2 % e numrit të procedimeve penale dhe Kukës 1 % e procedimeve të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër drejtësisë" për vitin 2023 është 8,66 %, tregues në ulje krahasuar me vitin 2022 gjatë të cilit pesha specifike e kësaj vepre ishte 10,48 %.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje prej 13,11 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal "Pengime për ekzekutimin e vendimit të gjykatës", në krahasim me vitin 2022.

### Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër drejtësisë" për vitin 2023 është 19,28 %, ndërsa në vitin 2022 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 19,93 % të totalit të grupit.

Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 1,72 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i Kodit Penal "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", në krahasim me vitin 2022.

## Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër drejtësisë" për vitin 2023 është 36,11 %, ndërsa në vitin 2022 pesha që zinin procedimet e regjistruara për këtë vepër përbënte 24,57 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", në vitin 2023, prej 54,55 % në krahasim me vitin 2022.

## Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim

Pesha specifike e kësaj vepre në grupin e veprave penale "Kundër drejtësisë" për vitin 2023 është 15,20 %, ndërkohë që në vitin 2022 ky tregues ishte 20,79 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në ulje prej 23,14 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 87,68 % janë meshkuj, 43,55 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 72,61 % janë të papunë dhe 31,75 % janë të dënuar më parë për vepra penale të ndryshme.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale kundër drejtësisë, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 31 %, ndërkohë që koeficienti

më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Gjirokastër me 36 procedime dhe qarkun Vlorë me 35 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 84,02 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 79,79 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në 88,43 % të të pandehurve është kërkuar dënim me burg dhe në 11,57 % dënim me gjobë, ndërkohë që ka patur 6 kërkesa për pushim çështje. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 31,31 % të të pandehurve, 20,09 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 47,67 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,93 % është kërkuar masa e dënimit me kohën e paraburgimit. Gjykata ka vendosur në 89,79 % të dënimeve dënim me burg dhe në 10,21 % dënim me gjobë, ndërkohë që janë vendosur 7 pushim çështjeje dhe 10 vendime pafajësie. Sa i përket masës së dënimit, është vendosur aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për 36,82 % të të pandehurve, në 18,64 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum, në 43,64 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita dhe në 0,9 % të të pandehurve është vendosur dënimi me kohën e paraburgimit.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 35 ose 5,71 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 4,60 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRA PENALE QË PREKIN ZGJEDHJET E LIRA DHE SISTEMIN DEMOKRATIK TË ZGJEDHJEVE

Të dhënat në lidhje me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve (tabela 33) tregojnë se gjatë vitit 2023 janë regjistruar 25 procedime penale dhe 19 të pandehur, ndërsa në vitin 2022 janë regjistruar 26 procedime penale dhe 16 të pandehur. Janë dëguar për gjykim 2 procedime penale me 14 të pandehur dhe janë dënuar 2 të pandehur, ndërkohë që në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 3 procedime penale me 16 të pandehur dhe janë dënuar 14 të pandehur.

Sipas veprave penale rezulton se peshën më të madhe të procedimeve të regjistruara e përbën vepra penale e parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", për të cilën janë regjistruar 8 procedime penale dhe 6 të pandehur; për veprën penale të parashikuar nga neni 327/a i Kodit Penal "Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar" janë regjistruar 5 procedime penale dhe 10 të pandehur, ndërkohë është dërguar për gjykim 1 procedim me 10 të pandehur dhe është dënuar 1 i pandehur; për veprën penale parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje" janë regjistruar 4 procedime penale dhe është dënuar 1 i pandehur; për veprën penale parashikuar nga neni 330 i Kodit Penal "Pengimi i zgjedhësit" janë regjistruar 3 procedime penale; për veprën penale të parashikuar nga neni 327 i Kodit Penal "Shkelje të fshehtësisë së votimit" janë regjistruar 2 procedime penale dhe 2 të pandehur; dhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 326, 326/a dhe 331 të Kodit Penal janë regjistruar respektivisht nga 1 procedim penal, për vitin 2023.

## VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 0,71 % ndërsa për vitin 2022 ka qenë 1,02 %. Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 6,16, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 9,38.

## TENDENCA

Sikurse vihet re edhe nga tabela, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2023 ka një ulje 35,11 % të numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit dhe ulje 17,16 % të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re ulje 38,81 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2022, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë 19,25 % dhe rritje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata 30,77 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale kundër korrupsionit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat sociodemografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezulton se të gjithë të pandehurit janë të rritur (mbi 18 vjeç) ku, 6,52 % janë femra dhe 93,48 % meshkuj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 22,28 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 50 % janë me arsim të mesëm dhe 27,72 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se të punësuar në sektorin shtetëror janë regjistruar 56,67 % e të pandehurve, në sektorin privat rezultojnë të punësuar 35 % e të pandehurve, dhe 8,33 % prej tyre rezultojnë të papunë.
Rezulton se 75,54 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 24,46 % prej tyre në fshat.

Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, theksojmë se pjesa më e madhe e të pandehurve, 95,63 %, janë të padënuar më parë.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të veprave penale të korrupsionit në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për vepra penale në fushën e korrupsionit është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Tiranë regjistruar 61 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër në shkallë vendi; Durrës 8 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, Fier 6 % e numrit total të procedimeve të regjistruara, etj sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve të regjistruara për këtë grupvepër penale është në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë, Berat ku janë regjistruar 1 % e numrit total të procedimeve të regjistruar, si dhe në Kukës ku nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në vitin 2023 në grupin e veprave penale të korrupsionit është 67,06 %, ndërsa në vitin 2022 pesha që zinte kjo vepër ka qenë 81,30 %. Pra vërehet ulje e peshës specifike të kësaj vepre në totalin e veprave penale të grupit.
Për vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike", janë regjistruar 114 procedime penale, që përbën ulje 46,48 % në krahasim me vitin 2022.

### Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale të korrupsionit për vitin 2023 është 23,53 %, që përbën rritje krahasuar me peshën specifike që kjo vepër kishte në vitin 2022, 15,27 %. Nga të dhënat statistikore, në vitin 2023 vërehet tendencë e njëjtë me vitin 2022 e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", 40 procedime.

Ecuria e këtyre veprave penale në dy vitet e fundit 2021-2023[26] paraqitet në grafikun e mëposhtëm:




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 93,48 % janë meshkuj, 50 % janë me arsim të mesëm, 35 % janë të punësuar në sektorin privat dhe 95,63 % janë të padënuar më parë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale të korrupsionit, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 61 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarqet Tiranë e Durrës me 10 procedime dhe Gjirokastër me 9 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grup veprash, 58,06 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 53,57 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 91,84 % të të pandehurve, 3,06 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 5,10 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Sa i përket masës së dënimit,gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 91,59 % të të pandehurve, në 2,53 % është vendosur caktimi i dënimit në minimum dhe në 5,88 % të dënimeve me burg, është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita.

[26] Ndryshuar kompetenca për këto vepra me ligjin nr. 41/2021 që ka ndryshuar nenin 75/a të K.Pr.Penale, hyrë në fuqi me datë 1 qershor 2021.

## KRIMI KIBERNETIK

Pesha specifike që zë ky grup veprash penale në numrin total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për vitin 2023, është 1,29 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 0,99.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 11,30, ndërsa në vitin 2022 ka qenë më i ulët ose 9,13 %.

**TENDENCA**

Nga të dhënat statistikore (tabela 35) rezulton se në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara, është rritur me 22,35 % krahasuar me një vit më parë, ka një ulje të numrit të procedimeve dërguar në gjykatë, nga 13 procedime në vitin 2022 në 10 procedime dërguar në gjykatë në vitin 2023, ose 23,08 %, ulje të numrit të të pandehurve të regjistruar në vitin 2023 përkundrejt këtij totali në vitin 2022 nga 30 në 20, ose 33,33 %, ulje të numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë nga 17 në 16, ose 5,88 % dhe rritje të numrit të të pandehurve të dënuar për vepra penale kundër krimit kompjuterik nga 8 në vitin 2022, në 9 në vitin 2023, ose 12,50 %.

Grafikisht tendenca e krimit kibernetik për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Të pandehurit, 89,47 % meshkuj dhe 10,53 % janë femra.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 36,84 % e tyre janë me arsim të mesëm, 42,11 % me arsim të lartë, 21,05 % me arsim deri 9-vjeçar.
Rezulton se 89,47 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet dhe 10,53 % në fshat.
Ndërsa lidhur me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se te 94,44 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 5,56 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për krimin kibernetik është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 68 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra,Durrës dhe Elbasan përkatësisht 7 % e procedimeve të regjistruara, etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Dibër, Lezhë, Berat, ku janë regjistruar përkatësisht 1 % e numrit të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër, si dhe në Kukës ku nuk është regjistruar asnjë procedim për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Mashtrimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” për vitin 2023 është 32,26 %, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 30,45 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 25 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 143/b i Kodit Penal “Mashtrimi kompjuterik”, në krahasim me vitin 2022.

### Falsifikimi kompjuterik

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 30,45 % për vitin 2023, ndërsa në vitin 2022, ky tregues ka qenë 28,03 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal, “Falsifikimi kompjuterik”, është rritur 17,28 %.

### Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale “Kundër krimit kompjuterik” është 26,28 % për vitin 2023, ndërsa në vitin 2022, ky tregues ka qenë 21,80 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal “Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike”, është rritur me 30,16 %.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




**VLERËSIME**
Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 89,47 % janë meshkuj, 42,11 % janë me arsim të lartë, 94,44 % janë të padënuar më parë.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për krimin kibernetik, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 68 % dhe koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton po në qarqet Tiranë e Durrës me 19 procedime dhe në Gjirokastër me 13 procedime.
**Politika Penale:** Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se në të gjithë rastet është kërkuar dënim me burg dhe është vendosur nga gjykata dënim me burg. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 36,36 % të të pandehurve dhe në 45,45 % të rasteve është kërkuar caktimi i dënimit në minimum të dënimit dhe 18,19 % në marzhin mesatar të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 45,45 % të të pandehurve, është vendosur caktimi i dënimit në minimum për 45,45 % të të pandehurve dhe për 1 të pandehur është vendosur marzhi mesatar i dënimit i parashikuar nga dispozita.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 198 ose 63,46 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 55,70 % të procedimeve të regjistruara.

## TRAFIQET E PALIGJSHME

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi është 1,02 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 0,65 %.

Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 8,87, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 5,94.

## TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 36) rezulton se në vitin 2023 ka një rritje të gjithë treguesve për veprat penale të trafiqeve të paligjshme, ku vërehet rritje prej 47,59 % e numrit të procedimeve të regjistruara dhe rritje prej 34,38 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë, në krahasim me vitin 2022. Në lidhje me të pandehurit për këtë grup veprash penale vërehet rritje prej 65,52 % e numrit të të pandehurve të regjistruar, rritje prej 23,08 % e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë dhe rritje prej 68,18 % e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata, përkundrejt të njëjtëve tregues të vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale të trafiqeve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Sipas gjinisë, rezultojnë se 7,06 % janë femra dhe 92,94 % janë meshkuj.
Në vitin 2023 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 3 shtetas të huaj.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 35 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar , 60 % me arsim të mesëm dhe 5 % me arsim të lartë.
Në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve rezulton se 36,67 % janë të punësuar në sektorin privat, 63,33 % janë të papunë.
Rezulton se 74,12 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet, ndërsa 25,88 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet 89,29 % e të pandehurve janë të padënuar më parë dhe 10,71 % prej tyre rezultojnë përsëritës në vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për trafiqet e paligjshme është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistuar 25 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto grupvepra në shkallë vendi, Durrës 20 %,  Korçë dhe Shkodër, përkatësisht nga 10 %, Kukës 9 % e procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Berat, Sarandë ku janë regjistruar rreth 1 % e numrit të procedimeve  të regjistruara në shkallë vendi për këtë grupvepër.

**VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT**

## Trafikimi i personave të rritur

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" në vitin 2023 është 2,45 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet një tendencë në ulje e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal "Trafikimi i personave të rritur" në krahasim me vitin 2022, nga 7 procedime në 6 procedime të regjistruara në vitin 2023 ose 14,29 %.

## Trafikimi i të miturve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" në vitin 2023 është 3,27 % ndërsa në vitin 2022 ka qenë 2,41 %.
Në vitin 2023 numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal "Trafikimi i të miturve" është rritur krahasuar me vitin 2022, nga 4 në 8 procedime penale.

## Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" është 0,41 %, dhe rezulton ulje e numrit të procedimeve të regjistruara në dy vitet e fundit, nga 3 procedime penale në vitin 2022, në 1 procedim të regjistruar në vitin 2023.

## Trafikimi i mjeteve motorike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" është 63,67 % për vitin 2023, ndërkohë që për vitin 2022 ka qenë 58,43 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendencë në rritje prej 60,82 % e numrit të procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal "Trafikimi i mjeteve motorike", në krahasim me vitin 2022.

## Trafikimi i armëve dhe i municionit

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" është 8,57 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal "Trafikimi i armëve dhe i municionit", është rritur nga 10 procedime penale të regjistruara në vitin 2022, në 21 procedime penale në vitin 2023.

## Trafikimi i narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në grupin e veprave penale "Kundër trafiqeve të paligjshme" në vitin 2023 është 21,22 %, ndërkohë që në vitin 2022 ky tregues ka qenë 25,90 %.
Nga të dhënat statistikore në vitin 2023 vërehet tendenca në rritje prej 20,93 % e procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal "Trafikimi i narkotikëve", në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:

**Profili i të pandehurve:** 92,94 % janë meshkuj, 35 % janë me arsim deri 9-vjeçar, 63,33 % janë të papunë dhe 10,71 % janë të dënuar më parë për vepra të ndryshme.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për trafiqet e paligjshme, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë 25 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun me Kukës me 29 procedime dhe qarkun Gjirokastër me 19 procedime.
**Politika Penale:** për këtë grupveprash, 85,51 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 76,81 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 23,08 % të të pandehurve, po për 76,92 % të kërkesave rezulton caktimi i dënimit rezulton në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 24,32 % të të pandehurve, janë dënuar me marzhin minimal të dënimit 5,41 % të të pandehurve, 70,27 % e të pandehurve rezulton për caktimin e dënimit mesatar, ndërkohë që rezultojnë edhe 2 vendime pafajësie.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 78 ose 31,83 % e procedimeve të regjistruara, tregues në ulje pasi në vitin 2022, ky tregues përbënte 63,85 % të procedimeve të regjistruara.

## VEPRAT PENALE QË LIDHEN ME PRODHIMIN DHE KULTIVIMIN E NARKOTIKËVE

Pesha specifike që ky grup veprash penale zë për vitin 2023 përkundrejt numrit total të procedimeve penale të regjistruara në shkallë vendi, është 7,28 %, ndërsa për vitin 2022 ka qenë 6 %. Pra vihet re një rritje e këtij treguesi për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022.
Koeficienti i kriminalitetit për 100,000 banorë për këtë grup veprash në vitin 2023 është 63,55, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 55,20.

### TENDENCA

Nga të dhënat statistikore (tabela 37) rezulton se në vitin 2023 ka një rritje prej 13,81 % të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë grup veprash penale në krahasim me vitin 2022 e ndërkaq rezulton ulje prej 21,84 % e numrit të procedimeve të dërguara në gjykatë në krahasim me një vit më parë. Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale vihet re një ulje e numrit të të pandehurve të regjistruar prej 15,95 %, ulje e numrit të të pandehurve të cilët janë dërguar në gjykatë prej 23,59 % dhe ulje e numrit të të pandehurve të dënuar nga gjykata me 18,46 % përkundrejt vitit 2022.

Grafikisht tendenca e veprave penale për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, paraqitet si vijon:




## TË PANDEHURIT

Të dhënat socio-demografike të të pandehurve për këtë grup veprash penale, si gjinia, mosha, arsimi, gjendja shoqërore, vendbanimi e gjendja gjyqësore, paraqiten në mënyrë të detajuar në vijim:
Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 96,68 % të pandehur meshkuj, nga totali i meshkujve, 2,49 % janë meshkuj të mitur (14 deri 18 vjeç). Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve, rezultojnë 3,32 % femra.
Në lidhje me arsimin e të pandehurve rezulton se 48,13 % e të pandehurve janë me arsim deri 9-vjeçar, 45,14 % me arsim të mesëm dhe 6,73 % e të pandehurve me arsim të lartë.
Në vitin 2023 rezultojnë si të pandehur për këto grup vepra 8 shtetas të huaj.
Për sa i përket gjendjes shoqërore nga të dhënat statistikore vihet re se nga sektori privat janë regjistruar 18,73 % e të pandehurve, të punësuar në sektorin shtetëror 1,19 % dhe të papunë 80,08 %.
Rezulton se 67,69 % e të pandehurve kanë vendbanimin në qytet ndërsa 32,31 % prej tyre në fshat.
Në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve, vërehet se 86,81 % e tyre janë të padënuar më parë, 0,92 % janë përsëritës për të njëjtën vepër, ndërsa 12,27 % janë përsëritës për vepra penale të ndryshme.

## SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE

Lidhur me shpërndarjen gjeografike të këtyre grupveprave në vitin 2023, grafiku në vijim paraqet të dhënat statistikore në shifra dhe përqindje sipas secilës prokurori:




Paraqitja grafike evidenton se numri më i lartë i procedimeve të regjistruara për veprat penale të prodhimit dhe kultivimit të narkotikëve është në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë: Tiranë regjistruar 27 % të numrit total të procedimeve të regjistruara, Lezhë regjistuar 15 % e numrit total të procedimeve të regjistruara për këto vepra në shkallë vendi, Shkodër 14 %, Fier 10 %, e procedimeve të regjistruara etj, sipas paraqitjes grafike, ndërsa vërehet se numri më i vogël i procedimeve penale të regjistruara për këtë grupvepër është në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë: Sarandë, Gjirokastër, ku janë regjistruar 2 % e numrit të procedimeve penale në shkallë vendi për këtë grupvepër.

## VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË GRUPIT

### Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

Pesha specifike që zë kjo vepër penale në këtë grup për vitin 2023 është 58,46 %, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 68,94 %.
Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2023 për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, numri i procedimeve të regjistruara ka pësuar një ulje prej 3,48 % në krahasim me vitin 2022.

### Kultivimi i bimëve narkotike

Pesha specifike që zë kjo vepër penale këtë grup është 41,37 % për vitin 2023, ndërkohë që në vitin 2022 ka qenë 31,06 %.
Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023, numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal “Kultivimi i bimëve narkotike”, ka një tendencë në rritje prej 51,57 % në krahasim me vitin 2022.

Ecuria e këtyre veprave penale në pesë vite, 2019-2023 paraqitet në grafikun e mëposhtëm (procedimet penale të regjistruara në prokurori):




## VLERËSIME

Në analizë të të dhënave, rezulton se:
**Profili i të pandehurve:** 96,68 % janë meshkuj, 45,14 % janë me arsim të mesëm, 80,07 % janë të papunë dhe 0,92 % janë përsëritës për të njëjtën vepër dhe 12,27 % janë përsëritës për vepra të tjera.
**Gjeografia sociale**: numri më i lartë i procedimeve për vepra penale të kultivimit të narkotikëve, është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me 27 %, ndërkohë që koeficienti më i lartë për 100,000 mijë banorë rezulton në qarkun Lezhë me 228 procedime dhe qarkun Shkodër me 134 procedime.
**Politika Penale**: për këtë grup veprash, 77,59 % e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi lidhen me caktimin e masave të sigurimit me arrest dhe nga gjykata në 70,37 % të kërkesave është vendosur masë sigurimi me arrest.
Në kërkesat lidhur me llojin e masën e dënimit të kërkuar nga prokurori, rezulton se është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë në 32,12 % të të pandehurve, 11,81 % e kërkesave rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 54,68 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,52 % në marzhin maksimal dhe 0,87 % është kërkuar caktimi i dënimit me kohën e paraburgimit. Ndërkohë që prokuroria ka kërkuar pushimin e çështjes në 8 raste. Gjykata ka vendosur aplikimin e pezullimit të dënimit dhe vendosjen në provë për 45,11 % të të pandehurve, 7,87 % e dënimeve rezulton për caktimin e dënimit në minimum, 45,26 % në marzhin mesatar të dënimit të parashikuar nga dispozita, 0,32 % në marzhin maksimal dhe 1,44 % është vendosur caktimi i dënimit me kohën e paraburgimit. Në 19 raste ka vendosur pafajësinë e të pandehurit, në 1 rast ka vendosur pushim akuze dhe në 8 raste pushimin e çështjeve.
**Siguria publike:** Numri i procedimeve të pezulluara për vitin 2023 është 546 ose 31,11 % e procedimeve të regjistruara, ndërsa në vitin 2022, ky tregues përbënte 36,70 % të procedimeve të regjistruara.

## 2.10 TREGUESI I EFEKTIVITETIT TË ORGANIT TË PROKURORISË NË VITE, NË NGRITJEN E AKUZËS NË FAZËN E HETIMIT PARAPRAK

Nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi i efektivitetit të ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak ka qenë si më poshtë:
Në vitin 2023 janë përfunduar hetimet për 13234 të pandehur nga të cilët 11401 janë dërguar në gjykatë ose 86 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 1833 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 14 % të të pandehurve. Në vitin 2022 janë përfunduar hetimet për 15254 të pandehur nga të cilët 12936 janë dërguar në gjykatë ose 85 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2318 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 15 % të të pandehurve. Në vitin 2021 janë përfunduar hetimet për 14979 të pandehur nga të cilët 12343 janë dërguar në gjykatë ose 82 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2636 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 18 % të të pandehurve. Në vitin 2020 janë përfunduar hetimet për 13805 të pandehur nga të cilët 11503 janë dërguar në gjykatë ose 83 % e personave për të cilët është ngritur akuzë dhe për 2298 të pandehur janë pushuar hetimet ose për 17 % të të pandehurve.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet efektiviteti i ngritjes së akuzës në fazën e hetimit paraprak për vitin 2023:




**Treguesi i efektivitetit të organit të prokurorisë në pesë vite, në dënimin e të pandehurve**
Grafiku i mëposhtëm përmban të dhëna të detajuara lidhur me numrin e të pandehurve të deklaruar fajtor e dënuar dhe ata që kanë marrë pafajësi në pesë vitet e fundit:



## Të dhëna mbi kërkesën e prokurorit dhe vendimet e gjykatës

Më poshtë paraqiten në përqindje të dhënat lidhur me kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës gjatë vitit 2023, lidhur me dënimin me burgim, dënimin me gjobë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë:







Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me **dënimin "Burgim i përjetshëm"** për periudhën 2018-2022:




Në lidhje me burgimin e përjetshëm, nga të dhënat statistikore sipas paraqitjes grafike pese vjecare rezulton se, në vitin 2023 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë janë të njëjta me vitin 2022, në vitin 2022 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur me 66,6 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur me 50 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 kërkesat e prokurorit për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur 20 % krahasuar me vitin 2019.

Ndërkohë nga të dhënat statistikore sipas paraqitjes grafike mesipër rezulton se, në vitin 2023 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2022 në

masën 20 %, në vitin 2022 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2021 në masën 66,6 %, në vitin 2021 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë ulur në krahasim me vitin 2020 në masën 50 %, ndërsa në vitin 2020 vendimet e gjykatës për dënim me burgim të përjetshëm janë rritur në krahasim me vitin 2019 në masën 50 %.

Paraqitja grafike më poshtë evidenton të dhëna në lidhje me **dënimin e të pandehurve me burgim sa maksimumi i** parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete për vitet 2019-2023:




Nga të dhënat statistikore vihet re se në vitin 2023 ka një ulje prej 77,32 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 ka një rritje prej 42,6 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 ka një rritje prej 65,85 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 36,92 % të kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurve me maksimumin e dënimit me burgim të parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete krahasuar me vitin 2019.

Lidhur me vendimet e dënimit në maksimumin e masës së dënimit të parashikuar për veprën penale konkrete, gjatë vitit 2023 vërehet ulje prej 82,14 % krahasuar me vitin 2022, gjatë vitit 2022 vërehet rritje prej 47,4 % krahasuar me vitin 2021, gjatë vitit 2021 vërehet rritje prej 83,87 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa gjatë vitit 2020 vërehet ulje prej 32,61 % krahasuar me vitin 2019.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për vitet 2019-2023 në lidhje me masën e **dënimit me burgim në minimumin** e parashikuar nga ligji:




Në lidhje me masën e dënimit me burgim në minimum, vihet re se, në vitin 2023 kërkesat e prokurorit janë ulur me50 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 kërkesat e prokurorit janë rritur me 4 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 kërkesat e prokurorit janë rritur me 17,43 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 kërkesat e prokurorit janë ulur me 12,60 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2023 vihet re se vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 54,03 % krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 janë ulur me 9,5 % krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 janë rritur me 15,57 % krahasuar me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 vendimet e gjykatës për dënimin në minimumin e parashikuar nga ligji për veprën penale konkrete janë ulur me 1,44 % krahasuar me vitin 2019.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me zbatimin e nenin 59 të Kodit Penal ku është parashikuar **"Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë"** si kërkime të prokurorit ashtu edhe vendime të gjykatës, në pesë vitet e fundit:



Nga të dhënat statistikore, vihet re se në vitin 2023 ka një ulje prej 34,29 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2022 ka një rritje prej 13,6 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, në vitin 2021 ka një rritje prej 17,19 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë”, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 3,07 % të numrit të kërkesave të prokurorit për aplikimin e alternativës së dënimit me burg të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

Ndërkohë vendimet e gjykatës në vitin 2023 kanë pësuar ulje prej 31,60 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 kanë pësuar rritje prej 19,2 % në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 kanë pësuar rritje prej 16,05 % në krahasim me vitin 2020.

**Në lidhje me dënimin me gjobë**, grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për pesë vitet 2019-2023:




Të dhënat statistikore në vitin 2023 tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 40,04 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 tregojnë rritje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 18,1 % në krahasim me vitin 2021, të dhënat statistikore në vitin 2021 tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 16,96 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa dhe në vitin 2020 tregojnë ulje të kërkesave të prokurorit për dënimin me gjobë prej 27,20 % në krahasim me vitin 2019.

Sa i përket të dhënave lidhur me vendimet e dënimit me gjobë, vihet re se në vitin 2023 ka një ulje prej 35,89 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 ka një rritje prej 9,6 % në krahasim me vitin 2021, vitin 2021 ka një ulje prej 14,52 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 ka një ulje prej 28,42 % në krahasim me vitin 2019.

## 2.11 TË DHËNA PËR TË PANDEHURIT PËR VITIN 2023

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në hetim[27] në pesë vitet e fundit (2019–2023):




Në lidhje me të pandehurit e regjistruar në vitin 2023, nga të dhënat statistikore rezulton se dinamika e këtij treguesi në tre vite është si më poshtë:
Në vitin 2023 janë regjistruar 11005 të pandehur që do të thotë ulje prej 12,02 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 janë regjistruar 12508 të pandehur që do të thotë ulje prej 13 % në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 janë regjistruar 14374 të pandehur që do të thotë rritje prej 1,58 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar 14151 të pandehur që do të thotë ulje prej 9,06 % në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me të pandehurit mbartur në hetim, duke marrë në referencë vitet 2019-2023 rezulton se; në vitin 2023 janë mbartur hetimet për 7963 të pandehur që do të thotë ulje prej 20,92 % në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 janë mbartur hetimet për 10069 të pandehur që do të thotë rritje prej 7,6 % në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 janë mbartur hetimet për 9359 të pandehur që do të thotë rritje prej 16,43 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa në vitin 2020 janë mbartur hetimet për 8038 të pandehur që do të thotë rritje prej 15,70 % në krahasim me vitin 2019.

Në lidhje me të pandehurit, për të cilët është vendosur rifillimi hetimeve rezulton se, në vitin 2023 janë rifilluar hetimet për 34 të pandehur që do të thotë ulje prej 22,73% në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 janë rifilluar hetimet për 44 të pandehur që do të thotë ulje prej 60 % në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 janë rifilluar hetimet për 111 të pandehur që do të thotë rritje prej 141 % në krahasim me vitin 2020, ndërsa vitin 2020 janë rifilluar hetimet për 46 të pandehur që do të thotë ulje prej 62,60 % në krahasim me vitin 2019.

### Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjininë e të pandehurve në vitet 2021-2023:

[27] Në të dhënat e një viti përfshihen të pandehur çështjet e të cilëve janë mbartur nga viti i kaluar, të pandehur për të cilët është rifilluar hetimi nga organi i prokurorisë, të pandehur të regjistruar nga organi i prokurorisë.




Nga të dhënat statistikore rezulton se raporti i të pandehurve meshkuj-femra në vitin 2023 është 94,72 % meshkuj dhe 5,28 % femra, në vitin 2022 është 94,75 % meshkuj dhe 5,25 % femra, në vitin 2021 është 94,89 % meshkuj dhe 5,11 % femra.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me arsimin e të pandehurve në vitet 2021-2023:




Nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 rezultojnë 43,47 % e të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar që përbën ulje në krahasim me vitin 2022, në vitin 2022 rezultojnë 44,2 % e të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar që përbën ulje në krahasim me vitin 2021, në vitin 2021 rezultojnë 46,77 % e të pandehurve me arsim deri 9-vjeçar që përbën ulje në krahasim me vitin 2020.

Me arsim të mesëm në vitin 2023 rezultojnë 46,37 % e të pandehurve, që përbën rritje krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezultojnë 44,24 % e të pandehurve, që përbën rritje krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 rezultojnë 42,73 % e të pandehurve, që përbën ulje krahasuar me vitin 2020.

Me arsim të lartë, në vitin 2023 rezultojnë 10,16 % e të pandehurve që përbën ulje krahasuar me vitin 2022, në vitin 2022 rezultojnë 11,51 % e të pandehurve që përbën rritje krahasuar me vitin 2021, në vitin 2021 rezultojnë 10,50 % e të pandehurve shifër e njëjtë në krahasim me vitin 2020.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen shoqërore të të pandehurve për vitet 2021-2023:




Për sa i takon gjendjes shoqërore të të pandehurve, nga të dhënat statistikore vërehet se në vitin 2023 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 3,04 % e të pandehurve, në vitin 2022 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 2,6 % e të pandehurve, në vitin 2021 të punësuar në sektorin shtetëror rezultojnë 2,5 % e të pandehurve.

Të pandehurit e punësuar në sektorin privat në vitin 2023 përbëjnë 32,06 % të numrit të të pandehurve, në vitin 2022 përbëjnë 32,24 % të numrit të të pandehurve në vitin 2021 përbëjnë 27,44 % të numrit të të pandehurve.

Në vitin 2023 rezultojnë 64,90 % e të pandehurve si të papunë, në vitin 2022 rezultojnë 65,14 % e të pandehurve si të papunë, në vitin 2021 rezultojnë 70,02 % e të pandehurve si të papunë.

Pra ajo që vërehet nga të dhënat statistikore është se gjatë tre viteve të fundit më shumë se 66,76 % e të pandehurve janë të papunë dhe ky tregues është një nga faktorët kryesor kriminogjenë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna në lidhje me vendbanimin e të pandehurve për vitet 2021-2023:




Sikurse rezulton edhe nga tabela e mësipërme, në lidhje me vendbanimin e personave të cilët janë marrë të pandehur, theksojmë se nga të dhënat statistikore rezulton se kriminaliteti mbetet një

fenomen i pranishëm më shumë në qytet sesa në fshat edhe për vitin 2023 ku tendencat tregojnë se 66,73 % e të pandehurve rezultojnë me vendbanim në qytet dhe 33,27 % rezultojnë me banim në fshat.

Grafiku në vijim paraqet të dhëna në lidhje me gjendjen gjyqësore të të pandehurve për vitet 2021-2023:




Për sa i takon gjendjes gjyqësore të të pandehurve, në vitin 2023 rezulton se 1,11 % e të pandehurve janë përsëritës për të njëjtën vepër penale që do të thotë se ky tregues ka pësuar një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2022.
Përsëritës për vepra penale të ndryshme në vitin 2023 rezulton se janë 10,84 % e të pandehurve, që do të thotë rritje krahasuar me vitin 2022.
Të pandehurit e padënuar më parë në vitin 2023 përbëjnë 88,05 % të të pandehurve.

## Shtetësia e të pandehurve

Për sa i përket shtetësisë së të pandehurve, gjatë vitit 2023 rezulton se nga totali i të pandehurve, 1,58 % e tyre janë me me shtetësi të huaj. Ky tregues rezulton në ulje prej 31,25 % krahasuar me numrin e të pandehurve të huaj të regjistruar në vitin 2022.



## Të miturit 2023

Gjatë vitit 2023, bazuar në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë regjistruar 891 procedime penale ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin, me një rritje prej 8,53 % krahasuar me vitin 2022.
Nga të dhënat statistikore rezulton se janë regjistruar 746 të mitur si të pandehur ose persona nën hetim për kryerjen e veprave penale dhe ndaj 36 prej tyre është vendosur masë sigurimi arrest në burg, që zë rreth 4,83 % të të pandehurve të mitur ose një rritje prej 44 % të këtij raporti krahasuar me vitin 2022.
Lidhur me vendimarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin, të dhënat tregojnë se është vendosur mosfillimi për 603 referime/kallzime penale ndaj të miturve, janë pushuar 353 çështje me 353 të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 11,01 % të çështjeve dhe rritje prej 25,62 % të të pandehurve krahasuar me vitin 2022 dhe janë dërguar për gjykim 178 çështje me 195 të pandehur ose një ulje prej rreth 13,59 % të çështjeve të dërguara për gjykim dhe ulje prej 13,33 % të të pandehurve, krahasuar me vitin 2022.
Shkaqet e vendimmarrjes në rastet e pushimit të çështjes, tregojnë se në 90,37 % të çështjeve janë vendosur masa alternative të shmangies dhe pjesa tjetër është pushuar për shkaqe të tjera procedurale.
Sa i përket aplikimit të masës alternative të shmangies, nga të dhënat rezulton se është aplikuar shmangia në 319 çështje me 326 të pandehur që është vendosur pushimi, ndër të cilat për 2 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur këshillim, për 39 të mitur është vendosur paralajmërim me gojë për 282 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur paralajmërim me shkrim dhe për 3 të pandehur janë vendosur masa detyruese.

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhëna për të pandehurit në konflikt me ligjin në lidhje me aplikimin e masave të shmangies:




## Të dhëna mbi masat e sigurimit personal

Lidhur me të dhënat statistikore për caktimin e masave të sigurimit shtrënguese për vitin 2023, për 55,31 % të të pandehurve të regjistruar ( 32,03 % të të pandehurve në hetim) është kërkuar caktimi i një mase sigurimi shtrënguese. Ndërkohë, rezulton se 59,32 % e kërkesave, lidhet me caktimin e një mase sigurimi me arrest, masa këto të kërkuara për 32,81 % të të pandehurve regjistruar ( 19 % të të pandehurve në hetim). Krahasuar me vitin 2022 janë caktuar masa sigurimi shtrënguese për 52,42 % të të pandehurve të regjistruar ( 28,99 % të të pandehurve në hetim), ndërkohë që rezulton se 56,49 % e kërkesave, lidhet me caktimin e një mase sigurimi me arrest, masa këto të kërkuara për 29,61 % të të pandehurve regjistruar ( 16,37 % të të pandehurve në hetim).

# III. MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2023 përveç detyrave që burojnë nga ligji ka kryer edhe detyra të tjera, të cilat konsistojnë në:

a) bashkëpunimin me prokurorët për plotësimin korrekt të dokumentacionit lidhur me kërkesat në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;
b) ndjekjen në dinamikë dhe kontrollin për realizimin sa më efektiv dhe në afat të kërkesave në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, pa ndërhyrë në pavarësinë e prokurorëve;
c) bashkërendimin me drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me institucione të tjera, të vendit ose të huaja, si pikë kontakti me këto autoritete;
ç) kontributin në hartimin e raporteve të ndryshme në funksion të raportimit periodik të Prokurorisë së Përgjithshme pranë institucioneve shqiptare si *Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Evropës dhe Punët e Jashtme*, për zbatimin e strategjive/planeve të veprimit si, Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë, integrimit europian të Shqipërisë etj., apo në funksion të raportimeve periodike tek organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë *si, Komisioni Europian, Moneyval, GRECO, UNODC etj.*;
d) dhënien e kontributit me qarkore orientuese për prokurorët, në funksion të përmirësimit të punës në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;
dh) organizimin dhe mbajtjen e takimeve periodike me autoritetet vendase dhe ato të huaja, të atashuara në Shqipëri; komunikimi me përfaqësuesit e huaj si psh:
- *me organizatorët e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Europiane CCPE;*
- *me përfaqësues të Rrjetit Gjyqësor Europian EJN;*
- *me Prokurorin Ndërlidhës shqiptar të atashuar në EUROJUST,*
- *me përfaqësues të EPPO,*
- *me përfaqësues të Rrjetit Europian të Prokurorëve për Mjedisin ENPE;*
- *me përfaqësues të Ambasadave të huaja të akredituara në Shqipëri, si dhe kontakte periodike me Prokurorët dhe Oficerët Ndërlidhës Policorë të atashuar në to.*

e) bashkërendimin me drejtoritë dhe sektorët e tjerë në Prokurorinë e Përgjithshme, për të organizuar trajnime, seminare, konferenca etj. në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe në të gjithë fushat ku ka nevojë për trajnime;
ë) hartimin e programeve të nevojshme për udhëtimet zyrtare jashtë vendit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe përfaqësuesve të institucionit të prokurorisë, si dhe organizimi i vizitave të përfaqësuesve të autoriteteve të huaja gjyqësore në Shqipëri;
f) plotësimin e nevojave të institucionit të prokurorisë për përkthim;
g) kryerja e funksioneve të tjera të caktuara me ligj.

Në veprimtarinë e drejtorisë sonë, rëndësi të veçantë ka marrë bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë Interpol Tirana ku, megjithë dinamikën në punën tonë të përditshme, marrëdhëniet me këto institucione kanë qënë korrekte dhe vështirësitë e hasura janë tejkaluar me sukses.

Gjithashtu, implementimi i Marrëveshjeve me EUROJUST dhe Zyrën e Prokurorit Publik Europian (EPPO), referuar rezultateve të deritanishme të bashkëpunimit ka provuar se institucioni ynë është tashmë një partner me vlerë.
Impakt në volumin e punës kanë pasur edhe marrëveshjet dypalëshe të nënshkruara, përkatësisht:

- ***Marrëveshja ndërmjet Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës së Shqipërisë*** *si shtesë e Konventës Europiane* ***"Për Ekstradimin"*** *e vitit 1957* e cila me hyrjen në fuqi në mars të vitit 2022 u zbatua menjëherë duke filluar procedurat e ekstradimit të shtetasve shqiptarë drejt Spanjës – në tërësi për vitin 2023 rezultojnë 9 praktika ekstradimi drejt Spanjës, nga të cilat 8 janë përfunduar;
- ***Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut "Për transferimin e personave të dënuar"*** e ratifikuar me ligjin nr. 125 datë 16.12.2021, hyri në fuqi në datë 05.05.2022. gjatë vitit 2023 janë paraqitur 38 kërkesa për transferimin e të dënuarve nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri. Prokuroria e Përgjithshme së bashku me Ministrinë e Drejtësisë po bashkëpunojnë ngushtë me Ambasadën Britanike në Tiranë për shmangien e vështirësive që hasen lidhur me këto praktika dhe realizimin me sukses të transferimeve.

Në frymën e rritjes së bashkëpunimit përmendim gjithashtu, nismën e Prokurorisë së Përgjithshme për amendimin e *Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Prokurorit Federal të Belgjikës,* për bashkëpunim gjyqësor në veçanti në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (nënshkruar në Bruksel më 10.05.2011), e cila aktualisht është fazën e diskutimeve dypalëshe, nëpërmjet Zyrës së Oficerit Ndërlidhës Belg.

**Sa i takon rezultateve të punës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2023, në total, gjatë vitit 2023 në regjistrin e Zyrës së Protokoll-Arkivës rezultojnë rreth 8808 shkresa hyrëse.**

**Nga të dhënat e regjistruara në sistemin IMPRO të drejtorisë rezultojnë, përkatësisht:**

- **171 praktika ekstradimi nga jashtë drejt Shqipërisë**, ndër të cilat janë përfunduar gjithsej 45. Nga këto rezultojnë, 36 praktika ekstradimi me Greqinë, 30 me Italinë, 30 me Mbretërinë e Bashkuar, 18 me Gjermaninë, 14 me Spanjën, 6 me Francën etj.
- **99 praktika ekstradimi nga Shqipëria për jashtë**, ndër të cilat janë përfunduar gjithsej 48. Nga një rast rezulton të jetë me shtete si, Austri, Kinë, Belgjikë, Bullgari, Egjipt, Gjeorgji, Peru, Kore e Jugut, Zvicër, Tunizi, ndërsa rezultojnë 7 raste me Gjermaninë, 55 raste me Italinë, 9 me Spanjën, 3 me Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, 3 me Poloninë dhe Turqinë etj.
- **431 letërporosi nga jashtë drejt Shqipërisë**, ndër të cilat janë përfunduar gjithsej 229 ose 53 %. Nga këto rezultojnë 68 letërporosi të dërguara nga Gjermania, 77 Kosova, 44 Portugalia, 37 Italia, 32 Greqia, 21 Turqia 18 Mali i Zi, 17 Hollanda, 14 Franca, 12 Sllovenia, 11 Maqedonia e Veriut, 8 Belgjika, Hungaria, Polonia dhe Spanja, 7 Austria, 5 Mbretëria e Bashkuar, 4 SHBA, Suedia dhe Kroacia, 2 Bjellorusia etj.
- **491 letërporosi nga Shqipëria drejt vendeve te tjera**, ndër të cilat janë përfunduar gjithsej 152 ose 30%. Nga këto rezultojnë, nga 1 letërporosi me Australinë, Azerbajxhanin, Bosnjë-Herzegovinën, Brazilin, Ganën, Indinë, Indonezisë, Kenia, Kamerunit, 2 Emiratet e Bashkuara Arabe, 82 Italia, 6 Austria, 58 Greqia, 44 me Gjermaninë, 32 drejt Mbretërisë së Bashkuar, 20 drejt Zvicrës, 19 drejt SHBA-ve, 16 drejt Belgjikës, 11 Spanjës, 10 Hollanda, 7 Bullgaria, 25 Franca, 3 Izraelit, 58 Kosovës etj.

- **185 praktika shpallje në kërkim ndërkombëtar dhe 103 praktika heqje nga kërkimi ndërkombëtar**
- **280 urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, nga të cilat 125 të përfunduara;**
- **47 praktika transferimi i të dënuarve nga jashtë**
- **2 praktika transferimi i të dënuarve për jashtë**
- **33 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë**
- **8 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë**
- **22 praktika transferimi të procedimeve nga jashtë**
- **16 praktika transferimi të procedimeve për jashtë**
- **495 praktika të tjera të ndryshme**
- **43 hetimi pasuror,** ku në kuadër të trajtimit të kërkesave të ardhura nga autoritetet e huaja gjatë vitit 2022 (*për ekstradimin e shtetasve nga Shqipëria drejt shteteve kërkuese apo për njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimeve penale të huaja të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë*), mbështetur në ligjin antimafia, i kemi kërkuar Drejtorisë për Krimin Ekonomik dhe Financiar në Policinë e Shtetit, në **43 raste**, kryerjen e veprimeve për hetimin pasuror të këtyre subjekteve dhe për **2 raste** janë përfunduar verifikimet nga Policia e Shtetit, e cila ka njoftuar sipas rastit referimin pranë prokurorive kompetente me juridiksion të përgjithshëm ose arkivimin e praktikave në rastet kur nuk janë identifikuar pasuri.

Kërkesat e ndryshme të ardhura nga partnerët huaj, institucionet vendase apo prokuroritë shqiptare të juridiksionit të përgjithshëm të dërguara drejtpërdrejt me e-mail në këtë drejtori janë transmetuar menjëherë sipas rastit pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë Interpol Tirana, Prokurorisë kompetente të Juridiksionit të Përgjithshëm apo Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), si dhe autoriteteve të huaja.

# I. Ekstradime

## *i. Ekstradime nga jashtë*

Gjatë vitit 2023 janë trajtuar gjithsej 171 praktika ekstradimi, për shtetas shqiptarë apo të huaj të cilët janë shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjishthëm mbi bazën e një vendimi penal dënimi të formës së prerë ose vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal "*arrest në burg*" të dhënë nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Këta shtetas janë arrestuar ose lokalizuar nga autoritetet policore të shteteve të huaja, duke iniciuar kështu procedurën e ekstradimit nga jashtë vendit për në Shqipëri. Nga të dhënat statistikore rezulton se, për periudhën raportuese janë përfunduar gjithsej 45 praktika ekstradimi.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2023, në raport me vitin e kaluar vërehet rritje e lehtë e numrit të kërkesave të paraqitura nga autoritetet shqiptare për ekstradimin e subjekteve nga jashtë drejt vendit tonë, e konkretisht në masën 5.5 %.

Më poshtë paraqesim në formë tabelare dhe grafike të dhënat për periudhën 2020-2023:

| | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|
| **Nr. kërkesave për ekstradim** | 119 | 117 | 162 | 171 |




Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat statistikore për këtë tregues (*ekstradime nga jashtë*), si dhe grafiku përkatës sipas shteteve të cilëve i janë drejtuar kërkesat për ekstradim:

| Shteti | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|
| **Itali** | 29 | 30 |
| **Greqi** | 36 | 36 |
| **Angli** | 21 | 30 |
| **Gjermani** | 15 | 18 |
| **Francë** | 5 | 6 |
| **Kosovë** | 8 | 5 |
| **Spanjë** | 8 | 14 |

### *ii. Ekstradime për jashtë*

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2023 janë arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim ekstradimi drejt shteteve të tjera 99 shtetas (shqiptarë apo të huaj), një tregues ky i cili i krahasuar me një vit më parë rezulton me ulje në masën 16.8 %. Gjatë këtij viti rezulton të jenë përfunduar 45 praktika ekstradimi.

| Ekstradime për jashtë | | | |
|---|---|---|---|
| Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
| 114 | 128 | 119 | 99 |




Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e plota mbi praktikat e regjistruara në fushën e ekstradimit për jashtë, sipas shteteve, si dhe praktikat e përfunduara gjatë vitit 2023 për secilin shtet:

*Ekstradime për jashtë 2023*

| | *Të regjistruara* | *Të përfunduara* |
|---|---|---|
| *Itali* | 55 | 23 |
| *Spanjë* | 9 | 9 |
| *Gjermani* | 7 | 4 |
| *Kosovë* | 3 | 2 |
| *Maqedoni e Veriut* | 3 | 2 |
| *Poloni* | 3 | 1 |
| *Turqi* | 3 | 2 |

## II. Kërkesa për ndihmë juridike (Letërporosi)

### i. *Letërporositë nga jashtë*

Autoritetet gjyqësore të huaja, gjatë vitit 2023 kanë paraqitur në vendin tonë 431 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të çështjeve penale, tregues i cili rezulton me ulje në masën 11.8 % krahasuar me vitin 2022, vit në të cilin janë paraqitur 489 letërporosi.

Në tërësi rezulton që gjatë vitit 2023, nga 431 letërporosi të dërguara në Shqipëri nga autoritetet e huaja rezulton të jenë ekzekutuar/përfunduar veprimet proceduriale nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm gjithsej 229 letëporosi, ose 53 %.




Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e regjistruara për kërkesat për ndihmë juridike, të ndara sipas shteteve, si dhe të dhënat respektive mbi letërporositë e përfunduara për çdo shtet.

| | Të regjistruara | Të përfunduara | Të përfunduara në % |
|---|---|---|---|
| *Kosovë* | 77 | 43 | 55.8 |
| *Gjermani* | 68 | 46 | 67.6 |
| *Portugali* | 44 | 29 | 65.9 |
| *Itali* | 37 | 21 | 56.8 |
| *Greqi* | 32 | 20 | 62.5 |
| *Turqi* | 21 | 13 | 61.9 |
| *Mali i Zi* | 18 | 9 | 50.0 |
| *Hollandë* | 17 | 8 | 47.1 |
| *Francë* | 14 | 3 | 21.4 |
| *Slloveni* | 12 | 4 | 33.3 |
| *Maqedoni e Veriut* | 11 | 6 | 54.5 |
| *Spanjë* | 8 | 5 | 62.5 |
| *Belgjikë* | 8 | 4 | 50.0 |
| *Hungari* | 8 | 4 | 50.0 |
| *Poloni* | 8 | 1 | 12.5 |
| *Austri* | 7 | 3 | 42.9 |
| *Mbretëri e Bashkuar* | 5 | 3 | 60.0 |
| *SHBA* | 4 | 0 | 0.0 |
| *Kroaci* | 4 | 1 | 25.0 |
| *Suedi* | 4 | 2 | 50.0 |

### ➢ *Letërporositë nga jashtë të ndara sipas grup veprave penale*

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, ndër të cilat[28] të grupuara sipas grupveprave penale rezultojnë:

- 43 letërporosi të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të trafiqeve të paligjshme *(kryesisht trafikimi i lëndëve narkotike),*
- 45 letërporosi për veprat penale kundër narkotikëve
- 65 letërporosi të ardhura nga autoritetet e huaja gjyqësore për kryerjen e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve,
- 11 letërporosi për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale,
- 37 letërporosi për veprën penale të mashtrimit,
- 20 letërporosi për veprën penale shkelje e ligjit të qëndrimit,
- 11 letërporosi për veprat penale të krimit kibernetik
- 2 letërporosi për veprën penale të dhunës në familje.

### ➢ ***Videokonferenca***

Theksojmë se, gjatë vitit 2023 është rritur ndjeshëm numri i kërkesave të autoriteteve të huaja (13 kërkesa) për marrjen në pyetje të personave ose dhënien e dëshmisë nëpërmjet videokonferencës.

### *ii. Letërporositë për jashtë*

Gjatë vitit 2023 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë i kanë dërguar autoriteteve të huaja gjyqësore gjithsej 491 kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruara në Shqipëri. Ky tregues ka pësuar rënie me 18 % krahasuar me vitin 2022, në të cilin janë dërguar 526 letërporosi.

Gjatë vitit 2023, nga 491 letërporosi të dërguara nga autoritetet gjyqësore shqiptare jashtë vendit rezulton të jenë përfunduar/ekzekutuar nga autoritetet e huaja gjithsej 152 letëporosi, ose 30 % e tyre.




[28] Sipas të dhënave, të gjeneruara nga sistemi elektronik IMPRO

Sa i takon shpërndarjes gjeografike sipas prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm rezulton se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën raportuese ka dërguar jashtë vendit në funksion të hetimit 125 letërporosi, Durrësi 48, Shkodra 51, Kukësi 44, Korça 38, Lezha 30, Elbasani 29, Fieri 27, Vlora 26, Saranda 14 etj. (të dhëna të cilat paraqiten në grafikun e mëposhtëm)




iii. ***Letërporositë sipas veprave penale***

Gjatë vitit 2023, prokurorитё pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm kanë dërguar pranë autoriteteve të huaja kërkesa për ndihmë juridike në kuadër të procedimeve penale të regjistruar për vepra të ndryshme penale, të grupuara si më poshtë:

- 103 letërporosi për autoritetet e huaja për kryerjen e veprave penale të trafiqeve të paligjshme;
- 77 letërporosi për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- 64 letërporosi për kryerjen e veprave penale të krimit kibernetik;
- 67 letërporosi për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve;
- 87 letërporosi për veprat penale të mashtrimit;
- 32 letërporosi në kuadër të procedimeve për kryerjen e krimeve kundër jetës të kryera me dashje;
- 7 letërporosi për kryerjen e veprave penale të dhunës në familje 2021.

# III. Njohjet e vendimeve penale

## *i. Njohjet e vendimeve penale të huaja*

Referuar të dhënave statiskore rezulton se, për vitin 2023 autoritetet e huaja kanë paraqitur gjithsej 33 kërkesa për njohjen e vendimeve të tyre penale dhënë në ngarkim të shtetasve shqiptarë, tregues

ky i cili rezulton me rritje në masën 73 % krahasuar me vitin 2022, vit në të cilin është kërkuar njohja e 19 vendimeve penale të huaja.




Sikurse vërehet në tabelën e mëposhtme, Italia ka vijuar të zënë pjesën më të madhe të kërkesave për njohje vendimi penal përkatësisht me 20 kërkesa, ndërsa Belgjika ka paraqitur 2 kërkesa, Kosova 4 etj.

### *ii. Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit*

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2023 autoritetet shqiptare kanë paraqitur gjithsej 8 kërkesa për njohjen e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit, përkatësisht 2 Kosovës, 2 Italisë, 1 Moldavisë, 1 Hollandës, 1 Polonisë dhe 1 Venezuelës.




## IV. Transferimet e procedimeve penale

### *i. Transferimet e procedimeve penale*

Gjatë vitit 2023, autoritetet e huaja gjyqësore kanë transferuar në Shqipëri 22 procedime penale me qëllim ushtrimin e ndjekjes penale, ndërsa për periudhën raportuese prokuroritë shqiptare kanë transferuar jashtë vendit gjithsej 16 procedime penale (*shih grafikun e mëposhtëm*).




Sikurse vërehet nga të dhënat rezulton se, për periudhën raportuese ka rritje të numrit të procedimeve penale të transferuara nga autoritetet e huaja në Shqipëri në raport me një vit më parë dhe gjithashtu rritje të numrit të procedimeve penale të transferuara nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm drejt autoriteteve gjyqësore të huaja.

| Shtetet | Transferime procedimesh penale nga jashtë | Transferime procedimesh penale për jashtë |
|---|---|---|
| Itali | 1 | 4 |
| Kosovë | 14 | 9 |
| Greqi | 1 | 1 |
| Bosnjë-Herzegovinë | 1 | |
| Francë | 2 | |
| Kroaci | | 1 |
| Mali i Zi | 3 | |
| Maqedoni e Veriut | | 1 |
| ***Totali analitik*** | **22** | **16** |

# V. Transferimet e personave të dënuar

## ***i. Transferimet e personave të dënuar***

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur gjithsej 47 kërkesa për transferimin në Shqipëri të të dënuarve jashtë vendit, përkatësisht 38 kërkesa nga Mbretëria e Bashkuar, 4 Italia, 3 Suedia dhe 2 Serbia. Ndërsa për transferimin nga Shqipëria jashtë vendit të të dënuarve janë paraqitur 2 kërkesa.

| Viti | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | Viti 2023 |
|---|---|---|---|---|
| Transferimi i të dënuarve nga jashtë | 35 | 2 | 10 | 47 |

- ***Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet shqiptare***

Referuar të dhënave statistikore konstatohet se, gjatë vitit 2023 Prokuroria Shqiptare ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 185 shtetas (*shqiptarë apo të huaj*) të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë ose me vendim mase të sigurimit personal "*Arrest në burg*". Krahasuar me vitin 2022, në të cilin janë shpallur në kërkim ndërkombëtar 245 persona, për vitin raportues ky tregues ka pësuar ulje në masën 24,4 %. Ndërkohë për të njëjtën periudhë raportuese rezultojnë 103 praktika për heqjen e personave nga listat e kërkimit ndërkombëtar.




***- Urdhrat e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë (UAN)***

Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana ka njoftuar **280 raste për** shpalljen e shtetasve shqiptarë në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja, me të cilët Republika e Shqipërisë nuk ka marrëveshje ekstradimi.

Vlerësojmë të theksojmë se, përveç volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2023 ka trajtuar rreth **495 kërkesa të ndryshme** të ardhura nga autoritetet gjyqësore vendase e ato të huaja, si dhe ka asistuar prokurorin ndërlidhës shqiptar në EUROJUST në 27 raste.

## VI. ZYRA NDËRLIDHËSE E SHQIPËRISË NË EUROJUST

Në vitin 2023, të dhënat në lidhje me çështjet aktive të regjistruara nga Zyra shqiptare dhe kundrejt Zyrës shqiptare (të hapura me kërkesë të autoriteteve gjyqësore kombëtare dhe me kërkesë të vendeve të Bashkimit Evropian) janë në thelb konfirmuese të tendencës në rritje në raport me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar në total 116 çështje krahasuar me 85 në 2022. Janë regjistruar 76 çështje të reja nga zyra shqiptare, me kërkesën e autoriteteve gjyqësore shqiptare, dhe 40 nga zyrat e vendeve të tjera të Bashkimit Evropian (BE), mbi kërkesën e autoriteteve të tyre gjyqësore.




Paraqitja grafike e mësipërme ofron informacion të mëtejshëm. Stabiliteti thelbësor i numrit të çështjeve të reja të regjistruara dhe të trajtuara në vitin 2023 nga zyra shqiptare krahasuar me një vit më parë, korrespondon me një rritje prej 36 %.
Numri i çështjeve nga viti 2019 deri në 2023 ka pësuar një rritje eksponenciale, gjë që tregon bashkëpunim më aktiv mes prokurorisë shqiptare dhe prokurorive të vendeve të Bashkimit Evropian.



Sa i takon kategorive të çështjeve të trajtuara, konstatohet se numrin më të madh të çështjeve e zenë hetimet e pastrimit të parave, të ndjekura nga krimi i organizuar, trafikimi i drogës dhe korrupsioni.




Kjo shpjegohet pasi kërkesat për asistencë, Zyrës shqiptare të Eurojust-it, i vijnë kryesisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar(SPAK), e cila është e përfshirë në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Vihet re një trend zbritës në lidhje me kërkesat e shteteve anëtare të BE-së kundrejt zyrës shqiptare në Eurojust, në lidhje me kërkesat për lehtësim ekzekutimi të letërkërkesave në raport me vitin 2022 apo kërkesa të tjera në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale.

Për sa i përket vendeve kundrejt të cilave drejtohen kërkesat e autoriteteve shqiptare, më të përfshira gjatë vitit 2023 ishin Franca (23), Italia (18) dhe Greqia (7) etj.

Ndërsa vendi i Bashkimit Europian që kërkon më së shumti lehtësimin dhe përshpejtimin e ekzekutimit të letërkërkesave është Italia me 17 çështje të hapura, më pas renditen shtetet e tjera me një numër më të reduktuar. Trendi i ri është tashmë marrja e kërkesave nga shumica e autoriteteve të vendeve të Bashkimit Europian, duke përfshirë tashmë edhe Sllovakinë, Hungarinë, Poloninë, etj.

Suksesi më i madh i punës së autoriteteve gjyqësore shqiptare dhe Zyrës shqiptare në Eurojust në bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale ka të bëjë me krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore(SPH) me prokuroritë e vendeve të Bashkimit Evropian.

Gjatë vitit 2023, autoritetet shqiptare kanë nënshkruar marrëveshjet për krijimin e 5 skuadrave të reja hetimore me asistencën e Eurojust, dhe 17 skuadra kanë qenë aktive në vijim duke çuar numrin e skuadrave të përbashkëta hetimore për vitin 2023, në 22 skuadra hetimore. Këto skuadra janë krijuar vetëm mes SPAK dhe autoriteteve gjyqesore të vendeve të Bashkimit Europian, Itali, Francë etj. Trendi vijon të jetë në rritje, nga 5 skuadra të përbashkëta hetimore aktive në vitin 2019, në 22 skuadra të përbashkëta hetimore aktive në vitin 2023.




Gjithashtu pjesëmarrës në këto skuadra janë edhe Europol (5 skuadra) dhe vendet jo anëtare të BE si Ukraina, Maqedonia e Veriut, Gjeorgjia, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar etj.

Skuadrat e përbashkëta hetimore[29] kryesisht janë krijuar për të mbështetur hetimet e trafikimit të lëndëve narkotike, por edhe për krime të llojeve të tjera si krime kibernetike, pastrim i parave, terrorizmit, trafikimi i qenieve njerëzore, etj.




Eurojust financon shpenzimet për hetimet që kryhen nga skuadrat e përbashkëta hetimore. Ky program financimi siguron që kufizimet financiare dhe të tjera organizative që lidhen me natyrën ndërkufitare të një rasti (hetimi), të mos pengojnë krijimin dhe nevojat operacionale të një skuadre. Si pjesë e përpjekjeve të saj për të lehtësuar përdorimin e SPH-ve, Eurojust ofron mbështetje financiare për të mbuluar kostot e përfshira në aktivitetet hetimore ndërkufitare të lartpërmendura. Eurojust nuk financon SPH-të në tërësinë e tyre, por më tepër kontribuon duke rimbursuar kostot e katër fushave të shpenzimeve të përbashkëta: • udhëtimi dhe akomodimi; • interpretimi dhe përkthimi; • transferimi i objekteve (dokumentet procedurale, provat ose objektet e sekuestruara gjatë operacioneve të ekipit); • konsulencë e specializuar.
Shfrytëzojmë rastin të informojmë se për vitin 2023 është planifikuar një zgjerim i fushës së mbulimit të shpenzimeve të sipërpërmendura, siç raportohet më poshtë: • opsioni i marrjes me qira të makinave;

[29] Një skuadër mund të hetojë më shumë se një krim

• mundësia për të kërkuar kosto për dhënien me qira të pajisjeve dhe abonimet e softuerit/licencës; • rimbursimi i udhëtimeve kombëtare (me kusht që në aktivitet të marrë pjesë edhe autoriteti i huaj); • kosto indirekte fikse (për rimbursimin e kostove të ndryshme të vogla, si parkimi apo transporti lokal). Për sa i përket financimit të SPH-ve për vitin 2023, SPAK ka siguruar financime të konsiderueshme nga Eurojust.

*Mbledhjet e koordinuara*
Sa i takon Mbledhjeve të Koordinuara, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 22 mbledhje të koordinuara, nga të cilat 3 janë zhvilluar me iniciativën e Zyrës shqiptare në Eurojust, dhe për 19 mbledhje të koordinuara autoritetet gjyqësore shqiptare jane ftuar nga autoritetet gjyqësore të vendeve të BE-së.







Mbledhjet e Koordinuara janë zhvilluar kryesisht me ftesën dhe pjesëmarrjen e autoriteteve gjyqësore të Italisë dhe Francës, por edhe vendeve të tjera të BE-së. Në këto mbledhje kanë marrë pjesë edhe autoritetet gjyqësore të vendeve jo anëtare të BE-së, si dhe Europol.
Mbledhjet e Koordinuara[30] janë zhvilluar kryesisht në lidhje me hetimet mbi veprat penale në fushën e narkotikëve, krimit të organizuar, pastrimit të parave, mashtrimit, terrorizmit, etj.




[30] Një MK mund të trajtojë më shumë se një krim

# IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Gjatë vitit 2023, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" (ligji nr. 138/2015) dhe Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" (Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016).

**1.** Gjatë vitit 2023 në Sektorin e Dekriminalizimit janë regjistruar 91 (nëntëdhjetë e një) kërkesa të reja në zbatim të ligjit nr. 138/2015, të paraqitura nga subjektet si më poshtë:

- 46 (dyzet e gjashtë***)*** nga Departamenti Administratës Publike;
- 45 (dyzet e pesë) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Më poshtë paraqitja grafike e tyre:




**1.1** Nga 91 (nëntëdhjetë e një) kërkesa të reja, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 77 (shtatëdhjetë e shtatë) procese për verifikim të thelluar në zbatim të ligjit nr. 138/2015.
Këto procese, sipas organeve kompetente që kanë kërkuar verifikimin e thelluar të të dhënave të vetëdeklaruara në formularë nga subjektet, për vitin 2023, ju përkasin:

- 38 (tridhjet e tetë) kërkesave të bëra nga Departamenti Administratës Publike;
- 39 (tridhjet e nëntë) të bëra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Referuar nivelit hierarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose që zgjidhen që kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit sipas nenit 5 të ligjit, proceset e verifikimit të regjistruara në vitin 2023 ju përkasin:

- 9 (nëntë) subjekte në kategorinë "Zyrtar i Lartë";

- 42 (dyzet e dy) subjekte në kategorinë “Nivel Drejtues”;
- 6 (gjashtë) subjekte në kategorinë “Nivel Ekzekutiv”;
- 20 (njëzet) subjekte në kategorinë “Nivel i Mesëm”.

Më poshtë paraqitja grafike:




**1.2** Për 12 (dymbëdhjetë) kërkesa të ardhura gjatë vitit 2023, është vendosur “Mospranimi i kërkesës”, për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet, për arsye të mosplotësimit të kushteve e kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015 dhe në Kreun II, III dhe V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, lidhur me kryerjen nga Prokuroria e Përgjithshme të procesit të verifikimit të thelluar të të dhënave të vetëdeklaruara në formular nga personat subjekt të ligjit.
Nga këto vendime mospranimi, 8 (tetë) i referohen kërkesave të ardhura nga DAP dhe 4 (katër) kërkesave të ardhura nga KQZ.

**1.3** Për 2 (dy) kërkesa, të paraqitura nga organi përgjegjës për administrimin e formularit, Sektori i Dekriminalizimit ka kërkuar plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kritereve formale ligjore të tyre, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 dhe neneve 44, 62 e 64 të Kodit të Procedurave Administrative. Këto kërkesa për verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit, i përkasin Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Më poshtë paraqitja grafike:




**1.4** Gjithashtu gjatë vitit 2023 është trajtuar dhe një praktikë e ardhur nga Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet së cilës kërkohej verifikimi i thelluar për 38 subjekte, kandidatura për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të cilët organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit (në rastin konkret Komisioni i Pavarur *Ad Hoc*) nuk kishte kryer verifikimin paraprak të të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit.
Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme pasi shqyrtoi paraprakisht dokumentacionin, në mbështetje të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 1, 2, 3, 4 dhe Kreut VI të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, i ka kthyer praktikën Institucionit të Avokatit të Popullit për të ndjekur procedurat e përcaktuara ligjore.

**2.** Gjatë vitit 2023, nga Sektori i Dekriminalizimit është ndjekur procesi i verifikimit të thelluar të të dhënave të vetëdeklaruara në formular, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, për 155 (njëqind e pesëdhjetë e pesë) subjekte si më poshtë:

- 77 (shtatëdhjetë e shtatë) subjekte të regjistruara në vitin 2023;
- 78 (shtatëdhjetë e tetë) subjekte të mbartura nga vitet 2017 – 2022.

Më poshtë paraqitja grafike:



**3.** Gjatë vitit 2023 janë përfunduar 85 (tetëdhjetë e pesë) procese për verifikim të thelluar nga të cilat 29 (njëzet e nëntë) vendime janë procese të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vendime janë procese të mbartura nga vitet 2017 - 2022.

Më poshtë paraqitja grafike:




**3.1** Brenda vitit 2023, për kërkesat e ardhura po në këtë vit, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka përfunduar procesin e verifikimit të thelluar dhe miratuar rezultatin për 29 (njëzet e nëntë) subjekte të ligjit, dhe janë mbartur për të vijuar procesin për vitin 2024, 48 (dyzet e tetë) subjekte të ligjit.

Sipas, organeve kompetente që kanë kërkuar në vitin 2023 verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruara në formularë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, gjendja e proceseve për verifikim është si më poshtë vijon:

| Institucioni | Të përfunduara | Në proces |
|---|---|---|
| **Departamenti i Administratës Publike** | 21 | 17 |
| **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** | 8 | 31 |
| **TOTALI** | **29** | **48** |

Më poshtë paraqitja grafike:




Sipas nivelit hierakik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose që zgjidhen, të cilët kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit, të parashikuar në nenin 5 të ligjit, procesi i verifikimit ka përfunduar për:

- 2 (dy) subjekte, "Zyrtar i Lartë" ;
- 4 (katër) subjekte, "Nivel Ekzekutiv";
- 11 (trembëdhjetë) subjekte, "Nivel Drejtues";
- 12 (trembëdhjetë) subjekte, "Nivel i Mesëm Drejtues".

Më poshtë paraqitja grafike:




**3.2** Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes dhe shqyrtimit të rezultateve të verifikimit për 21 (njëzet e një) proceset e vitit 2023, të përfunduara nga Prokuroria e Përgjithshme, ka njoftuar për 15 (pesëmbëdhjetë) prej tyre qëndrimet si më poshtë:

- Për 1 (një) subjekt është vendosur se *ka përfunduar periudha e ndalimit për kandidim*;
- Për 1 (një) subjekt është vendosur se *përfshihet në nenin 2, pika 1, gërma ç*;
- Për 2 (dy) subjekte DAP ka vendosur *të konkludojë pasi të mbarojnë të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi të ketë marrë formë të prerë;*

- Për 10 (dhjetë) subjekte është vendosur se *nuk përfshihen*;
- Për 1 (një) subjekt është vendosur *lirimi nga shërbimi civil;*

Për 6 (shtatë) subjekte të tjera nuk kemi marrë ende njoftim.

Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka dërguar njoftim për rezultatet e verifikimit për 8 (tetë) proceset e vitit 2023 të përfunduara nga Prokuroria e Përgjithshme.

**3.3** Brenda vitit 2023, për proceset e mbartura nga 2017 - 2022, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka përfunduar procesin e verifikimit të thelluar dhe miratuar rezultatin për 56 (pesëdhjetë e gjashtë) subjekte të ligjit, dhe kanë vijuar procesi, për vitin 2024, për 22 (njëzet e dy) subjekte të ligjit.

| **Institucioni** | **Të përfunduara** | **Në proces** |
|---|---|---|
| Departamenti i Aministratës Publike | 45 | 10 |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 11 | 11 |
| Ministria e Brendshme | 0 | 1 |
| **TOTALI** | **56** | **22** |

Më poshtë paraqitja grafike:




**3.4** Në lidhje me nivelin hierarkik të 56 (pesëdhjetë e gjashtë) subjekteve të mësipërme të mbartura nga vitet 2017 – 2022, për të cilat është marrë vendim brenda vitit 2023, rezultojnë si më poshtë:

- 10 (dhjetë) subjekte në kategorinë "Zyrtar i Lartë";
- 11 (njëmbëdhjetë) subjekte në kategorinë "Nivel Drejtues";
- 21 (njëzet e një) subjekte në kategorinë "Nivel Ekzekutiv";
- 14 (katërmbëdhjetë) subjekte në kategorinë "Nivel i Mesëm";

Më poshtë paraqitja grafike:




**3.5** Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes dhe shqyrtimit të rezultateve të verifikimit për 45 (dyzet e pesë) procese të mbartura, të cilat kanë përfunduar gjatë vitit 2023 nga Prokuroria e Përgjithshme, ka njoftuar qëndrimet si vijon për 43 (dyzet e tre) prej tyre:

- Për 27 (njëzet e shtatë) subjekte është vendosur që *nuk përfshihen;*
- Për 5 (pesë) subjekte është vendosur që *përfshihen;*
- Për 2 (dy) subjekte është vendosur *ndërprerje e marrëdhënies financiare;*
- Për 2 (dy) subjekte është vendosur *lirimi nga shërbimi civil;*
- Për 4 (katër) subjekte DAP ka vendosur *të konkludojë pasi të mbarojnë të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi të ketë marrë formë të prerë;*
- Për 2 (dy) subjekte është vendosur se *ka përfunduar periudha e ndalimit për kandidim;*
- Për 1 (një) subjekt është vendosur *ndërprerje e punës me dëshirë nga subjekti;*

Për 2 (dy) subjekte të tjera nuk kemi marrë ende njoftim.

Ndërsa, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka dërguar njoftim për rezultatet e verifikimit për 11 (njëmbëdhjetë) proceset (e mbartura) të përfunduara nga Prokuroria e Përgjithshme.

**4.** Nga rastet për të cilat ka përfunduar procesi i verifikimit të thelluar në vitin 2023 dhe miratuar rezultati, mbështetur në nenet 69, 74 e 76 të Kodit të Procedurës Penale, për 9 (nëntë) persona, materiali është kaluar për kompetencë në prokuroritë përkatëse, si të dyshuar për veprën penale të "Falsifikimit i vulave, i stampave ose i formularëve", parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, nga të cilat 4 (katër) janë për kërkesat e vitit 2023, 2 (dy) për kërkesat e vitit 2020 dhe 3 (tre) për kërkesat e vitit 2021.

**4.1** Personat që kanë rezultuar të kenë plotësuar formularin e vetëdeklarimit me të dhëna të rreme, ju përkasin kërkesave për verifikim të ardhura si vijon:

- 8 (tetë) nga Departamenti i Administratës Publike;
- 1 (një) nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Më poshtë paraqitja grafike:




**5**. Në vitin 2024 vijojnë të jenë ende në proces verifikimi 70 (shtatëdhjetë) kërkesa për verifikim nga të cilat 48 (dyzet e tetë) janë të mbartura nga viti 2023 dhe 22 (njëzet e dy) të mbartura nga vitet 2017 – 2022).

**6**. Gjatë vitit 2023 Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka siguruar bashkëpunimin me DAP, KQZ dhe institucione të tjera si dhe i është përgjigjur në kohë kërkesave të këtyre institucioneve dhe palëve të tjera në proces, për statusin e procesit të verifikimit të thelluar dhe interpretime të ndryshme ligjore në lidhje me vendimmarrjen për rezultatet e verifikimit.

# V. NGARKESA E PUNËS SË PROKURORIVE PËR VITIN 2023

Ky raport është hartuar në përputhje me nenin 19 pika 1, të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kanë sanksionuar se prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm përbëhen nga:
a) Prokuroria e Përgjithshme;
b) Prokuroria pranë Gjykatës të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm;
c) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Në vitin 2023, numri i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve në juridiksionin e përgjithshëm është **321.**

Shpërndarja e tyre në prokurori sipas niveleve ka qenë: 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme. Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 177 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 10 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 11 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2022[31] nuk përbën ulje në numrin faktik total të prokurorëve.

Në vitin 2023 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për çdo prokurori paraqitet si vijon:

| Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë | Prokurorë | | | Oficerë të Policisë Gjyqësore | | Administrata | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Organika | Gjendja | Efektivë[32] | Organika | Gjendja | Organika | Gjendja | Organika | Gjendja |
| Tiranë | 90 | 55 | 50.50 | 63 | 61 | 77 | 76 | 230 | 192 |

[31] Numri faktik i prokurorëve për vitin 2023 pavaresisht largimeve nga sistemi te magjistrateve nga procesi i vettingut nuk ka ndryshuar pasi kemi 26 emerime te reja magjitratesh te ardhur nga shkolla e magjistratues.
[32] Llogaritja e numrit efektiv është bërë sipas kohës reale të punës së prokurorit në prokurorinë përkatëse, ku:
Me pak se nje muaj (30 dite) =0 prokuror
Nga 1 në 3 muaj=0,25 prokuror
Nga 4 në 6 muaj=0,5 prokuror
Nga 7 në 9 muaj=0,75/prokuror
Nga 10 në 12 muaj=1 prokuror

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Berat** | **7** | **6** | **6** | **6** | **6** | **12** | **12** | **25** | **24** |
| **Dibër** | **8** | **6** | **5.50** | **7** | **6** | **12** | **11** | **27** | **23** |
| **Durrës** | **34** | **23** | **22** | **22** | **21** | **29** | **29** | **85** | **73** |
| **Elbasan** | **20** | **13** | **13.50** | **16** | **13** | **20** | **20** | **56** | **46** |
| **Gjirokastër** | **9** | **6** | **5.50** | **7** | **5** | **15** | **15** | **31** | **26** |
| **Fier** | **22** | **13** | **12.50** | **18** | **14** | **22** | **22** | **62** | **49** |
| **Korçë** | **19** | **11** | **10** | **15** | **12** | **24** | **24** | **58** | **47** |
| **Lezhë** | **14** | **8** | **7.75** | **11** | **11** | **16** | **16** | **41** | **35** |
| **Sarandë** | **7** | **5** | **4.50** | **6** | **5** | **10** | **10** | **23** | **20** |
| **Shkodër** | **20** | **13** | **11.50** | **17** | **17** | **23** | **23** | **60** | **53** |
| **Vlorë** | **20** | **14** | **13** | **17** | **17** | **20** | **20** | **57** | **51** |
| **Kukës** | **8** | **4** | **4.75** | **6** | **6** | **10** | **10** | **24** | **20** |
| **Total** | **278** | **177** | **166.50** | **211** | **194** | **290** | **288** | **779** | **659** |

| **Prokuroritë pranë gjykatave të apelit** | **Prokurorë** | | | **Administrata** | | **Gjithsej** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Organika** | **Gjendja** | **Efektivë** | **Organika** | **Gjendja** | **Organika** | **Gjendja** |
| **Tiranë** | **26** | **10** | **11** | **19** | **18** | **45** | **13** |

| **Prokuroria e Përgjithshme** | **Prokurorë** | | | **Oficerë të Policisë Gjyqësore** | | **Administrata** | | **Gjithsej** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Organika** | **Gjendja** | **Efektivë** | **Organika** | **Gjendja** | **Organika** | **Gjendja** | **Organika** | **Gjendja** |
| | **17** | **11** | **11** | **35** | **32** | **86** | **70** | **138** | **113** |

Duke iu referuar të dhënave statistikore vjetore të përcjella nga prokuroritë, volumi i punës dhe ngarkesa mesatare analizohet në vijim:

## I. Ngarkesa e punës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm

### I.1 Volumi në hetim

Volumi i punës në hetim në shkallë vendi
Gjatë vitit 2023, në organin e prokurorisë janë trajtuar 55 253 [33] materiale kallëzuese që përbën një ulje prej 9,4 % në krahasim me vitin 2022. Janë ndjekur gjithsej 45.715 procedime penale, që përbëjnë një ulje prej 5,2 % në krahasim me vitin 2022, nga të cilat 24 095 janë procedime penale të regjistruara, me një ulje prej 6,2 % në krahasim me vitin 2022 dhe 201 procedime penale të rifilluara, që tregon ulje prej 70 % në krahasim me vitin 2022. Janë mbartur, 21011 procedime penale me një ulje prej 3,9 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2022. Është vendosur mosfillimi për 9946 referime dhe kallëzime penale, që do të thotë një ulje prej 22,2% në krahasim me vitin 2022.




**Volumi në hetim ku përfshihen çështjet e mbartura, çështjet e regjistruara, çështjet e rifilluara dhe ato të mosfilluara, për vitin 2023 sipas prokurorive është si më poshtë**:

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat janë ndjekur 2521 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër janë ndjekur 1909 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë ndjekur 6792 çështje;

[33] Tek kjo shifër e materialeve të trajtuara përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara gjatë vitit 2023 për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal; procedimet e rifilluara gjatë vitit 2023; si dhe vendimet e mosfillimit të marra gjatë vitit 2023 pa procedimet e regjistruara sipas kodit penal ushtarak.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë ndjekur 3701 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier janë ndjekur 4801 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër janë ndjekur 1766 çështje;
Në Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë ndjekur 4253 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës janë ndjekur 1035 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë ndjekur 2384 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë janë ndjekur 2355 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë ndjekur 2937çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë ndjekur 17200 çështje;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë ndjekur 3599 çështje

Grafikisht këto të dhëna paraqiten si vijon:




Në vitin 2023 raporti i numrit të çështjeve në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, sipas prokurorive paraqitet në grafikët në vijim:

## Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit organik




## Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit faktik




## Ngarkesa mesatare në hetim për çdo prokuror sipas numrit efektiv



**I.2 Sipas prokurorive të shkallës së parë, numri i procedimeve penale të regjistruara në vitin 2023 është si vijon:**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat janë regjistruar 749 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër janë regjistruar 556 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës janë regjistruar 2685 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë regjistruar 1474 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier janë regjistruar 2058 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër janë regjistruar 615 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë regjistruar 1560 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës janë regjistruar 570 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë janë regjistruar 1381 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë janë regjistruar 877 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër janë regjistruar 1597 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë regjistruar 8463 procedime penale;
Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë regjistruar 1510 procedime penale.

Grafiku më poshtë paraqet të dhënat mbi procedimet penale të regjistruara sipas prokurorive të shkallës së parë në vitin 2023:



Ndërkohë, numri i të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar në prokuroritë e shkallës së parë, paraqitet në grafikun më poshtë:




Raporti i numrit mesatar të çështjeve të regjistruara sipas numrit organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve sipas prokurorive paraqitet në vijim:




Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit faktik
175
172
158
154
143
142
125
123
117
113
108
103
93
Sarandë
Lezhë
Fier
Tiranë
Kukës
Korçë
Berat
Shkodër
Durrës
Elbasan
Vlorë
Gjirokastër
Dibër


Procedime regjistruar për çdo prokuror sipas numrit efektiv
195
178
168
165
156
139
125
122
120
116
112
109
93
Sarandë
Lezhë
Tiranë
Fier
Korçë
Shkodër
Berat
Durrës
Kukës
Vlorë
Gjirokastër
Elbasan
Dibër

**I.3 Në analizë të përqindjes që zënë procedimet e regjistruara dhe procedimet e mbartura në volumin e punës sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:**






**I.4 Në analizë të përqindjes që zënë raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara dhe procedimeve të përfunduara me procedimet në ndjekje sipas prokurorive, të dhënat rezultojnë si më poshtë:**






## II. Ngarkesa e punës e Prokurorisë pranë Gjykatës të Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm për 5 vitet e fundit




## III. Ngarkesa e punës së Prokurorisë së Përgjithshme

### III.1 Përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme kanë përfaqësuar organin e akuzës pranë Gjykatës së Lartë në 51 çështje, prej të cilave 30 gjykime themeli (nga 65 gjykime themeli në vitin 2022), 2 përfaqësime në gjykime për të njësuar/ndryshuar praktikën gjyqësore dhe 19 mendime për çështje të shqyrtuara në dhomë këshillimi, si dhe në cilësinë e subjektit të interesuar pranë Gjykatës Kushtetuese për 22 çështje (nga 11 çështje në vitin 2022).

### III.2 Mosmarrëveshje për kompetencë

Gjatë vitit 2023 janë marrë 82 vendime për zgjidhje të mosmarrëveshjeve për kompetencën tokësore apo lëndore në hetimit paraprak të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

### III.3 Akte nënligjore

3.1 Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023 janë miratuar këto Udhëzime të Përgjithshme:

- ✓ "Për masat administrative dhe proceduriale për zbatimin e hartës së re gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm", nr. 01, datë 26.01.2023;
- ✓ "Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm", nr. 02, datë 12.05.2023.

3.2 Urdhra të Prokurorit të Përgjithshëm:
- “Për caktimin e personelit në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 3/2019, i ndryshuar, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2023;
  - “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rezolutës së Kuvendit datë 06.07.2023 “Për vlerësimin e veprmitarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2022”, nr. 103, datë 25.07.2023;
  - “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””, nr. 70, datë 12.05.2023.

3.3 Akte të përbashkëta:
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme dhe Bankës së Shqipërisë “Për rritjen e eficencës në parandalimin dhe mbrojtjen e monedhave nga falsifikimi dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë fushë” nr. 57 prot., i Prokurorisë së Përgjithshme, datë 17.01.2023;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit “Për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave”, nr. 1311 prot., datë 14.08.2023 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe organizata me objekt veprimtarie këtë fushë.

## III.4 Dekriminalizimi

Në Sektorin e Dekriminalizimit në Drejtorinë e Koordinimit Institucional, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për vitin 2023 janë regjistruar 91 kërkesa për verifikim të plotë të të dhënave të formularëve të vetëdeklaruar të personave, subjekt i këtij ligji. Janë regjistruar 77 procese të reja dhe është ndjekur procesi i verifikimit të thelluar të të dhënave të vetëdeklaruara në formular, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, për 155 subjekte.
Për 85 subjekte vetëdeklarues është përfunduar verifikimi dhe janë përcjellë rezultatet e verifikimit, ndërkohë që 70 raste vijojnë të jenë në proces verifikimi brenda afatit ligjor të kryerjes së verifikimit, të përcaktuar në ligjin nr. 138/2015 dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

### III.5 Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë vitit 2023, ka trajtuar:

- 171 praktika ekstradimi nga jashtë drejt Shqipërisë, ndër të cilat janë përfunduar 45.
- 99 praktika ekstradimi nga Shqipëria për jashtë, ndër të cilat janë përfunduar 48.
- 431 letërporosi nga jashtë drejt Shqipërisë, ndër të cilat janë përfunduar 229.
- 491 letërporosi nga Shqipëria drejt vendeve te tjera, ndër të cilat janë përfunduar 152.
- 185 praktika shpallje në kërkim ndërkombëtar dhe 103 praktika heqje nga kërkimi ndërkombëtar
- 280 urdhër arreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, nga të cilat 125 të përfunduara;
- 47 praktika transferimi i të dënuarve nga jashtë;

- 2 praktika transferimi i të dënuarve për jashtë;
- 33 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë;
- 8 praktika njohje e vendimeve penale nga jashtë;
- 22 praktika transferimi të procedimeve nga jashtë;
- 16 praktika transferimi të procedimeve për jashtë;
- 495 praktika të tjera të ndryshme;
- 43 hetime pasurore.

## III.6 Përgjimet

Gjatë vitit 2023 është përdorur përgjimi i komunikimeve elektronike nga prokurorët në fazën e hetimeve paraprake si mjet për sigurimin e provës në 514 procedime penale. Është realizuar përgjimi për 2675 pajisje fundore në përdorim të 2492 subjekteve ndaj të cilëve ishte lejuar përgjimi. Në total janë ekzekutuar 1121 vendime për përgjim të autorizuara nga gjykata dhe 456 urdhra/autorizime të prokurorit.

# VI. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS FINANCIARE DHE ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL PËR VITIN 2023

***Të dhëna të përgjithshme mbi buxhetin e miratuar dhe realizuar për Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2023***

Me ligjin nr. 84/2022, *"Për buxhetin e shtetit të vitit 2023"*, u miratua buxheti për Prokurorinë e Përgjithshme, në vlerë 2.620.500 mijë lekë. Realizimi i buxhetit për vitin 2023, sipas artikujve kryesorë, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

(Në buxhetin e rishikuar për vitin 2023 janë përfshirë të gjitha rialokimet e kryera gjatë vitit)

**në 000/lekë**

| Emertimi | Buxheti i miratuar për vitin 2023 | Buxheti i Rishikuar për vitin 2023 | Realizimi i buxhetit për vitin 2023 | Raporti (në %) Realizim/Buxhet për vitin 2023 |
|---|---|---|---|---|
| Paga | 1,831,670 | 2,741,484 | 2,740,255 | 100 |
| Sigurime Shoqërore | 223,500 | 248,057 | 343,963 | 98 |
| Shpenzime operative | 355,180 | 365,762 | 355,328 | 97 |
| Transferta korente të huaja | 150 | 150 | 134 | 89 |
| Transferime tek individi | 2,900 | 5,919 | 5,915 | 100 |
| Investime | 210,000 | 144,400 | 91,028 | 63 |
| **TOTALI** | **2,620,500** | **3,505,772** | **3,436,623** | 98 |

***Shpenzime personeli***

Buxheti vjetor i rishikuar i shpenzimeve të personelit (Paga+Sigurime shoqërore) për këtë program është 2.989.541 mijë lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve të personelit për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 2.984.218 mijë lekë. Ky fond është realizuar në masën 99.82 %. Realizimi në këtë masë është ndikuar edhe nga pagesat e detyrimeve të prapambetura për pagat e magjistratëve/prokurorë dhe oficerëve të policisë gjyqësore në zbatim të Vendimit nr. 35/2023 të Gjykatës Kushtetuese.
Ndërkohë shpenzimet për mbikohë pune dhe gatishmëri gjatë vitit 2023 arrijnë në shumën 94,622 mijë lekë.

***Shpenzimet operative***

Shpenzimet operative, përfshijnë shpenzime që kryhen nga prokuroritë në mbështetje të realizimit të detyrave të tyre funksionale si: letër, tonera, shtypshkrime, kancelari, udhëtime e dieta, energji, shpenzime postare, telefon, shpenzime transporti, shpenzime për mirëmbajtje të ndryshme (sidomos sistemet e IT dhe paisjet e interceptimit), shpenzime për ruajtjen e godinave, avokatë, përkthyes, ekspertë të ndryshëm, shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, etj.

Edhe pse, ky zë i shpenzimeve, ka një peshë të ulët specifike, në buxhetin total të prokurorisë 10.44 %, impakti i tij në aktivitetin e përditshëm të prokurorive dhe aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme është i drejtpërdrejtë dhe shumë i rëndësishëm.

Për vitin 2023, buxheti i miratuar me ligj për shpenzime operative prej 355,180 mijë lekë ishte i pa mjaftueshëm për të plotësuar gjithë nevojat e parashikuara për këtë zë të shpenzimeve të kërkuara edhe në Projektbuxhetin 2023-2025, pasi është rritur ndjeshëm vlera e faturave të papaguara në afat.

Përdorimi me efikasitet të lartë i këtyre fondeve bëri që gjatë vitit 2023 të likuidojmë 84 milionë lekë fatura për grupin (avokatë, ekspertë, ekspertë mjeko-ligjorë, MKZ dhe fatura të kadastrës). Këto detyrime rriten pothuajse çdo vit duke bërë që gjendja në fund të vitit të arrijë vlerën rreth 124 milionë lekë. Peshën më të madhe e zenë faturat për ekspertimet mjeko-ligjore, rreth 100.4 milionë lekë. Gjithashtu edhe shpenzimet për ruajtjen fizike të godinës me subjektin "Illyrian Guard sh.a", janë në rritje. Kështu shpenzimet e ruajtjes fizike nga 92,373 mijë lekë në vitin 2022, arritën në 86,783 mijë lekë në fund të vitit 2023 (megjithëse numri i prokurorive u reduktua ndjeshëm nga zbatimi i hartës së re gjyqësore).

Buxheti për shpenzime operative për vitin 2023 u realizua në masën 355,328 mijë lekë ose 97 % e buxhetit të rishikuar.

***Investime***

Për sa i përket investimeve, fondi i miratuar për investime për vitin 2023, ishte 210,000 mijë lekë. Në detajimin e fondit të investimeve për vitin 2023 janë mbajtur në konsideratë kërkesat buxhetore për vitin 2023, ku prioritet në kuadrin e hartës së re gjyqësore kishte rikonstruksioni i godinës së prokurorisë Dibër, investim i cili nuk u realizua plotësisht.

Fondi i investimeve është realizuar në masën 91,028 mijë lekë ose 63 % kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2023.

***Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm***

Për vitin 2023, sipas kalendarit vjetor të auditimeve, janë miratuar nga ana e titullarit, 7 angazhime auditimi, nga të cilat janë realizuar 7 auditime të kombinuara dhe është kryer dhe 1 auditim tematik. Subjektet që u audituan janë prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Gjirokastër, Korçë, Dibër, Fier, Tropojë, Mat, Lezhë dhe Prokuroria e Apelit Tiranë. Në fazën e planifikimit të angazhimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar fushat me risk të mesëm, ku dhe është fokusuar auditimi. Fokusi i fushave prioritare, mbi të cilat janë fokusuar e materializuar programet e auditimit, kanë qenë si më poshtë:

- Prokurimet e fondeve publike dhe zbatimi i kuadrit rregullator për investimet;
- Në fushën e investimeve publike me financim të brendshëm;
- Administrimi i vlerave materiale e monetare;
- Shkelje, shpërdorime dhe mungesë dokumentacioni justifikues për shpenzimet e kryera për udhëtime e dieta;
- Zbatimi i rregullave të kontabilitetit publik, ruajtja dhe administrimi i pronës;
- Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimi i aseteve dhe burimeve nga subjektet e audituara etj.

Nga misionet e ushtruara në subjekte janë përcaktuar risqet kryesore të identifikuara dhe janë marrë masa për analizimin dhe trajtimin e këtyre risqeve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e komponentëve të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar Publik.

Nga misionet e auditimit për vitin 2023 në subjektet e audituara, janë dhënë rekomandime, të strukturuara sipas kësaj tipologjie:

a) Për 2 subjekte janë dhënë rekomandime për arkëtim të shumave që janë përfituar padrejtësisht në vlerën 452 mijë lekë;
***b)*** 53 rekomandime për masa të karakterit të ndryshëm.

### *Shërbimi civil*

Gjatë vitit 2023 në Prokurorinë e Përgjithshme janë rekrutuar 5 specialistë;

Në drejtim të zbatimit të politikave ekzistuese për rritjen e kapaciteteve profesionale, është bashkëpunuar me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim. Punonjësit civilë kanë dërguar nevojat e tyre në fushat ku kanë të nevojshëm trajnimin si dhe është ndjekur procesi i trajnimit detyrues nga ata që kanë hyrë në shërbimin civil të prokurorisë.

Sa i përket disiplinës në shërbimin e prokurorisë, gjatë vitit 2023, nuk janë zhvilluar procedurat disiplinore.

### *Kosto e shpenzimeve procedurale në fazën e hetimeve*

Në përfundim të vitit buxhetor 2023 nga ana e strukturave financiare të Prokurorisë së Përgjithshme është bërë një analizë e hollësishme e elementëve të kostos mesatare të hetimit për çdo prokurori dhe kostos[34] mesatare për gjithë sistemin e prokurorisë.

Shpenzimet e buxhetit të shtetit për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë që janë të përfshira drejtpërdrejt në procesin e hetimit për vitin buxhetor 2023[35] kanë qenë në shumën 2,680,828,252 lekë, në të cilën janë përfshirë pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative, ndërsa vetëm shpenzimet operative kanë qenë në shumën 157,201,279 lekë.

Kostoja mesatare e hetimit për vitin 2023, llogaritet si herës i shpenzimeve pagat, shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative kosto rezulton në shumën 48825 lekë/procedim.

**Grafiku paraqet shpenzimet totale me vlerën mesatare të kostos në përqindje sipas prokurorive për vitin 2023:**

[34] Në elementët e kostos janë përfshirë numri 45715 i procedimeve të ndjekura në fazën e hetimeve dhe numri 9946 kallëzime/referime të verifikuara dhe mosfilluar procedimi. Gjithashtu, në elementet e kostos nuk janë perfshirë shpenzimet e kryera nga oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe polici apo organet/institucione të tjera që kanë atributet e policisë gjyqësore të cilat kanë kryejnë veprime hetimore përgjatë vitit 2023.

[35] Në shpenzimet e buxhetit të shtetit për prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë për vitin 2023 nuk janë përfshirë shpenzimet për infrastrukturën dhe shpenzimet për ruajtjen e godinave të prokurorive.


Prokuroria Vlore
9%
Prokuroria Tirane
7%
Prokuroria Berat
5%
Prokuroria Diber
6%
Prokuroria Durres
7%
Prokuroria Shkoder
11%
Prokuroria Sarande
4%
Prokuroria Lezhe
9%
Prokuroria Elbasan
9%
Prokuroria Fier
6%
Prokuroria Kukes
13%
Prokuroria Gjirokaster
8%
Prokuroria Korce
6%

# VII. OBJEKTIVA PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2024

Me synim përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor të prokurorisë, si për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e mëtejshme të efektivitetit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e çështjeve/akuzave në gjyq, për krime të rënda e sensitive, me shtrirje të gjerë dhe me tendenca në rritje dhe marrjen e masave për vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, si dhe respektimin e të drejtave të ligjshme dhe lirive personale të individit në procesin penal, ashtu dhe në funksion të rritjes së kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, për përmirësimin e koordinimit dhe mbikëqyrjes të veprimtarisë së prokurorive për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme e akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstitucionale të bazuar në rekomandime të institucioneve kushtetuese sipas ligjit, si dhe përmirësimin e mbarëvajtjes së punës në administratën e prokurorive të riorganizuara në zbatim të hartës së re gjyqësore, duke garantuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve, objektivat prioritare, masat dhe aktivitetet e prokurorisë për vitin 2023, janë si më poshtë:

**1.** Në kuadrin e zbatimit të hartës së re gjyqësore të vijojë puna e nisur në bashkërendim dhe koordinim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Ministrinë e Drejtësisë për rritjen e kapaciteteve akomoduese me ambjente pune për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve, administratën dhe shërbimet mbështetëse në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, dhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe për sigurimin e aksesit të shtetasve në prokurori.

**2.** Vijimi i punës së nisur për rritjen e eficiencës së koordinimit dhe mbikëqyrjes në ecurinë e zbatimit të memorandumit të bashkëpunimit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, për rritjen më tej, të efektivitetit në hetimet, ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë për veprat penale të pastrimit të produkteve kriminale, krimet financiare dhe hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

2.1 Në kuadrin e procesit të hartimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030, Prokuroria e Përgjithshme në cilësinë e anëtarit të Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës (GTNP) do të japë kontributin e saj institucional sipas prioriteteve për ndjekjen e zbatimit të Planit të Veprimit 2024 sipas rekomandimeve të Raportit të ICRG/FATF, si dhe për mbledhjen e të dhënave, informacionit, dhënien e kontributit dhe përfaqësimit për raundin e 6-të të vlerësimit nga Komiteti MONEYVAL.

2.2 Përmirësimi më tej i kapaciteteve profesionale ndërinstitucionale, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese të përfshira, nëpërmjet masave:

i) Përfundimin e punës së nisur në bashkëpunim me Projektin EU4FOCAL (FIIAPP-Spanjoll), dhe publikimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, sipas planifikimit të këtij projekti;

ii) Të vijojë puna për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese të përfshira, në bashkëpunim me misionet dhe projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.

2.3 Të vijojë rritja më tej e eficiencës në bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në këtë fushë, si për të rritur më tej numrin e procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionistë dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), ashtu dhe për rritjen më tej të hetimeve financiare paralele dhe procedime/hetime pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive produkte të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente të tyre.

**3.** Vijimi i punës për forcimin e kapaciteteve institucionale për rritjen e eficiencës në veprimtarinë administrative të prokurorisë dhe i kapaciteteve profesionale për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së prokurorëve dhe policisë gjyqësore në ushtrimin e funksioneve kushtetuese e ligjore, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

3.1 Vijimi i monitorimit periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", i ndryshuar, me synim administrimin e punës të secilit oficer të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe për të siguruar ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, eficiencën, ligjshmërinë, procesin e rregullt ligjor dhe transparencën në veprimtarinë e sistemit të prokurorisë, ku përfshihet dhe veprimtaria e policisë gjyqësore.

3.2 Vijimi i bashkërendimit dhe koordinimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës, për të planifikuar më në kohë zëvendësimin e prokurorëve, me synim shmangien e rritjes progresive të numrit organik të prokurorëve që i mungojnë sistemit të prokurorisë në të tre nivelet pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

**4.** Të vijojë rritja më tej e veprimtarisë mbikëqyrëse për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme[36] dhe e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë në drejtim të koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informacionit, identifikimit të shkeljeve disiplinore apo etike dhe problemeve të performancës së zyrave të prokurorive, nëpërmjet aktiviteteve:

4.1 Strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme në bashkërendim me drejtuesit e prokurorive të vijojnë qasjen proaktive, me prioritet mbledhjen dhe analizën e informacionit të përftuar për problematikat e evidentuara, në funksion të rritjes së bashkëpunimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes institucionale dhe ndërinstitucionale, si dhe garantimin e zbatimit të parimit të funksionalitetit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm;

4.2 Vijimi i punës për rritjen më tej të kujdesit për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorive nëpërmjet kërkimit dhe vlerësimit të informacioneve periodike nga drejtuesit e prokurorive;

4.3 Rritja më tej e eficiencës së bashkëpunimit, koordinimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme apo akteve të tjera normative, planeve të veprimit dhe/ose strategjive institucionale apo ndërinstitucionale, të fokusura për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe/ose rekomandimeve ndërkombëtare në kuadrin e integrimit evropian të vendit, sipas ligjit.

**5.** Vijimi i punës për intensifikimin dhe rritjen e eficiencës së bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë aktorët e përfshirë në ndërveprim me sistemin e prokurorisë në të gjitha fazat e procedimit

[36] Shih, pikën 2 të nenit 6 dhe pikën 1 të nenit 46 në lidhje me nenin 2 shkronja "c" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh", ku parashikohet se, udhëzimet e përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim të prokurorëve më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët.

penal, për rritjen e efektivitetit në hetimin, ndjekjen penale, përfaqësimin e akuzës në gjykatë dhe ekzekutimin e vendimeve penale ndaj autorëve të veprave penale me tendencë në rritje, veprave penale sensitive, dhe jo vetëm, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve:

5.1 Të vijojë koordinimi efikas mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme, në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi dhe zbatimit të Aktit të Koordinimit Institucional të lidhur mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, për të siguruar hetime të shpejta dhe të plota.

5.2 Të vijojë përmirësimi më tej i eficiencës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshjet dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës të Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, për goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit.

5.3 Të vijojë puna e nisur për rritjen e aksesit të drejtpërdrejtë teknik të përdorimit të bazave të të dhënave shtetërore dhe/ose institucione publike, si për ato kërkesa që janë në proces për të mundësuar të drejtën e aksesit të drejtpërdrejtë sipas ligjit, ashtu dhe për kërkesa në baza të të dhënave shtetërore ose institucione publike të tjera sipas ligjit.

**6.** Të vijojë puna e nisur në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të ndjekur ecurinë e masave konkrete për të mundësuar dixhitalizimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, me prioritetet:

6.1 Me miratimin e paketës së ndihmës financiare nga Bashkimi Evropian lidhur me implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, grupi i punës i ngritur nga Prokurori i Përgjithshëm do të vijojë aktivitetin në bashkërendim me shoqërinë që do të ndërtojë sistemin dhe subjekte të tjera të rëndësishme në proces, për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për krijimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjes që mundëson dixhitalizimin e plotë të proceseve të punës, gjenerimin e statistikave të plota, të sakta dhe të besueshme në kohë reale, shpërndarjen e çështjeve me short elektronik në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe çdo kërkesë të nevojshme për një sistem me standarde bashkëkohore.

6.2 Të vijojë bashkërendimi dhe koordinimi i strukturave përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standard ndërkombëtare.

6.3 Të vijojë me tej puna e nisur dhe e papërfunduar nga Projekti Euralius V për zhvillimin dhe përfundimin e sistemin elektronik PRESTO, për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave me të dhëna në kohë reale dhe gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, në këtë periudhë të ndërmjetme/tranzitore, deri në ngritjen dhe funksionimin e sistemit të ri CAMS.

**7.** Të vijojë rritja më tej e eficiencës së bashkërendimit ndërinstitucional dhe koordinimit me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe me agjencitë ligjzbatuese të përfshira, për forcimin e kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore në strukturat përkatëse të shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore, me synim rritjen më tej të cilësisë dhe efektivitetit në kryerjen e hetimeve në drejtimet prioritare të luftës kundër kriminalitetit në zbatim të Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit dhe ligjit nr. 10192/2009 i ndryshuar.

**8.** Të vijojë plotësimi i kuadrit nënligjor me qëllim përmirësimin e hetimit dhe ndjekjes penale dhe garantimin e respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal, nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme për qartësimin e kuptimit dhe zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor si më poshtë:

8.1 Udhëzim "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave", për të siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive të krimeve të trafikimit të personave të rritur dhe trafikimit të të miturve, në afate të shpejta, mbrojtje eficiente të të drejtave të viktimave të trafikimit, paraqitjen e kërkesave për masa dënimi efektive, proporcionale e frenuese, që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të trafikimit;

8.2 Udhëzim "Për masat e sigurimit", nëpërmjet të cilit do të synohet dhënia e orientimeve/drejtimeve të qarta për prokurorët e prokurorive pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për zbatimin e standardeve ligjore që balancojnë nevojën për siguri të personit dhe publikut, dhe efektivitetin e ndjekjes penale, me domosdoshmërinë për të respektuar liritë themelore dhe parimet e ligjshmërisë, propocionalitetit, prezumimit të pafajësisë, mosdiskriminimit.

9. Përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori me qëllim sigurimin e aksesit të shtetasve në prokurori, nëpërmjet garantimit të standardeve për intervistimin e miturve dhe viktimave të krimit, si dhe aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara.

**Ju faleminderit!**

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

# ANEKSI NR.1
# TABELA ME TË DHËNA E TREGUES STATISTIKORË SIPAS KRERËVE, SEKSIONEVE OSE GRUPVEPRAVE

*Tabela 1*

| KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE | 2022 | | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar | | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj.[37] | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënua r |
| Neni 76 Vrasja38 | 25 | 9 | 36 | 15 | 17 | | 14 | 9 | 15 | 14 | 4 |
| Neni 77 Vrasja për një krim tjetër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 78 Vrasja me paramendim | 33 | 14 | 31 | 27 | 27 | | 15 | 13 | 10 | 17 | 11 |
| Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje | 5 | 1 | 2 | 1 | 1 | | 2 | 0 | 6 | 0 | 0 |
| Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese | 13 | 12 | 9 | 20 | 11 | | 17 | 7 | 19 | 13 | 7 |
| Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit | 2 | 0 | 1 | 0 | 0 | | 1 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare | 14 | 11 | 10 | 14 | 12 | | 12 | 10 | 12 | 10 | 6 |
| Neni 80 | 2 | 0 | 1 | 0 | 4 | | 3 | 1 | 3 | 1 | 0 |
| Neni 81 Vrasja e foshnjës | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| Neni 82 Vrasja në tronditje psikike | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 83 Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 83/a Kanosja për hakmarrje/gjakmarrje | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 84 Kanosja | 222 | 38 | 77 | 43 | 41 | | 223 | 42 | 70 | 45 | 21 |
| **Totali** | **318** | **87** | **167** | **122** | **116** | | **290** | **82** | **137** | **100** | **50** |

*Tabela 2*

| KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI | 2022 | | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Në gjykat ë | Nr. pand. Regj | Nr. Pand. në gjyk. | Nr. Pand dënuar | | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënua r |
| Neni 85 Vrasja nga pakujdesia | 7 | 2 | 2 | 2 | 4 | | 5 | 4 | 5 | 4 | 3 |
| **Totali** | **7** | **2** | **2** | **2** | **4** | | **5** | **4** | **5** | **4** | **3** |

[37] Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.
[38] Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë 42 procedime regjistruar dhe 48 të pandehur regjistruar.

*Tabela 3*

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE | 2022 | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënu ar | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. Në gjyka të | Nr. pand. Regj | Nr. Pand. në gjyk. | Nr. Pand dënua r |
| Neni 86 Tortura | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 87 Tortura me pasoja të rënda | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 88 Plagosje e rëndë me dashje | 97 | 37 | 108 | 44 | 48 | 100 | 56 | 94 | 68 | 32 |
| Neni 88/a Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë211 psikike | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 2 | 11 | 4 | 2 |
| Neni 88/b Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme | 2 | 1 | 8 | 2 | 0 | 1 | 2 | 1 | 5 | 1 |
| Neni 89 Plagosje e lehtë me dashje | 547 | 226 | 290 | 305 | 195 | 559 | 204 | 242 | 282 | 148 |
| Neni 89/b Përhapja e sëmundjeve infektive | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 89/a Shitblerja e paligjshme e organeve | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 90 Dëmtime të tjera | 18 | 1 | 6 | 1 | 0 | 11 | 0 | 6 | 0 | 1 |
| **Totali** | **667** | **265** | **412** | **352** | **243** | **677** | **264** | **354** | **359** | **184** |

*Tabela 4*

| VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA | 2022 | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. pand. Regj | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar |
| Neni 91 Plagosja e rëndë nga pakujdesia | 9 | 2 | 3 | 5 | 1 | 3 | 1 | 0 | 1 | 0 |
| Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| **Totali** | **12** | **2** | **3** | **5** | **1** | **4** | **1** | **1** | **1** | **0** |

*Tabela 5*

| VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZËNËSISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS | 2022 | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar |
| Neni 93 Ndërprerja e shtatzënësisë pa pëlqim të gruas | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 94 Ndërprerja e shtatzënësisë e kryer në vende dhe nga persona të paautorizuar | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzënësisë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 96 Neglizhenca në trajtimin mjekësor | 46 | 6 | 0 | 8 | 8 | 41 | 6 | 0 | 11 | 2 |
| Neni 97 Mosdhënia ndihmë | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes | 233 | 4 | 3 | 4 | 2 | | 224 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| **Totali** | **287** | **10** | **3** | **12** | **10** | | **267** | **7** | **1** | **12** | **2** |

*Tabela 6*

| KRIME SEKSUALE | 2022 | | | | | | 2023 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Proc. Regj | Nr. Proc. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand. Regj. | Nr. Pand. Dërg. Gjyk. | Nr. Pand dënuar | | Nr. Proc. Regj | Nr. proc. Në gjykatë | Nr. pand. Regj | Nr. Pand. në gjyk. | Nr. Pand dënuar |
| Neni 100 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur | 22 | 16 | 14 | 17 | 9 | | 17 | 8 | 8 | 10 | 13 |
| Neni 101 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç | 15 | 2 | 9 | 2 | 7 | | 8 | 1 | 4 | 1 | 10 |
| Neni 102 Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura | 13 | 8 | 9 | 13 | 8 | | 11 | 3 | 7 | 3 | 5 |
| Neni 102/a Marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Neni 103 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur | 3 | 5 | 1 | 5 | 3 | | 4 | 3 | 1 | 3 | 1 |
| Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
